

Çështje Evropiane dhe të Sigurisë

28

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Bordi Shkencor:

Prof. Dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Dr. Pëllumb Qazimi (anëtar)

Dr. Elona Dhembo (anëtar)

MA Arjan Dyrmishi (anëtar)

Dr. Foto Duro (anëtar)

Redaktor përgjegjës:

Gentiola Madhi MA/MSc

*Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të
Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s.*

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
<i>Camilla CARINI</i> EULEX KOSOVA: NJË INSTRUMENT PËR ZGJERIMIN	5
<i>Adel ABUSARA</i> DOKUMENTET STRATEGJIKE TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR	24
<i>Foto DURO</i> MBI STRATEGJINË E SIGURISË KOMBËTARE TË SHQIPËRISË	43
<i>Albert HITOALIAJ</i> NJË EMËR PËR STRATEGJINË E SIGURISË KOMBËTARE 2014	63
<i>Elton QËNDRO</i> GJEOGRAFIA SI FAKTOR I RËNDËSISHËM I SIGURISË ENERGJITIKE TË RAJONIT	82
ABSTRACTS	97

PARATHËNIE

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave, mbi reformat dhe performancën e sektorit të sigurisë në përgjithësi, prirjet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, sjellim për lexuesin numrin e ri të *Revistës për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë*.

Tematika kryesore e numrit të 28 të revistës përqendrohet tek adoptimi i *Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe reflektimit të saj në nivel rajonal*.

Ky volum përqendrohet kryesisht tek sfidat dhe problemet e sigurisë, porë kjo në aspektin konceptual dhe në masat përkatëse që duhen ndërmarrë në këtë aspekt në vend. Një tjetër aspekt i trajtuar në këtë numër është roli i luajtur nga EULEX-i në Kosovë, si dhe sfidat e reja energjetike për rajonin e Ballkanin Perëndimor.

**EULEX KOSOVA:
NJË INSTRUMENT PËR ZGJERIMIN**

“Kosova është përfituesja më e madhe për frymë e ndihmave të BE-së në të gjithë botën”.² Me këto fjalë, në vitin 2011, Presidenti i Komisionit Evropian José Manuel Barroso nënvizoi angazhimin e Bashkimit Evropian (BE) ndaj këtij territori të kontestuar. Në vitin 2003, Këshilli Evropian i dha Kosovës një perspektivë evropiane dhe që prej asaj kohe, ajo është bërë përfituese e ndihmave financiare të procesit të zgjerimit (programi CARD dhe prej 2007, Instrumenti i Ndhmës së Para Aderimit – IPA). Kjo ndihmë synon kryesisht të mbështesë ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimin e sundimit të ligjit, në mënyrë që të lehtësojë përafrimin e standardeve kombëtare me standardet e *acquis communautaire*.

Që prej vitit 2005, procesi i zgjerimit ka filluar të fokusohet gjithnjë e më shumë tek sundimi i ligjit.³ Pasja e shtetit të së drejtës është e rëndësishme për vet procesin e zgjerimit, por gjithashtu edhe për të siguruar që programet e financuara nga Komisioni do të prodhojnë një ndryshim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, në sajë të institucioneve të përgjegjshme. Korrupsioni përbën një kërcënim serioz për shtetin e së drejtës, dhe kosovarët e perceptojnë atë si një prej çështjeve më serioze të vendin. Përveç çështjes së njohjes, ai përbën pengesën kryesore në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Transparency International në *Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit* e rendit Kosovën në vendin e 105 prej 176 vendesh, në një njësi matjeje ku korrupsioni është nga më pak deri tek më shumë i perceptuar.⁴

Që prej 2004, CSDP⁵-ja ka qenë gjithnjë e më shumë e fokusuar në promovimin e shtetit të së drejtës. Qëllimi kryesor i misioneve të sundimit të ligjit është qëndrueshmëria e reformave dhe vazhdimësia e tyre pasi misioni është larguar nga shteti pritës. Ginsberg dhe Penksa kanë zhvilluar një kuadër analitik mbi ‘analizën e ndikimit’, në mënyrë që të vlerësojë aspekte të ndryshme të misioneve të CSDP-së. Ky studim përdor këtë kuadër analitik, duke u fokusuar tek ndikimi politik i jashtëm, i cili konsiston në efektet e një misioni CSDP tek

¹ Autorja është diplomuar me gradën Master në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomacia e Bashkimit Evropian pranë Kolegjit të Europës (Bruges, Belgjikë), si dhe me gradën Master në Studime Evropiane pranë Universitetit të Sienës (Itali).

² European Union, Statement by President Barroso Following his Meeting with Hashim Thaçi, Prime Minister of Kosovo, SPEECH11/360, Pristina, 20 May 2011, retrieved on 28 April 2013.

³ European Commission, DG Enlargement, *Chapters of the acquis*, retrieved on 28 April 2013.

⁴ Transparency International, *Corruption by Country: Kosovo*, retrieved on 18 April 2013.

⁵ CSDP: Common Security and Defense Policy – Politika e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian

politikat kombëtare të vendit ku misioni operon, në sensin e mbështetjes nga liderat politikë dhe popullata.⁶

Ky studim fokusohet mbi rolin që EULEX-i luan në aspektin e ndikimit politik të jashtëm (si p.sh.: ai influencon në mënyrë të konsiderueshme politikat e institucioneve kosovare), e cila përbën vetëm një pjesë të “qasjes gjithëpërfshirëse” të BE-së ndaj Kosovës dhe, pavarësisht vullnetit të dobët politik të institucioneve kosovare në zbatimin e reformave, ndikimi politik influencohet ndjeshëm nga perspektiva e integritetit të vendit në BE.

Ginsber dhe Penksa identifikojnë disa elemente që mund të influencojnë, në nivele të ndryshme, suksesin e një misioni të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Ky punim merr në konsideratë elementet e mëposhtme: ftesën e qeverisë pritëse për dislokimin e misionit të BE-së, përçarjet mes vendeve anëtare, prezencën ose mungesën e një mandati ekzekutiv, pasi nëse ky mandat nuk ekziston, mund të komprometojë konsolidimin e autoritetit lokal mbi zbatimin e reformave.⁷ Elemente të tjera janë: efektet e padëshiruara e negative mbi shtetin pritës, përfshirja e elitës politike në marrjen e vendimeve, marrëdhëniet e punës mes gjithë homologëve (si në nivel operacional dhe në atë politik).⁸

EULEX KOSOVA

EULEX-i u krijua në dhjetor 2008, me qëllim për të “*ndihmuar institucionet, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë ligjzbatuese të Kosovës në progresin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies*”.⁹ Këshilli fillimisht parashikoi dy mënyra për përmbushjen e mandatit të EULEX-it: nëpërmjet mentorimit, monitorimit dhe këshillimit (MMA)¹⁰ dhe nëpërmjet përgjegjësisë ekzekutive në tre sektorë specifikë: policia, gjyqësori dhe doganat.¹¹ Detyrat e caktuara kanë qenë të shumta. Mes tyre, EULEX-i duhet të sigurojë se “*rastet e krimeve të luftës, korrupsionit, krimeve ndër-etnike do të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen sipas ligjit në fuqi*”¹², si dhe “*të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar*”¹³.

⁶ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *The European Union in Global Security. The Politics of Impact*, Houndmills Basingstoke, Palgrave, 2012, p. 108.

⁷ *Ibid.*, pp. 112-113.

⁸ *Ibid.*, p. 115-116.

⁹ Council of the EU, “Council Joint Action (2008/124/CFSP) on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo”, *Official Journal of the European Union*, L42, 16 February 2012, p. 92.

¹⁰ MMA: Mentoring, Monitoring & Advising

¹¹ *Ibid.*, p. 94.

¹² *Ibid.*, p. 93.

¹³ *Ibid.*, p. 93.

Mandati fillestar u zgjat deri në qershor 2016 dhe struktura e bazuar në tre sektorë u zëvendësua nga dy seksione: divizioni 'ekzekutiv' dhe divizioni 'mbështetës'. I pari është përgjegjës për zbatimin e mandatit ekzekutiv, ndërsa i dyti merret me zbatimin e MMA-së kundrejt institucioneve vendore.¹⁴

Në momentin e krijimit të EULEX-it, raportet për Kosovën specifikonin se prezenca ndërkombëtare ishte ende e nevojshme, sepse institucionet lokale nuk ishin në gjendje të merrnin përsipër përgjegjësi mbi disa sektorë sensitivë. Në veçanti, Plan i Veprimit mbi krijimin e EULEX-it, i atribuoi misionit detyra specifike në luftën kundër korrupsionit. Së pari, ai duhet të siguronte që krimet e lidhura me korrupsionin do të hetoheshin, ndiqeshin, gjykoheshin dhe zbatoheshin sipas ligjit në fuqi, nëpërmjet bashkëpunimit mes zyrtarëve ndërkombëtare dhe kosovarë. Së dyti, ai duhet të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit dhe të zbatojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit Antikorrupsion.¹⁵

ANALIZA E NDIKIMIT POLITIK TË EULEX-it NDAJ INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

Faktorët që influencojnë në ndikimin politik të EULEX-it mund të klasifikohen në tre kategori: faktorët ekzistues përpara dislokimit të misionit, faktorët pas dislokimit dhe faktorë të tjerë të pavarur nga EULEX-i.

1. FAKTORËT INFLUENCUES NË NDIKIMIN POLITIK TË EULEX-it PËRPARA DISLOKIMIT TË TIJ

1.1. NDARJET MIDIS SHTETEVE ANËTARE

Misionet CSDP përgjithësisht duhet të përshtaten në një kontekst koherent me politikën e jashtme të BE-së, në mënyrë që të evitohet mundësia e elitave politike të vendit pritës të shfrytëzojnë përçarjen midis shteteve anëtare. Për më tepër, qeveria pritëse mund të lodhet me zbatimin e politikave dhe programeve kur nuk ka një pozicion të unifikuar në nivel evropian.¹⁶

Në rastin e Kosovës, pozicioni i vendeve anëtare nuk mund të ishte më i përçarë se kaq. Në fakt, nuk kishte (dhe nuk ka ende) një konsensus mbi njohjen e Kosovës si shtet i pavarur, por kjo nuk

¹⁴ EULEX Kosovo, *EULEX Mission Extended until June 2016*, Pristina, 6 June 2014, retrieved on 18 April 2013.

¹⁵ Council of the EU, "Council Joint Action" *op. cit.*, p. 93.

¹⁶ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 111.

bllokoj lançimin e EULEX-it në 2008. Konsensusi u arrit mbi dy elemente: neutraliteti mbi statusin dhe natyra teknike e misionit.¹⁷

Neutraliteti mbi statusin e Kosovës ishte një kusht i detyrueshëm për dislokimin e misionit, si nga perspektiva e të drejtës ndërkombëtare (Serbia, shtet sovran, do ta pranonte misionin vetëm me këtë kusht) dhe nga perspektiva politike (shtetet anëtare që nuk e njohin pavarësinë e saj nuk do të votonin kurrë në favor të një misioni me konsiderata politike divergjente rreth Kosovës, si p.sh. njohja e sovranitetit të Kosovës).

EULEX-i u dislokua sepse shtetet anëtare ishin të preokupuara për veprimtaritë kriminale me origjinë prej apo që kalonin përmes Kosovës.¹⁸ Edhe pse EULEX-i është mision teknik, ai funksionon në një mjedis të politizuar dhe është në ndërveprim konstant me autoritetet politike kosovare. Ai nuk ka formën e politikave të BE-së, por funksionon për forcimin e institucioneve të ngarkuara me zbatimin e këtyre politikave.¹⁹ Vendet anëtare janë të kënaqura me këtë situatë dhe në mënyrë që të përmirësojnë sigurinë e tyre, ato përdorin EULEX-in si një instrument teknik bashkëpunimi me autoritetet kosovare. Në të kundërt, kjo do të ishte e pamundur për vendet anëtare që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Shembull konkret është fakti se EULEX-i ka negociuar me qeverinë sllovae për ekstradimin nga Kosova të një qytetari sllovak.²⁰

Perspektiva e zgjerimit e zvogëlon mundësinë e shtetit pritës në shfrytëzimin e ndarjeve të brendshme mes vendeve antare të BE-se mbi çështjen e statusit të Kosovës apo në perceptimin e prezencës së EULEX-it, apo dhe në zbatimin e politikave të BE-së si më pak legjitime në vend. BE-ja mbetet aktori ndërkombëtar me peshën më të lartë politike në Kosovë dhe, nëse anëtarësimi në BE nuk duket i mundshëm në periudhën afatshkurtër, ekzistojnë stacionet afatmesme, si liberalizimi i vizave për zonën Shengen dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, të cilat janë atraktive për qeverinë dhe qytetarët e Kosovës. Për t'i patur të dyja, raportet e Komisionit tregojnë se fuqizimi i shtetit të së drejtës është thelbësor, dhe se EULEX-i është instrumenti kryesor për këtë qëllim.

1.2. PËLQIMI MBI SOVRANITETIN

Nëse qeveria pritëse është detyruar nga presioni ndërkombëtar të pranojë misionin, autoritetet kombëtare mund të adoptojnë sjellje të

¹⁷ Interview with Official G, Italian Ministry of Foreign Affairs, via e-mail, 26 April 2013.

¹⁸ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 114.

¹⁹ Interview with Official F, EEAS, Civilian Planning and Conduct Capability, 26 April 2013.

²⁰ EULEX Kosovo, *EULEX Assists an Extradition Process*, Pristina, 20 December 2012, retrieved on 30 April 2032.

luhatshme duke shfrytëzuar prezencën e përplasjeve mes partive politike.²¹

Ideja origjinale e dislokimit të një misioni civil për forcimin e shtetit të së drejtës daton që në 2005 (pra përpara deklaratës së pavarësisë), dhe parashikohej si nga BE-ja edhe OKB-ja. Për këto arsye, konsultimet midis dy organizatave ndërkombëtare ishin intensive që në fazën e parë të planifikimit.²² Autoritetet kosovare, edhe pse në mënyre provizore, në fillim nuk dhanë konsensusin e tyre për dislokimin e EULEX-it.

Deklarata e Pavarësisë e Kosovës në mënyrë eksplicite bëri thirrje për një prezencë ndërkombëtare mbi mbikëqyrjen e zbatimit të propozimit të Ahtisaarit, duke përfshirë misionin e BE-së mbi sundimin e ligjit.²³ Ky pozicionim u përfshi gjithashtu në kushtetutën e re.²⁴ Pra formalisht, Kosova i bëri thirrje BE-së për një mision mbi sundimin e ligjit, por, në praktikë, kjo u konsiderua si një çmim për t'u paguar për deklarimin e pavarësisë. Me fjalë të tjera, prezenca ndërkombëtare, përfshirë dhe EULEX-in, ishte 'paketa e pavarësisë' që autoritetet kosovare duhet të pranonin.²⁵

2. FAKTORËT INFLUENCUES NË NDIKIMIN POLITIK TË EULEX-it PAS DISLOKIMIT TË TIJ

2.1. MBËSHTETJA NGA LIDERËT KOMBËTARË

Qëndrueshmëria e reformave garantohet kur plotësohen dy kushte: mbështetja nga liderët politikë kombëtarë dhe pikëtakimi midis nevojave për siguri të siguruesit (BE-ja) dhe çfarë ai percepton si nevoja të qeverisë pritëse.²⁶

Sa për mbështetjen e udhëheqësve politikë vendas, është themelor të kuptuarit e tyre mbi arsyen pse reformat janë të nevojshme, për të shmangur kështu anulimin e çka është zbatuar pas largimit të misionit.²⁷ Për sa i përket EULEX-it, elita vendase e ka kuptuar qartë se e ardhmja e Kosovës është në BE dhe se reformat e promovuara nga misioni (sikurse veprimtaritë ekzekutuese komplementare) përbëjnë hapa të detyrueshëm për avancimin në procesin e integritimit në BE.²⁸ Pavarësisht disa episodeve të diskutueshme, autoritetet kosovare e kanë kuptuar se bashkëpunimi

²¹ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 112.

²² C. Gourlay, "The Politics of EU Strategic Interventions and the Strategic Deficit of CSDP", ISIS "Communicate, Coordinate, and Cooperate" Papers, Brussels, October 2011, pp. 15-17.

²³ Republic of Kosovo, Assembly, *Declaration of Independence*, Pristina, 17 February 2008, par. 5.

²⁴ Republic of Kosovo, "Chapter VII – Final Provisions, Art. 143", *Constitution of the Republic of Kosovo*, Pristina, 15 June 2008, p. 55.

²⁵ Interview with official C, DG Enlargement, European Commission, Brussels, 12 April 2013.

²⁶ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 113.

²⁷ *Ibid.*, p. 113.

²⁸ Interview with Official F, *op. cit.*

me EULEX-in në zbatimin e agjendës së reformave të BE-së është i nevojshëm. Angazhimi i tyre mund të jetë pak a shumë i sinqertë, por ata janë në dijeni se nuk ka alternativë tjetër për të ardhmen e Kosovës veç BE-së.²⁹

Për sa i përket kontributit të autoriteteve vendase në hartimin e agjendës së reformave, është thelbësore arritja e një rezultati të pëlqyeshëm si nga BE-ja si nga vendi pritës.³⁰ Që kur Kosovës ju dha perspektiva evropiane, ka patur një konvergjencë midis nevojave të Kosovës dhe BE-së. Në kuadrin e Procesit të Dialogut të Stabilizim-Asocimit (SAPD) dhe procesit të liberalizimit të vizave, janë identifikuar shumë reforma të nevojshme në fushën e sundimit të ligjit. EULEX-i gjendet në Kosovë me objektivin e sigurimit të ekspertizës teknike institucioneve të përgjegjshme për zbatimin e tyre.

Sikurse është vënë re, kur EULEX-i të tërhiqet nga Kosova, BE-ja do të mbetet me procesin e zgjerimit dhe forma të tjera dialogu në këtë vend.³¹ Kjo qasje e gjerë e BE-së ndaj Kosovës kompenson mungesën parciale të mbështetjes së veprimtarive ku angazhohet EULEX-i. EULEX-i është një instrument për thjeshtëzimin e reformave, por mbetet procesi i zgjerimit si garantues i qëndrueshmërisë afatgjate të progresit të arritur.

2.2. ZHVILLIMI I PËRGJEGJËSISË VENDORE DHE MANDATI EKZEKUTIV

Sipas Ginsber dhe Penksa, 'autorësia vendore' (local ownership) duhet të jetë një prej parimeve kryesore të ndërhyrjes së jashtme të BE-së. Kjo lidhet me efektin e misioneve të suksesshme që kanë për qëllim reformimin e institucioneve dhe ligjeve në fuqi.³²

Në rastin e EULEX-it, ky koncept është theksuar veçanërisht në dokumentet dhe komunikatat e tij.³³ Gjithsesi, ky parim është shumë kontradiktor kur aplikohet tek një mision me një mandat ekzekutiv sepse ai "arrihet nëpërmjet qasjes së pushtetit piramidë (over-power approach) në vend të partneritetit bashkëpunues".³⁴

Fuqitë ekzekutive nënkuptohen në mënyra të ndryshme sipas institucioneve që i ushtrojnë.

Në gjyqësor, u vendos krijimi i një paneli me përbërje mikse nga EULEX-i dhe gjykatësit kosovarë, për të mënjeluar krijimin e një sistemi paralel vetëm për menaxhimin e rasteve më sensitive.

²⁹ Interview with Official E, EEAS, CMPD, via phone, 15 April 2013.

³⁰ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 113.

³¹ Interview with Official E, *op. cit.*

³² R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 113.

³³ See, as an example: EULEX Kosovo, *Programme Report 2009*, Pristina, June 2009, pp. 6, 9.

³⁴ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 112.

Nëpërmjet paneleve mikse, gjykatësit e EULEX-it kontribuojnë në krijimin e përgjegjësisë vendore nëpërmjet veprimtarive të punës në grup më kolegët kosovarë.³⁵

Në fushën e policisë gjithashtu, mandati ekzekutiv është i një rëndësie të veçantë. Policia e EULEX-it ka mundësinë e zhvillimit të operacioneve në zonat e ndjeshme pa përfshirë policinë e Kosovës dhe të kalimit të rezultateve direkt tek Zyra e Prokurorit Special të Kosovës.³⁶

Nëse fuqitë ekzekutive kanë kontribuar pozitivisht në performancën e EULEX-it, mbeten me dyshim kapacitetet aktuale të institucioneve vendore (kryesisht gjyqësori) për të menaxhuar çështjet e ndjeshme.³⁷ Kjo mund të shpjegojë arsyen e zgjatjes së mandatit.³⁸

EULEX-i është kritikuar për përdorimin e tepruar të mandatit të tij ekzekutiv dhe për privilegjimin e qasjes nga lart-poshtë (top-down approach), veçanërisht në sektorët e ndjeshëm siç janë krimet e luftës. Gjithsesi, nëse do të ishin lënë vetëm veprimtaritë e MMA-së, atëherë misioni do të humbiste një pjesë të efektivitetit të tij. Është e qartë se, megjithëse EULEX-i po vendos një sërë përgjegjësish në duart e institucioneve kosovare, ai nuk i konsideron ato ende gati për t'i marrë në dorë të gjitha, sikurse tregon dhe zgjatja e vet mandatit.

2.3. EFEKTET E PADËSHIRUESHME MBI INSTITUCIONET DHE POPULLSINË

Një mision CSDP mund të ketë disa efekte negative mbi institucionet dhe popullsinë e vendit pritës. Këto probleme duhet të parashikohen dhe mënjanohen. Gjithsesi, nuk është gjithnjë e mundur t'i identifikosh, prandaj duhet të vihen në aplikim strategji për limitimin e ndikimit.³⁹

Efekti i parë i padëshiruar i identifikuar nga pjesa më e madhe e të intervistuarve është prezenca e fuqive ekzekutive në mandatin e misionit. Në fakt, nëse i lejohet misionit të punojë në disa zona specifike sensitive, të cilat në të kundërt do të mbeteshin zbuluar, është gjithashtu e vërtetë se në të ardhmen, misioni do të riformatohet pa një mandat ekzekutiv ose do të tërhiqet nga Kosova. Zyrtarëve përgjegjës të disa funksioneve publike në fushën e sundimit të ligjit do t'u duhet t'i plotësojnë këto detyra në mënyrë të pavarur.⁴⁰

³⁵ Interview with Official F, *op. cit.*

³⁶ M. Spornbauer, "EULEX Kosovo – Mandate, Structure and Implementation: Essential Clarifications for an Unprecedented Mission", *CLEER Working Paper*, no. 5, 2010, The Hague p. 30.

³⁷ Interview with Official A, EEAS, CMPD, Brussels, 27 March 2013.

³⁸ Interview with Official G, *op. cit.*

³⁹ R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *op. cit.*, p. 113.

⁴⁰ Interviews with Officials A, E, F, *op. cit.*

Në rastin e gjyqësorit, në veçanti, nuk ka një ambient të sigurt për gjykatësit dhe prokurorët kur ata merren me raste sensitive (veçanërisht krimet e luftës, ku ish-anëtarët e UÇK-së nën hetim konsiderohen heronj kombëtarë nga popullsia) dhëlpër rrjedhim, sikurse u përmend më parë, mund të jenë të ekspozuar ndaj kërcënimeve.⁴¹

EULEX-i, nëpërmjet program-raporteve vjetore, identifikon progresin e bërë në mënyrë që të kalojë nga funksionet ekzekutive tek veprimtaritë e MMA-së, të cilat sigurojnë një qëndrueshmëri afatgjate.

Zyrtarë të EULEX-it, dhe me eksperiencë në Kosovë, identifikuan strategjinë e parë të komunikimit si një prej burimeve me efektin më negativ mbi popullsinë.⁴²

Në fakt, në momentin e dislokimit, pjesa më e madhe e kosovarëve nuk kishte një ide të qartë mbi mandatin e EULEX-it, ndoshta për shkak të paaftësisë së misionit për ta komunikuar atë. EULEX-i shihej si një vazhdim i administrimit të OKB-së dhe u akuzua si një shembull i mungesës së shërbimeve publike.⁴³ Për t'iu përgjigjur këtyre akuzave, EULEX-i lançoi një sërë fushatash televizive ku shpjegonte funksionet dhe veprimtarinë e tij.⁴⁴

3. FAKTORË TË TJERË INFLUENCUES NË NDIKIMIN POLITIK TË EULEX-IT

3.1. FUNDI I PAVARËSISË SË MONITORUAR

Në 10 shtator 2012 Zyra Ndërkombëtare Civile u mbyll dhe i dha fund pavarësisë së monitoruar të Kosovës. Ajo u hap në 2008 me qëllim asistimin në zbatimin e Planit të Ahtisaarit.

Entuziazmi në Kosovë ishte i lartë, duke qenë se kjo nënkuptonte një tjetër hap drejt pavarësisë së plotë. Gjithsesi, kjo nuk nënkuptonte fundin e prezencës ndërkombëtare, sepse KFOR-i dhe EULEX-i ishin (dhe janë) akoma prezentë. Nëse KFOR-i konsiderohet i nevojshëm për sigurinë e vendit (Kosova nuk ka një ushtri, megjithëse debati vazhdon), prezenca e EULEX-it perceptohet si 'ndërhyrëse' nga qeveria, dhe konsiderohet si kontradiktore.⁴⁵ Qeveria ka një sjellje kontradiktore ndaj misionit. Nga njëra anë, ajo do të donte një transferim të konsiderueshëm të EULEX-it në Veri dhe një prezencë të vogël të tij në Jug, me fuqi ekzekutive të limituara dhe që kanë të bëjnë me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimeve të luftës

⁴¹ Interview with Official A, *op. cit.*

⁴² Interview with Official H, EULEX, Brussels, 26 April 2013.

⁴³ Interview with Official D, EULEX, Brussels, 12 April 2013.

⁴⁴ See, as an example: "Interviewing Witnesses: MMA in Practice", *EULEX*, 24 August 2011, retrieved on 30 April 2013, or "EULEX Does Not Fix Our Everyday Lives", *EULEX*, retrieved on 30 April 2013.

⁴⁵ Interview with Official A, *op. cit.*

(që përbën një kërkesë të BE-së, por që është tepër sensitive për t'u kryer vetëm nga gjykatësit kosovarë), nga ana tjetër, dihet se prezenca e EULEX-it është e rëndësishme për forcimin e institucioneve të shtetit të së drejtës, veçanërisht për të ecur përpara në dialogun për liberalizimin e vizave dhe në negocimin për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.⁴⁶ Pas shtatorit 2012, nxitja për të marrë përsipër përgjegjësitë është bërë më eksplicite, por në të njëjtën kohë, prezenca e EULEX-it është më e nevojshme se kurrë për të zbatuar plotësisht detyrat për procesin e liberalizimit të vizave dhe për aspektet teknike të marrëveshjes me Serbinë, të firmosur në prill 2013.

3.2. INFLUENCA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

SHBA-ja ushtron një influencë të madhe mbi politikën kosovare, sikurse konfirmojnë episode si zgjedhja e Presidentes së Kosovës në 2011.⁴⁷ SHBA-ja merr pjesë tek EULEX-i nëpërmjet kontributit në burime njerëzore, por ka patur disa tensione midis këtyre dy entiteteve, si rasti i hartimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në 2012, ku BE-ja dhe SHBA-ja shprehën pikëpamje të ndryshme.⁴⁸

Një prej të intervistuarve e ka shpjeguar këtë influencë në terma mirënjohjeje ndaj 'çlirimtarit' nga shtypja serbe (1999) por gjithashtu në terma të të 'folurit me një zë të vetëm'. Në fakt, SHBA-ja është prezente në Kosovë me një linjë politike unike. Nga ana tjetër, BE-ja ka më shumë zëra, siç janë: vendet anëtare, Komisioni Evropian, Përfaqësuesi Special i BE-së dhe EULEX-i. Megjithatë, kur BE-ja kërkon adoptimin dhe zbatimin e një ligji, ajo parashtrohet vetëm linjat orientuese. Të qenit i aftë të zbatosh një kërkesë të BE-së në mënyrën më të përshtatshme për kombin është shenjë e pjekurisë politike, të cilën Kosova duhet ta tregojë.⁴⁹

⁴⁶ Interview with Official E, *op. cit.*

⁴⁷ The former Ambassador of Kosovo, Christopher Dell, played a crucial role in unblocking the political *impasse* following the election of the President of the Republic. He ranged an agreement between the main political parties which converged in voting Atifete Jahjaga. See: F. Martino, "Atifete Jahjaga, una Poliziotta alla Guida del Kosovo", *Osservatorio Balcani e Caucaso*, 8 April 2011, retrieved on 2 May 2013.

⁴⁸ Interview with Official F, *op. cit.*

⁴⁹ Interview with Official B, EEAS, CMPD, Brussels, 3 April 2013.

ANALIZË E NDIKIMIT POLITIK TE EULEX-IT MBI INSTITUCIONET E KOSOVËS NË LUFTËN NDAJ KORRUPSIONIT

1. FAKTORËT QË INFLUENCOJNË NDIKIMIN

Perspektiva e zgjerimit, dhe të gjitha hapat drejt tij, përbën faktorin kryesor që influencon efektin e EULEX-it mbi autoritetet e Kosovës në përfshirjen në luftën kundër korrupsionit. Kjo për shkak të theksit që Komisioni Evropian vendos mbi rëndësinë e sundimit të ligjit në formate të ndryshme negociatash.

Për sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, lufta kundër korrupsionit shihet si një kusht thelbësor për avancimin e negociatave. Udhërrëfyti i Komisionit kërkon masa për parandalimin e korrupsionit mes zyrtarëve të përfshirë në sektorët ku përshtatja me *acquis* është e nevojshme,⁵⁰ për të evituar që liberalizimi i vizave mund të kërcënojë sigurinë e brendshme të BE-së. Vet udhërrëfyti i cakton EULEX-it detyra specifike në vlerësimin e progresit të Kosovës dhe në realizimin e veprimtarive të MMA-së për adoptimin dhe zbatimin e reformave, duke nënvizuar sa thelbësor është bashkëpunimi midis autoriteteve të Kosovës dhe misionit.⁵¹

Për sa i përket Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Këshilli aprovoi hapjen e negociatave në fund të prillit 2013, dhe vendimi u zyrtarizua në qershor.⁵² Edhe në këtë rast, Komisioni nënvizon nevojën, për qeverinë kosovare, të bashkëpunojë me EULEX-in për arritjen e rezultateve të pritura në sensin e investigimeve të reja.⁵³ Në raportin e tij të prillit 2013, Komisioni deklaroi se rezultatet e partneritetit “*po bëhen më evidente*”, dhe se bashkëpunimi mes EULEX-it dhe prokurorëve vendorë, sikurse mes Zyrës së Prokurorit Special dhe policisë së Kosovës, është intensifikuar nga tetori 2012 dhe prilli 2013.⁵⁴ Është e qartë se perspektiva e hapjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit forcoi efektin e EULEX-it ndaj autoriteteve kosovare, duke i bërë ato më të prirura për të bashkëpunuar me misionin.

Për sa i përket fundit të pavarësisë së monitoruar, pasojat negative potenciale të vullnetit të qeverisë për të marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë në fushën e sundimit të ligjit janë zbutur nga ‘fuqia e strategjisë së zgjerimit’. Në raportet e tij, Komisioni Evropian ka deklaruar se, për të proceduar me negociatat për liberalizimin e

⁵⁰European Commission, *Visa Liberalization with Kosovo Roadmap*, Brussels, 14 June 2012, pp. 7, 9, 10.

⁵¹*Ibid.*, pp. 3, 6.

⁵²A. Gardner, “Landmark Deal Opens the Door to the EU”, *European Voice*, vol. 19, no. 16, 25 April 2013, pp. 8-9.

⁵³European Commission, *Communication on a Feasibility Study*, op. cit., pp. 10-11.

⁵⁴European Commission, *Joint Report on Kosovo's Progress in Addressing Issues set out in Council Conclusions of December 2012 in View of a Possible Decision on the Opening of the Negotiations on the Stabilization and Association Agreement*, JOIN(2013) 8 final, Brussels, 22 April 2013, p. 3.

vizave dhe për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, është i nevojshëm një përmirësim i bashkëpunimit me misionin.

Ndërkohë veprimtaria e SHBA-së në Kosovë tregon se ata ndonjëherë ndërhyjnë me veprimtarinë e BE-së, duke kontribuar pjesërisht në destabilizimin e rezultateve të arrira. SHBA-ja nuk disponon një levë politike mbi qeverinë kosovare, ndërkohë që ndihmat financiare janë shpërndarë pa kushtëzime, duke mos përcaktuar kështu asnjë kusht për qeverinë për një përfshirje efektive në luftën kundër korrupsionit.⁵⁵

Strategjia e zgjerimit përbën burimin më të madh të ndikimit mbi autoritetet kosovare në luftën kundër korrupsionit, dhe lehtëson efektet potenciale destabilizuese të dëshirës së qeverisë për të marrë përsipër veprimtarinë e EULEX-it dhe ndihmat pa kushte të SHBA-së. BE-ja ka qenë në gjendje të përdorë levën e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe procesit të liberalizimit të vizave për rritjen e ndikimit të EULEX-it mbi qeverinë për një përfshirje me efektive në luftën ndaj korrupsionit.

2. MBËSHTETJA E UDHËHEQËSVE LOKALË

Lufta kundër korrupsionit e EULEX-it ka prekur interesat e elitës politike, për pasojë, vullneti i tyre në mbështetjen e veprimtarisë antikorruptive të misionit nuk ka qenë i plotë. Gjithsesi, mundësia konkrete e hapjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndoshta ka gjeneruar një ndryshim të vullnetit politik.

Abuzimi me kompetencat publike konsiderohet të jetë baza e sistemit politik në Kosovë, dhe lufta ndaj korrupsionit do të nënkuptonte prishjen e qarkut që lidh fitoret elektorale, shpërndarjen në mënyrë selektive të fondeve të komunave me shumicë politike PDK-së, nepotizmit dhe lidhjet politike në emërimin e zyrtarëve publikë.⁵⁶ Ndonëse retorika antikorrupsion është e fortë, ekzekutivi nuk tregon një vullnet të madh në drejtim të zhdukjes së fenomenit. Në fakt, Kosova ka një legjislacion kompetent në fuqi, por niveli i zbatueshmërisë është i dobët dhe shpesh mos-zbatimi nuk sanksionohet.⁵⁷

Midis tetorit dhe prillit 2010, Komisioni ka regjistruar disa përmirësime në padurimin e autoriteteve kosovare në luftën kundër korrupsionit, dhe bashkëpunimi midis policisë, autoriteteve gjyqësore dhe EULEX-it ka prodhuar rezultate më të dukshme.⁵⁸

⁵⁵Interview with Official C, *op. cit.*

⁵⁶I. Briscoe, M. Price, "Kosovo's New Map of Power: Governance and Crime in the Wake of Independence", *Clingendael Institute*, The Hague, May 2011, pp. 26-27.

⁵⁷C. Fagan, "EU Anti-Corruption Requirements: Measuring Progress in Albania, Kosovo, FYR Macedonia and Turkey", *Transparency International Report*, Berlin, June 2011, p. 2.

⁵⁸European Commission, *Joint Report on Kosovo's Progress*, *op. cit.*, p. 3.

3. ZHVILLIMI I PËRGJEGJËSISË LOKALE

Në rastin e luftës kundër korrupsionit, mandati ekzekutiv i EULEX-it ka prioritetin mbi veprimtarinë e MMA-së, që është më e përshtatshme në forcimin e përgjegjësisë lokale. Një ndryshim do të jetë i mundshëm kur legjislacioni mbi mbrojtjen e prokurorëve dhe gjykatësve do të zbatohet me përpikëri.

Veprimtaritë e EULEX-it, në kuadër të MMA-së, kanë një ndikim pozitiv mbi institucionet kosovare për dy arsye kryesore: e para, është ngritja e kapaciteteve dhe transmetimi i praktikave më të mira për kolegët lokalë, dhe i dyti është fakti që prezenca e thjeshtë e stafit të EULEX-it shërben si frenim për korrupsionin. Si shembull, korrupsioni në sektorin e doganave është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme që kur u bë dislokimi i EULEX-it. Doganierët e EULEX-it nuk disponojnë një mandate ekzekutiv, por fakti që ata punojnë në skuadër me doganierët kosovarë parandalon aktet korruptive.⁵⁹ Gjithsesi, ndodhi që EULEX-i, nëpërmjet mandatit të MMA-së, nuk ishte në gjendje të parandalonte situata emërimi në policinë kosovare, të influencuara nga nepotizmi apo lidhjet me partinë në pushtet,⁶⁰ por kohët e fundit, autoritetet kosovare kanë ftuar EULEX-in të monitorojë procedurat e rekrutimit për pozicionet drejtuese në institucionet që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, për të siguruar integritetin e procedurës dhe evitimim e episodeve të tilla, sikurse ndërhyrjet politike apo nepotizmi.⁶¹

Këto episode demonstrojnë se veprimtaria e EULEX-it për të luftuar korrupsionin, nuk është e mjaftueshme vetëm në kuadrin e MMA-së dhe përdorimi i fuqive ekzekutive është thelbësor. Kjo është veçanërisht e vërtetë për sistemin gjyqësor. Gjithsesi, gjykatësit dhe prokurorët punojnë nën një sistem mbrojtës të dobët dhe kjo shpjegon pse ata shpesh hezitojnë në menaxhimin e rasteve sensitive, kështu që, gjyqësori është pothuajse tërësisht i varur nga stafi ndërkombëtar i EULEX-it.⁶² Përdorimi i fuqisë ekzekutive dhe pasoja e saj në ndërtimin e vështirë të përgjegjësisë lokale është e balancuar në sektorin gjyqësor nga fakti se shpesh prokurorët kosovarë punojnë dyshe me kolegët e EULEX-it, ndërsa panelet e gjykatësve janë përherë të përzierë. Në këtë mënyrë, veprimtaritë e MMA-së, ndonëse në mënyrë jozyrtare, arrihen të zbatohen.⁶³ Kur ligjet mbi mbrojtjen e gjykatësve dhe prokurorëve do të zbatohen (sepse janë të listuar mes kushteve për nënshkrimin e Marrëveshjes

⁵⁹ Interview with Official H, *op. cit.*

⁶⁰ A. Mustafa, "Strengthening Rule of Law in Kosovo: The Fight against Corruption and Organised Crime", *KIPRED Policy Paper*, no. 8/2010, Pristina, November 2010, p. 19.

⁶¹ European Commission, *Joint Report on Kosovo's Progress*, *op. cit.*, p. 3.

⁶² *Ibid.*, p. 29.

⁶³ Interview with Official H, *op. cit.*

për Stabilizim-Asocimin)⁶⁴, do të mund të verifikohet një zhvendosje drejt një roli më të madh të veprimtarisë së MMA-së në gjyqësor.⁶⁵

Në misionet mbi sundimin e ligjit, veprimtaritë e MMA-së mund të sigurojnë një qëndrueshmëri afatgjate të reformave të promovuara. Në rastin e EULEX-it, dhe të sistemit të drejtësisë në veçanti, ato janë thelbësore në hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit. Thuhet se përgjegjësia e parë për të luftuar korrupsionin bie mbi institucionet kosovare, të cilat duhet të jenë të përgjegjshme ndaj qytetarëve.⁶⁶ Gjithsesi, përderisa personave të përfshirë në këto veprimtari nuk i garantohet siguria nga zbatimi i drejtë i kuadrit ligjor, EULEX nuk mund të planifikojë një strategji veprimi vetëm nën suazën e MMA-së.

4. EFEKTET NEGATIVE MBI QEVERINË E KOSOVËS DHE QYTETARËT

Një strategji komunikimi e gabuar u aplikua në një rast specifik në luftën ndaj korrupsionit, duke shkaktuar një rritje të pritshmërisë së popullatës për një ndryshim radikal në Kosovë. Këto pritshmëri nuk arritën të plotësoheshin. EULEX-i u përpoq t'i reduktonte perceptimet nëpërmjet një tjetër fushatë publike komunikimi, por, mes popullatës, nisi të zhvillohej perceptimi i ndjenjës së mosndëshkimit për disa episode të korrupsionit të nivelit të lartë.

Në 2010, EULEX-i rriti pritshmëritë për një ndryshim radikal mes popullit të Kosovës, pas valës së hetimeve për rastet e korrupsionit në Ministrinë e Telekomunikacionit dhe në Bankën Qendrore. Ideja e të ashtuquajturit “peshku i madh” që ishte gati për tu kapur, duhet të përballej me realitetin se hetimet kanë nevojë për kohë dhe se është goxha e vështirë të hetosh raste të nivelit të lartë.⁶⁷ Për të lehtësuar ndikimin e kësaj politike komunikimi të gabuar, EULEX-i adoptoi dy strategji: së pari, lançoi disa spote televizive ku, në vend që të shpjegonte vështirësitë në adresimin e korrupsionit të nivelit të lartë, transmetoi të dhëna mbi veprimtarinë aktuale.⁶⁸ Së dyti, ai përfshiu, në të njëjtën kohë, disa prej zyrtarëve të vet më të lartë në shpërhapjen e mesazhit se “*sundimi i ligjit nuk duhet matur thjesht nëpërmjet statistikave*”.⁶⁹

Pritshmëritë e paplotësuara mbi “peshkun e madh” kontribuan në rritjen e sensit të mosndëshkueshmërisë për rastet e korrupsionit të

⁶⁴European Commission, *Commission Communication on a Feasibility Study*, op. cit., p. 9.

⁶⁵Interview with Official F, op. cit.

⁶⁶A. Mustafa, op. cit., p. 23.

⁶⁷Interview with Official H, op. cit.

⁶⁸“EULEX is Doing Nothing to Fight High-Level Corruption”, EULEX, 12 June 2012, retrieved on 30 April 2013.

⁶⁹N. Hawton, “In Defence of EULEX”, *Pristina Insight*, Pristina, 13 April 2012, retrieved on 30 April 2013.

nivelit të lartë, në emër të stabilitetit politik në rajon, për të lehtësuar Dialogun Prishtinë-Beograd.⁷⁰

5. FAKTORË TË TJERË

Një nga arsytet pse “peshku i madh” nuk është kapur akoma ka të bëjë me kombinimin e normativës së Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe rregullores mbi rekrutimin e stafit ndërkombëtar. Kodi lejon hetimet për një periudhë deri në dy vjetare. Shpesh kaq kjo nuk është e mjaftueshme dhe, për të evituar ndërprerjen e hetimeve, dosjet përgatiten shumë kohë përpara lançimit të hetimeve zyrtare. Për sa i përket stafit ndërkombëtar, ata janë përzgjedhur shpesh për periudha kohore deri në dy vite dhe kjo ka pasoja dramatike për ndjekjen e hetimeve. Është goxha e rrallë që i njëjti person të ndjekë të njëjtën dosje nga hapja e saj (në mënyre informale) deri tek mbyllja zyrtare.⁷¹

Pavarësisht burimeve financiare dhe njerëzore të limituara, Kosova disponon një kuadër institucional shumë kompleks në luftën kundër korrupsionit,⁷² i cili mund të përkufizohet si një kombinim i institucioneve vendore (policia, prokuroria) dhe atyre ndërkombëtare (EULEX-i), me një prezencë të fortë të aktorëve institucionalë gjysmë të pavarur (sikurse Agjencia Antikorrupsion – AKA).⁷³ Një shembull konkret është rasti i mbikëqyrjes të prokurimeve publike, ku veprojnë tre institucione, duke rritur kështu kompleksin e përgjithshëm institucional, fragmentimin e përgjegjësive institucionale në sigurimin e integritetit, si dhe riskun potencial të korrupsionit.⁷⁴ Mungesa e koordinimit dhe shkëmbimit të informacioneve midis institucioneve gjithashtu përbën problem. Në fakt, disa prej tyre, si rasti i AKA-s, kanë firmosur *memorandume* bashkëpunimi me EULEX-in, por bashkëpunimi real nuk është aq intens, duke qenë se EULEX-i zhvillon hetime nëpërmjet Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës. Organizma të tjerë këshillues, si Zyra për Qeverisjen e Mirë, kanë kontakte me EULEX-in në kontekstin e promovimit të shtetit të së drejtës, por nuk përbëjnë një partner potencial në hetimin dhe ndjekjen e veprave të korrupsionit.⁷⁵

Strategjia e OJQ-ve kosovare konsiston në lobimin tek komuniteti ndërkombëtar në mënyrë që të veprojnë në emër të tyre, ndërsa ata

⁶⁸ S. Kursani, “A Comprehensive Analysis of EULEX: What Next?”, *KIPRED Policy Paper*, no.1, Pristina, January 2013, p. 26.

⁷¹ Interview with Official B, *op. cit.*

⁷² Interview with Official D, *op. cit.*

⁷³ M. Mustafa et. al., “Assessment of Institutional Integrity – Kosova 2011”, *Kosova Democratic Institute and Transparency International Kosova Report*, Pristina, 2011p. 88.

⁷⁴ European Court of Auditors, “European Union Assistance Related to the Rule of Law”, *Special Report*, no. 18, October 2012, p. 25.

⁷⁵ Interview with Official F., *op. cit.*

qëndrojnë jashtë politikës.⁷⁶ Ekziston tashmë një debat brenda EULEX-it mbi rolin e OJQ-ve dhe nëse ata mund të përfshihen më shumë në dialogim, duke patur parasysh rolin e tyre si mbikëqyrës të institucioneve kosovare. Gjithsesi, EULEX-i i jep prioritet dialogut me qeverinë, duke i lënë Komisionit përballjen me OJQ-të. Kjo bëhet për të evituar një dyfishim të aktiviteteve dhe gjithashtu sepse niveli qeveritar konsiderohet si ai ku ka më shumë punë për të bërë.⁷⁷ Në përgjithësi, marrëdhënia me OJQ-të nuk është idilike. Në fakt, kur EULEX-i u dislokua, ata kishin pritshmëri të lartë mbi të, për sjelljen e një ndryshimi thelbësor në Kosovë, veçanërisht falë pushtetit të tij ekzekutiv. Duke qenë se rezultatet dolën më të ulëta seç priteshin, OJQ-të nisën të kritikojnë rëndshëm EULEX-in për falimentim në prodhimin e rezultateve.⁷⁸

PËRFUNDIME

Ky punim tregoi që EULEX-i luan një rol në terma të ndikimit politik, sepse ai luan një rol thelbësor në Kosovë në hetimin dhe gjykimin e krimeve, që prekin direkt jetën publike të vendit: krimet e luftës dhe korrupsioni. Në rastin e krimeve të luftës, çështja është akoma e ndjeshme, sepse kujtesa e konfliktit të 1999 është ende e freskët dhe është e vështirë të pranosh se “heronjtë e luftës” janë “kriminelë lufte”. Kjo situatë mund të ketë një ndikim negativ mbi pavarësinë e gjykimeve. Hetimi dhe gjykimi i rasteve të korrupsionit implikon një sfidë me një nga strukturat mbi të cilat Kosova është bazuar dhe prek drejtpërdrejt interesat e personave në pushtet. Gjykatësit dhe prokurorët nuk gëzojnë një sistem mbrojtës nga kërcënimet dhe mund të jenë të luhatur në hetimin e disa dosjeve. Prezenca e EULEX-it është thelbësore për hetimin, asistimin e prokurorëve dhe në qenien pjesë e paneleve në rastet e veprave penale që, në të kundërt, nuk do të mund të menaxhoheshin në të njëjtën mënyrë. Për më tepër, nëpërmjet prezencës së stafit gjykues të EULEX-it tek gjykatat kosovare, gjykatësit dhe prokurorët kosovarë bëhen pjesë e një trajnimi ditor konstant mbi praktikën më të mira të BE-së në gjykata dhe kjo njohuri transferohet në hartimin e dokumenteve si Guida për një Kod të Procedurës Penale të Kosovës.

EULEX-i luan gjithashtu një rol të rëndësishëm si organ këshillues. Stafi operativ tek Ministria e Drejtësisë nxit hartimin e reformave për të siguruar zbatimin më të mirë të legjislacionit të nevojshëm në Kosovë, për t’iu përafëruar *acquis* së BE-së. Prezenca këshilluese e EULEX-it është gjithashtu thelbësore në përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë publikë, në mënyrë që të sigurojë që procedurat

⁷⁶ I. Briscoe, M. Price, *op. cit.*, p. 20.

⁷⁷ Interview with Official H, *op. cit.*

⁷⁸ Interview with Official C, *op. cit.*

respektojnë ligjin. Këto shembuj shërbejnë për të konfirmuar se EULEX-i ka një ndikim politik mbi autoritetet dhe institucionet kosovare, duke siguruar kështu një funksionim normal të drejtësisë dhe duke influencuar metodat e hartimit të politikave.

Shkrimi tregoi gjithashtu se ndikimi politik influencohet shumë nga perspektiva e zgjerimit, pavarësisht luhatjes së institucioneve kosovare në zbatimin e reformave.

Sikurse tregon rasti i luftës kundër korrupsionit, elitat në pushtet janë ato që humbasin më shumë nëse korrupsioni luftohet në mënyrën e duhur. Është pra legjitime të mendosh se ata nuk dëshirojnë vërtet të gjejnë një zgjidhje ndaj këtij problemi. Gjithsesi, kur perspektiva e hapjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit do të jetë më e prekshme, grada e bashkëpunimit të elitës me EULEX-in do të rritet, sepse Komisioni e ka parashtruar si kusht thelbësor për hapjen e negociatave.

Pra, mund të thuhet se EULEX-i ka një ndikim të fuqishëm mbi elitën kosovare, dhe kjo kryesisht falë faktit që EULEX-i është një prej instrumenteve të dislokuar në vend, në mënyrë që të bëjë të mundur perspektivën evropiane. Zgjerimi është motori kryesor për ndryshim në Kosovë.

Gjithsesi, EULEX-i është kritikuar shumë gjatë viteve të fundit dhe, që kur ai u dislokua, problemi i korrupsionit duket se është rritur, të paktën sipas perceptimit të popullatës. Për më tepër, një nga kritikant kryesore të misionit lidhet me kostot dhe performancën e tij të ulët.

Të intervistuarit janë dakord për faktin se këto kritika janë legjitime, sepse, përveç disa përjashtimeve, nuk ka patur hetime dhe gjykime të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Gjithsesi, ky gjykim është influencuar nga pritshmëritë tepër të larta që rrethuan misionin, si në Bruksel ashtu edhe në Prishtinë. Një nga të intervistuarit sugjeroi që sukcesi nuk duhet të matet me shifra, por në ndryshimin e sjelljeve të kosovarëve, ndaj një etjeje më të madhe për të pranuar parimet themelore të shtetit të së drejtës.⁷⁹

EULEX-i u dislokua në një kontekst tepër të vështirë, dhe në praktikë, iu desh të ndërtonte institucionet e shtetit të ri, ku korrupsioni praktikohet në të gjitha nivelet e shoqërisë. Ai ishte i pari mision me atë numër personeli dhe kompetenca, dhe për këtë arsye, nuk ekzistonin ende 'praktika të mira' për tu zbatuar. Më saktë, ishte një situatë e 'të mësuarit duke punuar' (learning by doing). BE-ja beri një gabim të madh duke adoptuar një retorikë të tillë, që shkaktoi një rritje të pritshmërive mbi një ndryshim të shpejt dhe të qëndrueshëm në Kosovë, kur në fakt nuk ishte pikërisht rasti i tillë.

⁷⁹Interview with Official D, *op. cit.*

Sikurse Ginsberg dhe Penksa thonë, nëse suksesi i një misioni për sundimin e ligjit mund të matet në terma të ndryshimit të mentalitetit të elitës në pushtet, disa shenja të mira janë shfaqur. Në mars 2013 Kuvendi propozoi krijimin e një komisioni hetues për rihapjen e një rasti krimi lufte të gjykuar nga Gjykata Supreme.⁸⁰ Kjo përbënte haptazi një ndërhyrje të pushtetit legjislativ në fushën e gjyqësori dhe, falë presionit të EULEX-it, propozimi ra. Kjo tregon se kultura e sundimit të ligjit po ndërtohet me hapa të ngadaltë në Kosovë.

Për të arritur në një ndryshim të qëndrueshëm, nevojitet një ndryshim i mentalitetit të popullsisë. Për sa i përket korrupsionit, niveli i ulët i korrupsionit është po aq i përhapur sa edhe ai i nivelit të lartë. Shkëmbimi i favoreve është praktikë e përditshme për të patur akses tek shërbimet thelbësore, si p.sh. shëndetësia. Problemi është se këto sjellje të veçanta nuk perceptohen si 'korrupsion'. Vetëm kur ky perceptim do të ndryshojë, atëherë do të ketë qëndrueshmëri të reformave të promovuara nga BE-ja.

BE-ja duhet të përballohet me dy sfida për të krijuar një qëndrueshmëri të reformave në Kosovë: e para, është krijimi i një kulture të sundimit të ligjit në të gjitha nivelet e shoqërisë, dhe e dyta, është krijimi i një sistemi gjyqësor funksional.

Sfida e parë varet nga Komisioni Evropian. Nëpërmjet programeve dhe financimeve të tij, ai duhet të investojë për të rritur ndërgjegjshmin e popullsisë. Do të jetë më e lehtë në të ardhmen sepse, në 2012, nisën negociatat për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së.⁸¹ Në veçanti, programet e adresuara ndaj rinisë do të jenë një instrument i rëndësishëm në dispozicion të BE-së për të krijuar një ndërgjegjësim afatgjatë.

Sfida e dytë varet tërësisht nga EULEX-i. Suksesi përfundimtar i misioni dhe i veprimtarisë së dy sektorëve të tjerë varet nga kapaciteti i prokurorëve në hetimin dhe në elaborimin e akuzave në mënyrë të pavarur dhe nga gjykatësit në shpalljen e verdiktit pa influencim nga jashtë. Për të arritur këtë rezultat, shumë aksione duhet të merren: Qeveria e Kosovës duhet të adoptojë dhe zbatojë të gjithë legjislationin e nevojshëm për krijimin e një ambienti të sigurt pune për gjykatësit dhe prokurorët; një nga rrënjët e korrupsionit – pagat e ulëta – duhet të çrrënjohet (profesioni konsiderohet si shumë i rrezikshëm, plus përballimi me një rrogë të ulët); duhet të rritet intensifikimi i trajnimeve të gjykatësve dhe prokurorëve, në linjë me praktikën më të mira evropiane. Në momentin që këto elemente do të

⁸⁰ M. Brajšori, "Kosovo Parliament Withdraws from Court Case Involvement", *SETimes*, Pristina, 28 March 2013, retrieved on 4 May 2013.

⁸¹ European Commission, *Proposal for a Council Decision on the Conclusion of a Framework Agreement between the EU and Kosovo on the General Principles for the participation of Kosovo in Union Programmes*, COM(2013) 219 final, Brussels, 22 April 2013, p. 2.

vendosen në praktikë, EULEX-i do të jetë në gjendje të reduktojë mandatin e tij ekzekutiv dhe gradualisht të lërë përgjegjësitë në dorë të kosovarëve.

Fundi i pavarësisë së mbikëqyrur konsiderohej nga elita dhe popullsia si një rast për të marrë në dorë të gjitha përgjegjësitë e menaxhuara nga komuniteti ndërkombëtar. Kjo situatë e re përbën një provë për qeverinë për ti demonstruar qytetarëve se mund të përmirësojë mirëqenien e tyre, dhe duke qenë se nuk ka më një prezencë ndërkombëtare për tu fajësuar, të marrin mbi vete të gjithë përgjegjësinë në rast të arritjes së rezultateve të dobëta.

BIBLIOGRAFIA

“EULEX Does Not Fix Our Everyday Lives”, *EULEX*, retrieved on 30 April 2013.

“EULEX is Doing Nothing to Fight High-Level Corruption”, *EULEX*, 12 June 2012, retrieved on 30 April 2013.

“Interviewing Witnesses: MMA in Practice”, *EULEX*, 24 August 2011, retrieved on 30 April 2013

A. Gardner, “Landmark Deal Opens the Door to the EU”, *European Voice*, vol. 19, no. 16, 25 April 2013.

A. Mustafa, “Strengthening Rule of Law in Kosovo: The Fight Against Corruption and Organised Crime”, *KIPRED Policy Paper*, no. 8/2010, Pristina, November 2010.

C. Fagan, “EU Anti-Corruption Requirements: Measuring Progress in Albania, Kosovo, FYR Macedonia and Turkey”, *Transparency International Report*, Berlin, June 2011.

C. Gourlay, “The Politics of EU Strategic Interventions and the Strategic Deficit of CSDP”, ISIS “Communicate, Coordinate, and Cooperate” Papers, Brussels, October 2011.

Council of the EU, “Council Joint Action (2008/124/CFSP) on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo”, *Official Journal of the European Union*, L42, 16 February 2012.

EULEX Kosovo, *EULEX Assists an Extradition Process*, Pristina, 20 December 2012, retrieved on 30 April 2013.

EULEX Kosovo, *EULEX Mission Extended Until June 2016*, Pristina, 6 June 2014, retrieved on 18 April 2013.

European Commission, DG Enlargement, *Chapters of the acquis*, retrieved on 28 April 2013.

European Commission, *Joint Report on Kosovo’s Progress in Addressing Issues set out in Council Conclusions of December 2012 in View of a Possible Decision on the Opening of the Negotiations on the Stabilization and Association Agreement*, JOIN(2013) 8 final, Brussels, 22 April 2013.

- European Commission, *Proposal for a Council Decision on the Conclusion of a Framework Agreement between the EU and Kosovo on the General Principles for the participation of Kosovo in Union Programmes*, COM(2013) 219 final, Brussels, 22 April 2013.
- European Commission, *Visa Liberalization with Kosovo Roadmap*, Brussels, 14 June 2012.
- European Court of Auditors, "European Union Assistance Related to the Rule of Law", *Special Report*, no. 18, October 2012.
- European Union, Statement by President Barroso Following his Meeting with Hashim Thaçi, Prime Minister of Kosovo, SPEECH11/360, Pristina, 20 May 2011, retrieved on 28 April 2013.
- F. Martino, "Atifete Jahjaga, una Poliziotta alla Guida del Kosovo", *Osservatorio Balcani e Caucaso*, 8 April 2011, retrieved on 2 May 2013.
- I. Briscoe, M. Price, "Kosovo's New Map of Power: Governance and Crime in the Wake of Independence", *Clingendael Institute*, The Hague, May 2011.
- M. Brajshori, "Kosovo Parliament Withdraws from Court Case Involvement", *SETimes*, Pristina, 28 March 2013, retrieved on 4 May 2013.
- M. Mustafa et. al., "Assessment of Institutional Integrity – Kosova 2011", *Kosova Democratic Institute and Transparency International Kosova Report*, Pristina, 2011.
- M. Spornbauer, "EULEX Kosovo – Mandate, Structure and Implementation: Essential Clarifications for an Unprecedented Mission", *CLEER Working Paper*, no. 5, 2010, The Hague.
- N. Hawton, "In Defence of EULEX", *Pristina Insight*, Pristina, 13 April 2012, retrieved on 30 April 2013.
- R. H. Ginsberg, S. E. Penksa, *The European Union in Global Security. The Politics of Impact*, Houndmills Basingstoke, Palgrave, 2012.
- Republic of Kosovo, "Chapter VII – Final Provisions, Art. 143", *Constitution of the Republic of Kosovo*, Pristina, 15 June 2008, p. 55.
- Republic of Kosovo, Assembly, *Declaration of Independence*, Pristina, 17 February 2008.
- S. Kursani, "A Comprehensive Analysis of EULEX: What Next?", *KIPRED Policy Paper*, no.1, Pristina, January 2013.
- Transparency International, *Corruption by Country: Kosovo*, retrieved on 18 April 2013.

**DOKUMENTET STRATEGJIKE TË VENDEVE
TË BALLKANIT PERËNDIMOR
Analizë krahasuese**

Një nga testet e rëndësishme për demokracinë e vendeve në tranzicion është niveli i dokumenteve të tyre strategjiko-doktrinerë. Duke analizuar numrin e tyre, hierarkinë, institucionet e përfshira në përgatitjen e tyre, informimin e publikut (përpara se këto dokumente të jenë miratuar) dhe sidomos, përmbajtjen e tyre, mund të nxirren përfundime për këto vende që shkojnë përtej sigurinë e mbrojtjes.

Në nivelin bazë, thjesht ekzistenca e këtyre dokumenteve flet indirekt nëse gjenerata e parë e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS) ka përfunduar dhe nëse është vendosur një mbikëqyrje demokratike efektive për të gjithë institucionet e sigurisë. Gjithashtu, ata tregojnë se si elita politike e koncepton nevojën për një dialog gjithëpërfshirës me publikun e gjerë për çështje esenciale të vendit. Rëndësia që i është dhënë miratimit të këtyre dokumenteve, në përshtatje me standardet demokratike, si dhe hierarkisë së tyre, tregon sa është kuptuar nevoja për to. P.sh, nëse ato janë miratuar në të njëjtën kohë, me procedura të përsheptuara, pa kaluar në institucionet e duhura, ka të ngjarë që institucionet përgjegjëse thjesht po përpiqen të kenë “ambalazhin” e një vendi demokratik (në këtë fushë).

Pavarësisht nga vlera, një analizë e tillë për vendet e Ballkanit Perëndimor është e vështirë. Procesi i reformave në to po ndodh për shkak të shtytjes dhe influencës së komunitetit ndërkombëtar. Është e paqartë nëse ato do të mbeteshin në të njëjtin kurs pa këtë presion. Statusi gjeopolitik i rajonit është gjithashtu një problem. Dhjetë vjet pas konfliktit të fundit në rajon, jo të gjitha kufijtë janë të qartë, statusi i Kosovës është ende i diskutueshëm, e ardhmja e Bosnjë-Hercegovinës (BiH) mbetet e zymtë, ndërsa Maqedonia nuk është më pranë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Greqinë.

Përpjekjet për të zbuluar dhe analizuar tendencat e reja në sektorët e sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe nivelin e tyre të demokratizimit, nëpërmjet analizës krahasuese të dokumenteve kryesore strategjike arsyetohet në disa nivele: së pari, vendet e rajonit kanë pasur përvoja të ngjashme paqëndrueshmërie dhe krizash në dekadën e fundit të shekullit XX dhe një proces

¹ Autori është diplomuar për shkenca politike nga Universiteti i Beogradit dhe për gradën “Master” nga Kolegji i Europës (Bruges, Belgjikë). Ka punuar si studiues për problemet e sigurisë në një numër institucionesh jo qeveritare në Beograd. Aktualisht punon me projektin e OSBE-së për reformat në Sektorin e Sigurisë në Serbi.

stabilizimi të ngadalshëm në fillim të shekullit të ri; së dyti, koha për krijimin e strategjive të reja ishte pothuaj e njëjtë (në dhjetë vitet e fundit); së treti, reagimi i këtyre vendeve ndaj shtytjes së komunitetit ndërkombëtar (sidomos nga BE) për bashkëpunim rajonal, sinqeriteti i tyre dhe gatishmëria për të bashkëpunuar janë tregues se sa ato kanë lëvizur nga "mbeturinat" e se shkuarës së zymtë, prezente deri pak vite më parë. Analiza fokusohet vetëm në dokumentet kryesore strategjike të sigurisë.

KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM

Njëzet vjet pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe fillimit të luftërave për trashëgiminë e Jugosllavisë, rajoni i Ballkanit është i konsoliduar në kuptimin e sigurisë. Kjo do të thotë se nuk ka kërcënim imediat për një konflikt masiv të armatosur. Vakumi i sigurisë që u krijua nga shpërbërja e sistemit të kaluar dhe Jugosllavisë, si mbetje e atij sistemi, pothuajse është mbushur. Megjithatë, rajoni mbetet më shumë i ndarë se i bashkuar (politikisht por jo vetëm). Së dyti, problemi i Kosovës ende nuk është zgjidhur. Së treti, trashëgimia e konflikteve është ende e dukshme në bashkëpunimin rajonal dhe në marrëdhëniet midis shteteve (edhe pse në nivele të ulëta ka shembuj të mirë bashkëpunimi²). Së katërti, vendet e Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme të integritetit euro-atlantik: Kroacia do të bëhet anëtare e BE-së në 2012 apo 2013; Maqedonia ka qenë kandidat që nga viti 2005 (por nuk ka filluar negociatat akoma); Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia kanë paraqitur kandidaturat e tyre dhe ndoshta do të bëhen kandidatë për 1-2 vite, ndërsa BiH duhet të bëhet një shtet plotësisht funksional para se të arrijë këtë stad. Së fundi, Kosovës i është dhënë një perspektivë e fortë Evropiane, por duhet të zgjidhet më parë e në mënyrë definitive statusi i saj.

E njëjta paqartësi ekziston edhe në aspektin e integritetit në fushën e sigurisë. Shqipëria dhe Kroacia janë tashmë anëtarë të NATO-s. Anëtarësimi i Maqedonisë pengohet nga Greqia, ndërkohë që Asambleja Kombëtare e Serbisë ka shpallur neutralitetin ushtarak. Bosnja dhe Mal i Zi kanë ambicie të forta për anëtarësim në NATO (të dyja janë pranuar në procesin e "Planit të Veprimit për Anëtarësim") por kapacitete të dobëta demokratike (të paktën BiH), ndërsa NATO-ja është forca kryesore e sigurisë në Kosovë.

Për sa më sipër, vështirë të thuash se Ballkani Perëndimor është një rajon me të vërtetë i unifikuar për nga politikat e sigurisë. E gjithë kjo vjen nga fakti se elitat politike dhe shoqëritë që ato përfaqësojnë, nuk i interpretojnë ende bazat e sigurisë në mënyrë të ngjashme. Në to mungon një nocion sigurie që të përfshijë gjithë rajonin. Së fundi,

² Bashkëpunimi policor midis Serbisë dhe Kroacisë është një shembull i tillë.

elitat politike në rajon nuk janë ende në gjendje për të përcaktuar, strukturuar dhe prioritarizuar politikat e veta të sigurisë.

KRIJIMI DHE GJENDJA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Dokumentet strategjike dhe doktrina të vendeve të Ballkanit Perëndimor u përpiluan të gjitha në dekadën e parë të shekullit të XXI. Dhjetë vitet e para pas shpërbërjes së Jugosllavisë u karakterizuan nga luftërat për trashëgiminë dhe krijimin e shteteve të reja. Këto shtete ishin më të preokupuara me planet e luftës, varfërinë në rritje dhe sanksionet e imponuara nga bashkësia ndërkombëtare se sa për t'i kushtuar vëmendje krijimit e konsolidimit të kuadrit të sigurisë. Në anën tjetër, udhëheqësit autoritarë të tyre, nuk e patën prioritet kuadrin e sigurisë. Ata mendonin se e dinin më mirë se kushdo tjetër se si t'u përgjigjeshin çështjeve kryesore të sigurisë, ose nuk donin diskutimin parimor të çështjeve të tilla që mund të ngjallnin debate të padëshiruara për statusin e shtetit të ri, ose të sundimit të tyre, përgjithësisht autoritar. Nga ana tjetër, Shqipëria u përball me varfëri të madhe dhe rebelim politik në vitin 1997, që shkaktoi rënien e institucioneve shtetërore dhe atyre të sigurisë. Këto ishin arsye të përpjekja e parë serioze për shkrimin e dokumenteve strategjike nuk ndodhi deri në vitin 1999 (ku e para ishte Maqedonia).

Midis viteve 2000 e 2006, praktikisht të gjitha vendet e rajonit kishin dokumentet e parë strategjike të tyre. Shqipëria miratoi dokumentin e parë strategjik, në vitin 2000, i cili u rishikua disa herë (rishikimi i fundit në vitin 2007³). Strategjia e Mbrojtjes u miratua në vitin 2000 dhe u rishikua disa herë më pas, rishikimi i fundit ndodhi në vitin 2007.⁴ Së fundi, Strategjia Ushtarake u miratua në vitin 2002 dhe u rishikua në vitin 2005⁵, ndërsa Libri i Bardhë për Mbrojtjen, u publikua në vitin 2005.

Në BiH, e ashtuquajtura Politika e Mbrojtjes u miratua në vitin 2001, Doktrina Ushtarake në vitin 2003, ndërsa Politika e Sigurisë, në vitin 2006. Rishikimi i Mbrojtjes është në proces dhe pritet të miratohet para zgjedhjeve të Tetorit.

Kroacia e miratoi SSK-në dhe Strategjinë e Mbrojtjes në të njëjtën ditë, në vitin 2002. Një vit më vonë, u miratua Strategjia Ushtarake, ndërsa Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes u miratua në vitin 2005.

Maqedonia miratoi Strategjinë e Mbrojtjes në vitin 1999 (u amendua në Shkurt 2010), pastaj miratoi Konceptin për Sigurinë Kombëtare dhe Mbrojtjen si dhe Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes në

³ Në fakt ripunimi i fundit i SSK-së është në vitin 2004.

⁴ Bëhet fjalë për "Politikën e Mbrojtjes", pjesë e SSK që u miratua në vitin 2004.

⁵ Në fakt, pas versionit të vitit 2005, Strategjia Ushtarake e RSH është ripunuar sërish dhe miratuar në vitin 2007.

vitin 2003, ndërsa Librin e Bardhë për Mbrojtjen në vitin 2005. Së fundi, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare e ka miratuar në 2008. Në rastin e Maqedonisë, është një tjetër dokument që duhet marrë në konsideratë si pjesë e dokumenteve strategjike - Marrëveshja Kuadër e Ohrit, e cila u nënshkrua në Gusht 2001 dhe krijoi kushtet për t'u dhënë fund luftimeve mes pakicës etnike shqiptare dhe shumicës sllave në vend. Ky dokument "[...] ka përfshirë një numër dispozitash për çështjen e sigurisë dhe mbrojtjes [...] të cilat kanë ndikuar politikat e sigurisë në vend" (Yusufi, 2010).

Rasti i Serbisë dhe Malit të Zi është disi i veçantë, për shkak të përpjekjeve, së pari, për të mbajtur gjallë Federatën (pas rënies së Millosheviçit) dhe më pas, Unionin (që përbëhej prej këtyre dy republikave, pavarësisht nga mungesa e dukshme e interesit për këtë, të paktën nga njëra anë). Kjo beri që të dy vendet të përfundonin kuadrin e tyre strategjik vetëm pas "shpërbërjes së kadifenjtë" të Unionit (2006). Mali i Zi miratoi versionet e vet të para të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë së Mbrojtjes, vetëm pak muaj pas pavarësisë, në vitin 2006, ndërsa versionet e përmirësuara u miratuan dy vjet më vonë, në fund të vitit 2008. Serbia, nga ana tjetër, ka pasur vonesa edhe më të mëdha në miratimin e dokumenteve të veta të sigurisë për shkak të trazirave politike të shkaktuara nga shpallja e pavarësisë prej krahinës së Kosovë-Metohisë dhe të perceptimeve të ndryshme për sigurinë që patën partitë politike kryesore. Kjo është arsyeja pse u deshën tre vjet për të miratuar Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë e Mbrojtjes (fundi i 2009). Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (i përfunduar në 2006) u rishikua e miratua në vitin 2009.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Kosovës është duke u përgatitur. Kuadri i saj strategjik dhe doktrinor deri tani është kufizuar nga paqartësia e statusit politik dhe, në një farë mase, mosgatishmëria e komunitetit ndërkombëtar për t'u dorëzuar plotësisht strukturave kosovare të drejtën e marrjes së vendimeve të rëndësishme politike dhe strategjike. Nga ana tjetër, mbrojtja e Kosovës është ende përgjegjësi e forcave të NATO-s, dhe do të mbetet e tillë për një farë kohe në të ardhmen.⁶

⁶ Kosova nuk do të jetë shumë e pranishme në këtë studim, për arsyet e mësipërme dhe për faktin që nuk ka ende kuadrin e vet strategjik-doktrinor.

Dokumentet e strategjive të sigurisë e mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor

Shqipëria	BiH	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2004)	Politika e Sigurisë (2006)	Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2002)	–	Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2008)	Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2008)	Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2009)
Strategjia Ushtarake (2007)	Politika e Mbrojtjes (2008)	Strategjia e Mbrojtjes (2002)	–	Strategjia e Mbrojtjes (2010)	Strategjia e Mbrojtjes (2008)	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes (2009)
–	Rishikimi i Mbrojtjes (për t'u aprovuar mes-2010)	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (2005)	–	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes – Kuadri Politik (2003)	–	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (2009)

Duke filluar nga titujt, dokumentet strategjike të vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë disa ngjashmëri. Dokumenti që qëndron më lart në hierarkinë e dokumenteve strategjike, në të gjitha vendet, është Strategjia e Sigurisë Kombëtare, megjithëse nuk ka qenë kështu që në fillim (në Maqedoni, Koncepti i Sigurisë Kombëtare dhe Mbrojtjes, që u zëvendësua me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare).⁷ Përveç këtij dokumenti superior, të gjitha vendet posedojnë edhe dy lloje të tjera dokumentesh: strategjia ushtarake ose e mbrojtjes dhe Libri i Bardhë ose Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes.

Disa nga këto dokumente janë në rishikim tashmë. Ndryshimet e shpejta dhe të vazhdueshme në sektorët politikë dhe të sigurisë të këtyre vendeve, mund të jenë një shpjegim për këtë trend ndryshimesh, por ka me shume mundësi që, të paktën në fillim, krijimi i kuadrit të sigurisë ka qenë diçka “e panjohur” për elitat politike, prandaj ato janë përpjekur të kopjojnë nga demokracitë e zhvilluara perëndimore. Kjo kohë “përzgjedhjeje” mund të kishte përfunduar më shpejt, duke krijuar gjeneratën e dytë e ndoshta edhe të tretë të këtyre dokumenteve. Nga ana tjetër, ngjashmëria e titujve të dokumenteve strategjike mund të tregojë që shumica e këtyre vendeve, pavarësisht dallimeve të brendshme, kanë zgjedhur modele të njëjta ose të përafërta dokumentesh strategjike, për t'i kopjuar ose adoptuar për nevojat e veta të sigurisë.

⁷ Përfashtim bën BiH e cila ka Politikën e Sigurisë.

HARTIMI DHE MIRATIMI I DOKUMENTEVE

Edhe mënyra sesi strategjitë dhe doktrinat e vendeve të Ballkanit janë hartuar dhe miratuar, është një tregues i rëndësishëm i nivelit të demokracisë së tyre. Së pari, shkalla në të cilën aktorët ndërkombëtarë janë përfshirë në hartimin e këtyre dokumenteve flet për kapacitetet e vendit për të marrë vendime të pavarura për të ardhmen e vet. Gjithashtu, një analizë më e sofistikuar mund të qartësojë marrëdhëniet midis palëve kryesore të përfshira në procesin e shkrimit dhe miratimit të këtyre dokumenteve (Presidenti; Qeveria - në veçanti Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme; Parlamenti). Një tjetër përfundim i rëndësishëm, që mund të nxirret, ka lidhje me qëndrimin e elitës politike ndaj shoqërisë civile. Nëse ajo është përfshirë në procesin e hartimit, ose të paktën i është dëgjuar mendimi, mund të supozojmë marrëdhënie të shëndetshme partneriteti. E kundërta, përgatitja e dokumenteve "prapa dyerve të mbyllura", nënkupton komunikim të dobët dhe mungesë besimi të ndërsjellët (ndonjëherë edhe konfrontim).

Vendet e rajonit, pa përjashtim, kishin detyrën e vështirë të tregonin qasjen e tyre demokratike gjatë këtij procesi. Një shembull spikatës në lidhje me hapin e parë, hartimi i strategjive, është Kroacia. Një ide e shkëlqyer për të krijuar një organ të pavarur, për të shkruar SSK-në, i cili shpenzoi një vit e gjysme për të, u braktis. Përfundimisht atë e shkroi brenda disa javësh, një grup i vogël me përfaqësues nga disa ministri.

Rasti i Serbisë tregoi nevojën e një konsensusi të gjerë të paktën midis eliteve, për të shkruar e miratuar një strategji sigurie. Gjatë periudhës së "bashkëjetesës" President – Kryeministër (2006-2007) u krijuan dy grupe pune të cilët prodhuan dy dokumente. Ata dhanë ide të ndryshme dhe madje (në disa raste) kundërshtuese, mbi vendimet e rëndësishme strategjike ndaj vetë-shpalljes së pritshme të pavarësisë së Kosovës dhe çështjeve të tjera të sigurisë. Kjo përplasje mund të ishte shmangur nëse në Kushtetutë do të kishte klauzola të qarta për kuadrin strategjik dhe procedurat për krijimin e tij. Vetëm kur u deklarua qartë përgjegjësia e Ministrisë së Mbrojtjes për hartimin e dokumentit dhe e Parlamentit për miratim, ky problem u zgjidh në mënyrën e duhur (me gjithë vonesën e madhe).

Rëndësi merr edhe roli i bashkësisë ndërkombëtare (e pranishme në rajon, me formë e struktura të ndryshme, që nga fillimi i konflikteve njëzet vjet më parë) në procesin e hartimit të dokumenteve të sigurisë të këtyre vendeve. Konsulentë dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare sollën përvojën e tyre nga rajone të tjera post-konflikt dhe (megjithëse jo fort e përshtatshme) u përpoqën ta zbatonin në Kosovë, në BiH, pas përfundimit të luftës, në Shqipëri pas rënies së strukturave shtetërore në 1997 dhe, në një farë mase, në Maqedoni, në trazirat e vitit 2001. Marrëveshja e

Dejtonit (për BiH), marrëveshja e Ohrit (për Maqedoninë) dhe plani i Ahtisarit (për Kosovën) janë sot të njohura jo vetëm si dokumente që i dhanë fund një lufte, një armiqësie, apo një situatë bllokuese, por edhe si dokumentet e para strategjike për këto vende. Problemi në raste të tilla është se jepen zgjidhje parimore pa ndërtuar kapacitetet e duhura të vendit përkatës për zbatimin e tyre.

Forca lëvizëse për krijimin e kornizës strategjike-doktrinale të të gjitha vendeve të rajonit është padyshim perspektiva e anëtarësimit në BE dhe NATO. Kjo po nxit vendet për të bërë reforma në shoqëritë e tyre, në ekonomitë, madje, në një farë mase për të krijuar vlera krejt të reja. Prandaj, politika e NATO-s e "dyerve të hapura" dhe një deklaram i qartë i BE, që të gjitha vendet e këtij rajoni kanë perspektivë për anëtarësim (me kusht që të përmbushin standardet e nevojshme) kanë qenë me rëndësi të madhe edhe për sektorin e sigurisë dhe do të jenë thelbësore edhe në vitet e ardhshme.

Çështja e autoritetit për miratimin e dokumentit strategjik e rrit ose e ul legjitimitetin dhe mund të ndikojë në jetëgjatësinë e dokumentit. Megjithatë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë shpallur sisteme parlamentare apo gjysmë-presidenciale, nëse nuk është parlamenti që thotë fjalën e fundit, kjo do të thotë që populli nuk ka pasur zë (nëpërmjet përfaqësuesve të vet, të gjithë të zgjedhurit, jo vetëm nomenklatura në pushtet) ndërsa dokumenti është përgatitur vetëm nga Ekzekutivi (qeveria). Kështu, ai nuk është më "dokumenti i vendit" dhe "për vendin", por deri diku, një letër që shpreh pikëpamjet dhe dëshirat e partisë/partive në pushtet në një periudhë të veçantë. Ky ishte rasti me përpjekjen e parë të Malit të Zi për dokumentet strategjike (2006), ku Ministria e Mbrojtjes u ngarkua me hartimin e dokumentit i cili u miratua vetëm nga Qeveria. Kjo u korrigjua në përpjekjen e dytë, për rishikimin e SSK-së dhe Strategjisë së Mbrojtjes në vitin 2008. Megjithatë, përveç rastit të Bosnjës⁸, ky shembull është një përjashtim më tepër se sa një rregull. Vendet e tjera, pranojnë rastet kur, p.sh, Ministria e Mbrojtjes harton politikën e sigurisë e mbrojtjes pa u konsultuar me pjesën tjetër të Qeverisë apo me Parlamentin, si një përjashtim (megjithëse jo gjithnjë është e qartë se në cilat raste aplikohet).

Për çështjen e miratimit studiuesit ndahen. Disa prej tyre e konsiderojnë të drejtën e parlamentit për miratimin e dokumenteve strategjike si "*të palogjikshme*", me arsyetimin se kjo "*ia ul kredibilitetin Ekzekutivit*" dhe "*e bën Parlamentin impotent*" nëse më vonë shfaqen probleme me përmbajtjen e dokumenteve strategjike" (Mahecic, 2010). Prandaj propozojnë që parlamenti të japë mendim për to, ndërsa miratimi të bëhet nga Presidenti ose Kryeministri.

⁸ Veçoria e sistemit politik mbi baza etnike në BiH, e bën të pamundur çdo analizë serioze të marrëdhënieve midis autoriteteve të ndryshme.

Nëse kompetencat e parlamentit në këtë çështje reduktohen vetëm për të dhënë mendim, lind problemi që institucionet ekzekutive do të marrin të drejtën të përpilojnë dokumentet strategjike të vendit pa pëlqimin e popullit (të përfaqësuesve të tij në Parlament). Nga ana tjetër, nuk është e qartë çfarë do të thotë "jo-ja" e parlamentit. A do të jetë kjo detyruese për Ekzekutivin? Mendimi ynë është që dokumentet kryesore strategjike, përjashtuar ato doktrinale, të miratohen në Parlament, ndërsa nga ana hierarkike, për vetë rëndësinë që kanë, ato të vijnë menjëherë pas Kushtetutës.

Një nga sfidat kryesore në krijimin e kuadrit strategjik-doktrinor në vendet e Ballkanit Perëndimor, ende e pazgjidhur, ka të bëjë me kompetencat e hartuesve të tyre. Siç është shpjeguar tashmë, me gjithë kontributin e bashkësisë ndërkombëtare për krijimin e kapaciteteve vendore për të marrë në dorë procesin e hartimit të dokumenteve strategjike, ato mbeten të dobëta, me përjashtim (në një farë mase) të Serbisë dhe Kroacisë. Një tjetër problem që ndeshet shpesh me stafet e trajnuara është politizimi i tyre, dhe si rrjedhojë, duke qenë pjesë e administratës publike, bëhen objekt i ndryshimeve të shpeshta të administratës. Asnjë nga vendet e rajonit nuk e ka fituar shkallën e nevojshme të ndërgjegjësimit, se hartimi i dokumenteve më të rëndësishëm të vendit është një çështje që shkon përtej falë interesave të ditës. Nga ana tjetër, është e dyshimtë nëse vetë qeveritë në Ballkan janë kompetente për të vendosur e zbatuar politikat e sigurisë, ose për të ndryshuar ritmin apo drejtimin e reformave të sigurisë.

E fundit, por jo për nga rëndësia, është çështja e nivelit të përfshirjes së medias, qarqeve akademike dhe organizatave të shoqërisë civile në hartimin e dokumenteve strategjike. Shembulli më i mirë është Maqedonia, me të ashtëquajturin "Procesi 2002", të iniciuar nga Presidenti i atëhershëm i vendit. Ky është rasti i vetëm në rajon, ku u organizua një seri tryezash të rrumbullakëta me *"autoritetet përkatëse qeveritare e jo qeveritare, kombëtarë e ndërkombëtarë, për të diskutuar çështje të sigurisë [...] që më vonë shërbeu si bazë [...] në hartimin e dokumenteve strategjike"* (Yusufi, 2010). Një proces i ngjashëm ndodhi në Kroaci, por, siç u shtjellua më lart, me rezultat përfundimtar të dobët. Asnjë nga qeveritë e vendeve të tjera të rajonit nuk ka treguar ndonjë qëllim deri tani për të përfshirë publikun në procesin e hartimit. Në fakt kanë bërë të pamundurën për të mbajtur të tjerët larg e shmangur dhënien e mendimeve, bile edhe pasi dokumentet janë hartuar. Shembulli më i spikatur ka ndodhur në Serbi, kur qeveria publikoi projektet e SSK-së dhe Strategjisë së Mbrojtjes dhe ftoi publikun për diskutim, gjatë Krishtlindjeve dhe festave të Vitit të Ri (2009). Më shumë se një gabim administrativ, kjo ishte një përpjekje e qëllimshme për të shmangur çdo kritikë publike apo diskutim serioz. Megjithatë, presioni

nga disa dhjetëra OJQëve bëri që diskutimi të shtyhej për një muaj, gjë që pati një farë vlere. Për sa i përket Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës, nuk ka pasur kurrë konsulta me publikun e interesuar gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strategjive. Një shpjegim i çalë ka qenë mungesa e ekspertizës për një vlerësim cilësor të këtyre strategjive. Në fakt, më pranë të vërtetës, është arsyeja që qeveritë e këtyre vendeve, nuk kane dashur që dikush tjetër të jetë i përfshirë në proces, gjë që e de-legjitimizon vetë procesin dhe flet edhe për kulturën demokratike të vendit.

HIERARKIA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Miratimi i dokumenteve strategjike dhe doktrinare, sipas një radhe të drejtë, tregon pjekurinë e elitës politike dhe të kuptuarit nga ana e saj të rëndësisë që ka kompletimi si duhet i kuadrit strategjik doktrinor. Në krye dhe e para për t'u hartuar, duhet të jetë SSK-ja, ndërsa të gjithë dokumentet e tjerë, që vijnë më pas, duhet të varen prej saj e të jenë në linjë me të. Nevoja për miratimin së pari të SSK-së qëndron në faktin se ajo jep kuadrin për gjithë të tjerat. Në këtë aspekt, politikanët e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë treguar se, të paktën në fillim të këtij procesi, kanë dashur të fitonin "kredencialet" demokratike, thjesht duke adoptuar strategjitë. Kështu ata kanë nxituar për t'i përfunduar ato sa më shpejt, pa i kushtuar vëmendje hierarkisë. Kjo është arsyeja pse shumica e dokumenteve strategjike mbivendosen në përmbajtjen e tyre, përdorin formulime të njëjta ose, ca më keq, thjesht kopjojnë përmbajtjen e njëri-tjetrit (sidomos sfidat, rreziqet, kërcënimet).

Asnjë nga këto vende nuk ka ndjekur rendin e drejtë të hartimit dhe miratimit. Kështu, Kroacia miratoi Strategjinë e saj të parë të Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë e Mbrojtjes në të njëjtën ditë (19 Mars 2002). Serbia bëri të njëjtën gjë, duke i miratuar të dyja në Tetor 2009. Për rrjedhojë, ka mbivendosje - disa segmente në Strategjinë e Mbrojtjes nuk janë përpunuar sa duhen, por janë importuar tërësisht nga SSK-ja. Për më tepër, rishikimi Strategjik i Mbrojtjes i Serbisë u miratua 7 muaj para këtyre dy dokumenteve. Mali i Zi mund të përfitonte nga gabimet e të tjerëve. Në fakt, SSK-ja dhe Strategjia e Mbrojtjes u miratuan për herë të parë brenda 20 ditësh, në vitin 2006 (përkatësisht në 27 Nëntor dhe 17 Dhjetor) duke i hequr të dytës kohën e nevojshme për të ardhur në "linjë" me SSK-në. Kur ato u ripunuan në vitin 2008, u la një kohë e mjaftueshme deri në miratim, për të konkluduar që procesi ishte mjaftueshëm i konsoliduar (në teori).

Situata ka qenë me konfuze në Bosnje ku dokumentet e para strategjikë dhe doktrinare që përcaktonin qëllimet strategjike të sigurisë të BiH ishin Politika e Mbrojtjes dhe Doktrina Ushtarake,

ndërsa Politika e Sigurisë (dokumenti më i përgjithshëm i sigurisë, homologu i SSK-së) u miratua tre vjet më vonë, edhe pse logjikisht duhej të ishte i pari. Vetëm në Kosovë, për shkak të situatës aktuale mund të justifikohet një qasje “nga poshtë-lart”, që do të thotë hartimi dhe miratimi i strategjive sektoriale në vend të hartimit më parë të SSK-së.

Së fundi, Maqedonia, në shikim të parë, duket se ka ndjekur të njëjtën rrugë, si të gjitha vendet e tjera. Strategjia e parë e Mbrojtjes dhe Libri i Bardhë për Mbrojtjen u miratuan përpara SSK-së (në fakt titullohej “Koncepti Kombëtar për Sigurinë”). Të gjitha dokumentet e tjera (përveç Marrëveshjes së Ohrit) janë miratuar në të njëjtin vit, 2003 (Libri i Bardhë për Mbrojtjen dhe Strategjia për Reformat e Policisë u amenduan përkatësisht në 2005 dhe 2004) edhe pse jo në të njëjtën kohë. Megjithatë, pavarësisht nga këto probleme, në parim, kuadri strategjik i Maqedonisë deri tani është më i harmonizuari në rajon. Dokumentet e tjerë strategjikë të saj shprehin në mënyrë eksplicite, nënshtrimin e tyre ndaj Konceptit të Sigurisë Kombëtare dhe Mbrojtjes.

SFIDAT, RREZIQET DHE KËRCËNIMET

Analiza e përmbajtjes së dokumenteve të sigurisë që ekzistojnë në rajon konfirmon se këto vende u preokupuan më shumë me krijimin e këtyre dokumenteve, pa kuptuar vërtet dhe plotësisht “pse-në”. Shpesh qëllimi i përpilimit të tyre ishte ose për të kënaqur publikun e brendshëm, ose për të qenë “në linjë” me standardet ndërkombëtare e për t’u treguar “vlerësuesve” të huaj (nga BE ose NATO) pjekurinë e udhëheqjes politike dhe të vendit thjesht nga ekzistenca e kuadrit strategjik e doktrinor.

Dokumentet strategjike kanë strukturë të ndryshme nga njëri-tjetri, duke e vështirësuar analizën krahasuese, po ashtu, dokumentet e rishikuar nuk u ngjajnë shumë pararendësve. Kjo shpjegohet jo aq nga nevoja e përsosjes, por me faktin se vendet e rajonit janë ende duke eksperimentuar në këtë fushë.

Mundet që rishikimet e ardhshme të dokumenteve strategjike në rajon të fillojnë t’u ngjajnë njëri-tjetrit, duke marrë standardet e NATO-s si model. Trendi ka filluar të aplikohet. Mali i Zi e ripunoi SSK-në e vet, si dhe analizën e sfidave, rreziqeve e kërcënimeve, plotësisht në përputhje me ato të NATO-s, ndërsa Kroacia, qëndroi në pritje të anëtarësimit në NATO (që u finalizua në 2009) dhe pastaj të daljes të Konceptit të Ri të NATO-s (2010) për të rishikuar dokumentet e veta strategjike (sipas modeleve të NATO-s). Në fakt ky trend, të paktën në rastin e Malit të Zi, është bërë shkak për formulime disi groteske. Kështu në dokumentin e SSK-së, (nën shembullin e NATO-s) deklarohet që një pjesë e sfidave, rreziqeve e kërcënimeve ndaj

sigurisë të Malit të Zi mund të vijnë nga Lindja e Mesme, Kaukazi e Afrika e Veriut. Në këtë mënyrë, nga nxitimi për të kopjuar NATO-n, hartuesit e SSK-së të Malit të Zi e kanë lënë vendin pa strategji të sigurisë.

Vëzhgimi i dytë që rrjedh nga leximi i dokumenteve, është se asnjëri prej tyre nuk bën një dallim të qartë midis sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve. Kjo e ndërlikon “analizën e rreziqeve”, në dokumentet e ndryshme, duke ua lënë në dorë vetë studiuesve, interpretimin e tyre dhe arritjen e përfundimeve. Kështu, SSK-ja e Serbisë (2009) thekson në mënyrë të qartë se “*shpallja jo-ligjore dhe e njëanshme e pavarësisë nga Kosovë-Metohia, është kërcënimi më i madh për sigurinë e Republikës së Serbisë*”, ndërsa sfidat, rreziqet apo kërcënimet e tjera nuk janë kategorizuar gjithnjë qartë. Në këtë mënyrë, institucionet e sigurisë nuk gjejnë një vizion të qartë për të reaguar ndaj një problemi të caktuar dhe për t’u parapërgatitur për të.

Problemi i tretë i rëndësishëm është mungesa e hierarkisë midis sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve të paraqitura në këto strategji. Për disa nga dokumentet, ne mund të supozojmë, pa qenë plotësisht të sigurt, se radha e paraqitjes është njëherazi edhe një farë prioritarizimi. Disa dokumente deklarojnë kërcënimin më të madh për vendin e tyre, por sfidat, rreziqet dhe kërcënimet e tjera i lënë jashtë çdo hierarkie. Në rastin e SSK-së së Serbisë “[...] pavarësia e Kosovë-Metohisë”, siç u përmend më lart, konsiderohet si kërcënimi kryesor. Pavarësisht nga kjo, nuk është renditur i pari në listën e kërcënimeve (është në vend të tretë) rrëzuar supozimin që renditja përfaqëson njëkohësisht edhe prioritetin.

SSK-ja e Kroacisë e vështirëson më tej problemin duke i ndarë sfidat, rreziqet e kërcënimet në dy kapituj. Megjithatë, ose ato përsëriten në të dy kapitujt, ose përmbajtja e tyre, në të dy grupet nuk ka ndonjë dallim esencial.

Së fundi, vendi i vetëm që u bën një farë prioritarizimi sfidave, rreziqeve e kërcënimeve është Maqedonia. Ato renditen sipas kohës (aktuale, afatmesme e afatgjatë) dhe sipas nivelit të intensitetit (të lartë, të mesëm, të ulët, shumë të ulët). Në këtë strukturë hierarkie, në vendin më të lartë janë vendosur “*manifestimet e mundshme të nacionalizmit ekstrem, intolerancës raciale e fetare, terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar, migracioni i paligjshëm, tregtia e paligjshme e të gjitha llojeve, duke përfshirë tregtinë e materialeve strategjike dhe me përdorim të dyfishtë, kontrolli jo fort i sigurt dhe efikas i kufijve, etj*”. Në fakt, ky prioritarizim ekziston vetëm në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes të Maqedonisë, të vitit 2003, por nuk përsëritet në asnjë nga dokumentet e tjerë vijues.

Këto probleme, si dhe vete gjuha e Strategjive dëshmon që do të duhet ende shumë kohë që vendet e Ballkanit Perëndimor të bëjnë të

vetën logjikën dhe gjuhën “post–Luftë e Ftohtë”. Ata vijnë vërdallë kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave moderne, duke i marrë nga dokumente të tjera strategjike (shpesh me metodën “copy-paste”) dhe duke u përpjekur (pa sukses) t’i aplikojnë në strategjitë e tyre, pa arritur të kuptojnë diferencat reale, për t’i vendosur paskëtaj në hierarkinë e duhur.

KËRCËNIMET E BRENDSHME, RAJONALE DHE GLOBALE

Ngjashmëria më e madhe në dokumentet strategjike të vendeve të rajonit është kategorizimi i kërcënimeve të brendshme, rajonale dhe globale. Vetëm dokumentet strategjike të Malit të Zi nuk janë strukturuar në këtë mënyrë, por përsëri, ato mund të vihen në të njëjtin kuadër dhe të analizohen në të njëjtën mënyrë si dokumentet e tjerë për shkak të numrit të vogël të kërcënimeve (vetëm shtatë) të parashikuara. Edhe pse dokumentet në përgjithësi nuk lënë shumë hapësirë për analizën e sfidave, rreziqeve e kërcënimeve, ne do të fokusohemi tek dallimet, ngjashmëritë dhe veçantitë midis tyre, sepse kështu mund të nxirren përfundime për logjikën dhe filozofinë strategjike të tyre.

KËRCËNIMET E BRENDSHME

Në nivel kombëtar, në gati të gjitha dokumentet, spikatin problemet që lidhen me katastrofat dhe tranzicionin. Gjithashtu krimi i organizuar dhe terrorizmi perceptohen si kërcënime të brendshme, përjashtuar BiH dhe Maqedoninë. Krimi i organizuar mbetet një problem kronik për të gjithë Ballkanin, ku asnjë nga qeveritë nuk ka arritur të merret si duhet me të. Ai është rrënjësor thellë edhe në strukturat e shtetit dhe në veprimtarinë e tij nuk njihet kufij, nuk ka pengesa etnike, nacionaliste apo të ndonjë natyre tjetër. Rrjetet e krimit të organizuar në tërë rajonin kanë qenë shumë aktive në trafikun e paligjshëm të narkotikëve dhe njerëzve, imigrimit të paligjshëm, tregtisë së armëve konvencionale, etj. Prandaj është shumë interesante, përse ky kërcënim nuk konsiderohet si “i brendshëm” në dokumentet e Bosnjës dhe Malit të Zi.

Trajtimi i terrorizmit si kërcënim i brendshëm është disi i paqartë. Nga njëra anë është shumë vështirë për të provuar ekzistencën e “qelizave” terroriste në rajon. Me përfundimin e konflikteve në pjesën jugore të Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Serbia Jugore dhe Maqedoni) nuk ka patur kërcënime reale terroriste në rajon. Nga ana tjetër, edhe pse shumica e këtyre vendeve kanë dërguar trupa në Afganistan dhe Irak, për të ndihmuar Amerikën në “luftën kundër terrorizmit”, numri i tyre në teatër është tepër i vogël për të provokuar ndonjë lloj reagimi nga terroristët. Shpjegimi i vetëm për përfshirjen e terrorizmit si një kërcënim, është mundësia e shfrytëzimit nga

terrorizmi të vendeve të Ballkanit Perëndimor si "pozicion kalimtar", drejt destinacionit final, BE-së.

Në dokumentet në fjalë, problemet e tranzicionit janë përshkruar, së pari, si probleme të "tranzicionit politik", të cilat shkaktojnë një zhvillim të ngadalshëm të efektivitetit të institucioneve ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore; si probleme të "tranzicionit drejt ekonomisë së tregut", të cilat janë shkaktojnë për nivelin e ulët të investimeve të brendshme dhe të jashtme duke favorizuar njëkohësisht "ekonominë gri" dhe "tregun e zi"; si "*hapa të ngadalshëm, vështirësi dhe parregullsi në procesin e privatizimit e progresit teknologjik, në përkeqësimin e kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e papunësisë...*" (Rishikimi i Mbrojtjes i Bosnjës - ende i pabotuar). Dokumentet maqedonase shtojnë në këtë listë disa kërcënime specifike si "*terrorizmi urban, krimet e rënda që përfshijnë shantazhet, vrasjet dhe sulmet ndaj pronës së qytetarëve, krimi ekonomik, evazioni fiskal*" (Koncepti i Sigurisë Kombëtare dhe Mbrojtjes, Maqedoni). Përfshirja e katastrofave (ekologjike, teknologjike dhe epidemitë) si kërcënime të brendshme tregojnë se vendet e rajonit ndjekin të paktën një minimum të standardeve për çështjet bashkëkohore të sigurisë.

Përveç kërcënimeve që janë, pak a shumë, pjesë e dokumenteve të të gjitha vendeve, ka disa që janë specifike për një vend. Strategjitë serbe, siç janë përmendur tashmë, e perceptojnë pavarësinë e Kosovës si kërcënimin më të madh për sigurinë e Serbisë. Në të njëjtën linjë, aspiratat separatiste janë renditur gjithashtu si një faktor i fortë jostabiliteti për Serbinë dhe ndoshta edhe rajonin. Strategjia maqedonase (me gjasë) i referohet mosmarrëveshjeve të gjata me njërin prej fqinjëve të saj, kur përmend "*frazologjinë e kohës së Luftës së Ftohtë*". Ajo deklaron se një nga kërcënimet e saj të brendshme janë "*aktivitetet e shërbimeve speciale të huaja, me objekt përkeqësimin e gjendjes të sigurisë, për rrjedhojë edhe të proceseve demokratike dhe integruese, posaçërisht ato drejt NATO-s dhe BE-së*" (Koncepti i Sigurisë Kombëtare dhe Mbrojtjes i Maqedonisë, 2003). Gjithashtu, ndërsa dokumentet e tjerë vetëm përmendin nocionin e ndërvarësisë energjetike, ato të Maqedonisë deklarojnë haptazi se një nga kërcënimet për sigurinë e vendit janë "*pasojat e përplasjes së interesave për përdorimin e burimeve dhe rrugëve të transportit të materialeve strategjike të energjisë, si dhe bllokimi i importit të tyre në Republikën e Maqedonisë*". Duke pasur parasysh që i gjithë rajoni është shumë i varur nga importet e gazit nga Rusia, është shumë e çuditshme pse të paktën ky nivel i vëmendjes nuk i është kushtuar këtij problemi edhe nga vendet e tjera të rajonit.

Bosnja përcakton disa kërcënime që janë pasoja të drejtpërdrejta të luftës të zhvilluar atje. Së pari, është "*zbatimi jo i plotë dhe selektiv*

i Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit". Formulimi këtu është ndoshta "emëruesi më i vogël i përbashkët", për të cilin është rënë dakord, pasi palët në Bosnje, për këtë çështje, kanë qëndrime të kundërta. Sipas njërës pikëpamje, Marrëveshja e Dejtonit dhe "përbindëshi", që është krijuar me dispozitat e tij, duhet të shpërbëhet, duke hapur rrugë për një shtet funksional. Pikëpamja tjetër e konsideron Marrëveshjen e Dejtonit si "Biblën e Shenjtë", që nuk mund të preket. *"Trashëgimia e armiqësisë politike dhe sociale që nxit lloje të ndryshme të ekstremizmit nacionalist"* është një tjetër kërcënim i qenësishëm vetëm për BiH, si dhe *"armët dhe municionet e ruajtura në vende të papërshtatshme dhe posedimi individual i tyre i paligjshëm"*.

Së fundi, autorët e SSK-ve të Shqipërisë dhe Serbisë, i kanë kushtuar vëmendje të veçantë problemeve demografike, si emigracioni i paligjshëm që krijon efektin e *"largimit të trurit"*, dhe *"lëvizja e pakontrolluar e popullsisë"* (SSK-ja shqiptare), një fenomen i pranishëm në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, por i theksuar në mënyrë të veçantë vetëm në këto dy strategji. SSK-ja e Serbisë ka vetëm pak ndryshim në formulim, duke deklaruar se problemi është *"zhvillimi jo-proporcional ekonomik dhe demografik Republikës së Serbisë dhe vendeve fqinje"*, që çon në migracionin nga rajonet e pazhvilluara në ato më të zhvilluara (SSK-ja e Serbisë, 2009). Përveç kësaj, dy kërcënimet e fundit të brendshme në SSK-në e Shqipërisë janë shumë konfuze, çorientuese dhe të vështira për t'u kuptuar. I pari lidhet me *"keqinformin e opinionit publik"* që *"favorizon destabilizimin"*, ndërsa i dyti i referohet *"zhvillimit jo adekuat të arsimit, shkencës dhe kulturës"*, sepse *"[...] kushtet themelore për zhvillim, prosperitet dhe mbrojtje të identitetit kombëtar janë burimet njerëzore të specializuara, kapacitetet shkencore dhe prezantimi realist i kulturës dhe traditës sonë"*. Fjalja e fundit mund të ketë pasoja të rrezikshme, për shkak se ajo mund t'i japë aparatit shtetëror rolin e arbitrit final për të vendosur se çfarë është një prezantim *"realist"* i kulturës dhe traditës shqiptare, rol që ai nuk duhet të ketë në asnjë mënyrë.

KËRCËNIMET RAJONALE

Pavarësisht konflikteve të fundit dhe bllokimit të marrëdhënieve ndëretnike në gati të gjitha komunitet shumëkombëshe, në thelb, të gjitha vendet e rajonit, kur paraqesin pozicionin e tyre, përdorin formulime të ngjashme si: *"vendi ka evoluar nga pozita e konsumatorit të sigurisë"* në atë të *"ofruesit të stabilitetit"*, *"kontribuuesit të paqes dhe marrëdhënieve të mira me fqinjët"*. Është një çështje tjetër, sa kjo është një realitet apo mbetet vetëm një dëshirë.

Më kontradiktorja në këtë aspekt është pa asnjë dyshim SSK-ja e Shqipërisë dhe koncepti i të ashtuquajturës "*çështje kombëtare shqiptare*" që ajo ngre. Kjo "*çështje*" është vendosur tek objektivat afatmesme dhe afatgjata më të rëndësishme të Strategjisë: "*Shqipëria synon të jetë një partner aktiv në politikën rajonale. Në këtë kontekst, çështja kombëtare shqiptare do të arrihet nëpërmjet integritit evropian dhe euro-atlantik të vendeve të rajonit si edhe zgjidhjeve që do të sigurojnë një garanci afatgjatë dhe të pranueshme për komunitetin ndërkombëtar*" (SSK-ja e Shqipërisë). Autorët e analizës të dokumenteve shqiptare të sigurisë theksojnë fokusimin (e këtyre dokumenteve) tek integrimi evropian dhe euro-atlantik (duke i quajtur ato gabimisht "evropianizim"⁹), e cila, sipas tyre, është shmangie e qartë nga "*qasja nacionaliste*" në kërkimin e "*zgjidhjeve për çështjen shqiptare*" (Kamberi, 2010). Megjithatë, pyetja e vërtetë është se si mund të jetë kjo kësaj çështjeje një nga objektivat kryesorë të SSK-së shqiptare. Fshehur pas një emri të pafajshëm dhe pas qëllimeve të përgjithshme të integritit euro-atlantik, mund të thuhet se ekzistojnë ende aspirata nacionaliste të elitës politike shqiptare për të mbledhur të gjithë shqiptarët, të shpërndarë në vende të ndryshme të Ballkanit, në një shtet, ose të paktën në një entitet politik. Çfarë do të ndodhte nëse nuk do të ekzistonte mundësia për integrim në BE, ose ca më keq, në qoftë se disa prej vendeve të Ballkanit, me pakicën etnike shqiptare, nuk arrijnë të futen në BE? Si do manovrojë Shqipëria për të zgjidhur "*çështjen kombëtare shqiptare*"? Vetë ekzistenca e kësaj ideje në një dokument zyrtar të rangut të lartë mund të ngrejë shumë dyshime në sinqeritetin e të gjitha deklaratave të tjera për angazhimin e Shqipërisë në bashkëpunim të mirë rajonal.

Kur reflektojnë mbi kërcënimet rajonale, vendet e rajonit tregojnë në dokumentet e tyre, shkallën më të lartë të ngjashmërisë. Me sa duket, efekti i luftërave për trashëgiminë e Jugosllavisë dhe i faktorëve historikë janë ende të pranishme. Prandaj dokumentet, në versione të ndryshme, deklarojnë se, edhe pse mundësia e një konflikti të armatosur është reduktuar, "[...] *ajo kurrë nuk mund të përjashtohet tërësisht*" (SSK-ja e Malit të Zi). Shkalla e konfidencës mbi pamundësinë e një tjetër "kaosi" rajonal ndryshon nga një vend në tjetrin. Shqipëria është neutrale në këtë aspekt, ndërsa dokumentet e Maqedonisë janë te vetmet që flasin për "*rreziqet reale*" që vijnë nga konfrontimet rajonale me motive fetare, ose për pretendime territoriale apo krijimin e "*shteteve më të mëdha*".¹⁰ Së fundi, BiH duke trajtuar problematikën e vet, i mëshon "*aspiratës për*

⁹ Ky term përdoret me kuptimin e futjes së politikave të BE në politikat nacionale, por ndonjëherë edhe çuarjen e preferencave kombëtare në nivelin e BE (Borzel, 1999). Më së shumti ai nënkupton adoptimin e normave dhe vlerave të BE, ndërsa vetëm rrallë, e me sens thjeshtëzues nënkuptohet si integrim në strukturat e BE.

¹⁰ Aluzion për "Shqipërinë e Madhe", shën. përkth.

ndarje, autonomi dhe pavarësi të disa grupeve etnike" dhe konflikteve të armatosura që mund të shkaktohen nga këto aspirata, si një problem serioz rajonal (e padyshim kombëtar).

Një lexim i kujdesshëm i dokumenteve tregon se artikulli i kërcënimeve rajonale buron nga problemet e brendshme që vendet kanë. Natyrisht, shumë nga këto probleme i kanë rrënjët në faktin se rajoni konsiderohet ende si një zonë "post konflikti", i ngarkuar me probleme të rënda sociale, politike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, perceptimi i kërcënimeve rajonale (ndonjëherë midis rreshtave) na jep imazhin e marrëdhënieve të ndërlikuara midis shteteve të ndryshme të rajonit. Për fat të keq, në shumicën e rasteve fqinjët perceptohen ende si "të tjerët" që nuk janë një kërcënim eminent, por që gjithsesi mund të jenë një faktor destabilizues në të ardhmen.

Për shkak të këtij fakti dhe shumë çështjeve të tjera të pazgjidhura, *"paqëndrueshmëria rajonale dhe krizat"* përbëjnë një prej grupeve të kërcënimeve që është i përbashkët për të gjitha vendet. Duket se, megjithëse është arritur paqja, një lloj stabiliteti i brishtë dhe demokraci teknike, sërish vetë vendet e rajonit (sikurse BE dhe pjesa tjetër e komunitetit ndërkombëtar) nuk janë të sigurt që problemet e së shkuarës kanë mbetur pas e nuk mund të ringjallen përsëri. Specifike në këtë kuptim janë rastet e BiH dhe Serbisë, të cilat theksojnë *"tendencat separatiste"*, për shkak të problemeve të veta.

Shumica e vendeve u referohen krimit të organizuar dhe ekstremizmit si probleme rajonale. *Krimi i organizuar* është provuar tashmë si një kërcënim i vërtetë me një potencial për të penguar seriozisht përpjekjet për integrim në BE. Flitet shpesh se krimi i organizuar në Ballkan nuk njeht probleme etnike apo nacionaliste, nuk ka probleme kufijsh, apo vizash. *Ekstremizmi*, i shfaqur në përlëshjet brutale të viteve '90, përmendet si një problem në të gjithë rajonin, kryesisht lidhur me tiparet e veta nacionaliste, etnike dhe fetare. Megjithëse ekstremizmi theksohet posaçërisht në vendet e polarizuara etnikisht (p.sh. Maqedonia) në fakt ai ekziston kudo. Maqedonia konsideron si një kërcënim rajonal, *"mundësinë e manifestimit të nacionalizmit ekstrem, intolerancës raciale dhe fetare"*, ndërsa Serbia deklaron se *"ekstremizmi kombëtar, fetar e politik dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore"* karakterizojnë gjendjen e çështjeve të sigurisë në rajon, duke *"rënduar procesin e tranzicionit demokratik"* në vendet e tij. *Tranzicioni* gjithashtu është karakterizuar si rajonal dhe jo vetëm një problem i izoluar kombëtar. Dokumentet strategjike theksojnë që tranzicioni shkakton ndasi të ndryshme politike, sociale dhe ekonomike, të cilat vetë mund të jenë burim i jostabilitetit rajonal.

Përveç kërcënimeve rajonale që pasqyrohen në të gjitha dokumentet strategjike, çështje të tjera (të rëndësishme) janë

gjithashtu duke u ngritur nga disa prej tyre. Ndër më interesantet është sigurisht çështja e sigurisë së energjisë. Megjithëse e pa shprehur në dokumente, kuptohet se shtysë për këtë kanë qenë dy krizat e gazit të shkaktuara nga konflikti Rusi-Ukrainë. Efekti i tyre ishte shkatërrues për ekonominë e vendeve ballkanike (por jo vetëm për ta) dhe tregoi nivelin e varësisë së tyre nga këto importe. Prandaj dokumentet Maqedonase përqendrohen tek *"pasojat e përplasjeve të interesave për përdorimin e burimeve dhe rrugëve të transportit të materialeve strategjike të energjisë, si dhe bllokimi i importimeve e tyre në Republikën e Maqedonisë"*. Për to, ky është një kërcënim në nivel kombëtar dhe rajonal. Çuditërisht, Maqedonia është e vetmja që e ka vënë atë si një kërcënim, edhe pse krizat e fundit kanë treguar se vendet e Ballkanit janë ndër shtetet e Evropës, më të varura nga importi i gazit rus (në nivel deri 90%). Kjo vlen veçanërisht për Serbinë dhe Malin e Zi, dokumentet strategjike e të cilave ishin të fundit që u miratuan apo rishikuan, duke u krijuar kohë të mjaftueshme, pas krizës së dimrit të kaluar, për ta parë këtë problem të veçantë si një rrezik të mundshëm.

Së fundi, janë çështje të trajtuara shkurt, pa shumë shpjegime, por që plotësojnë imazhin se si kërcënimet rajonale perceptohen nga perspektiva e një vendi. Serbia, për shembull, shtjellon shkurt pozicionin e vështirë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur si dhe statusin e tyre të pazgjidhur në rajon. Kjo është normale, për faktin se Serbia ka numrin më të madh të njerëzve me këtë status në Evropë. Nga ana tjetër, BiH dhe Kroacia përmendin problemin e numrit të madh të minave anti-personel dhe eksplozivave të pashpërthyer në territorin e tyre dhe territoreve të vendeve fqinje.

Në përgjithësi, kjo pjesë e analizës së sfidave, rreziqeve e kërcënimeve ka tendencë të jetë më e rëndësishmja. Nëse shtetet arrijnë të kuptojnë se cilat janë pengesat kryesore në nivel rajonal dhe tregojnë pjekuri e mirëkuptim të ndërsjellë, perspektiva e tyre Euro-Atlantike (Evropiane, në rastin e Serbisë) do të jetë shumë më e ndritshme. Për fat të keq, do të duhet ende kohë, për të krijuar një farë komuniteti ose të paktën një "ndjeshmëri rajonale" për to.

KËRCËNIMET GLOBALE

Kjo është kategoria e elaboruar më pak. Terrorizmi është trajtuar në çdo strategji si kërcënimi më i madh i njerëzimit modern, me mundësi për t'u përhapur edhe në Ballkan. E njëjta gjë vlen edhe për krimin e organizuar. Çdo dokument përmend mundësinë e konflikteve të armatosura ndërshtetërore, por thekson se ka një probabilitet të ulët që kjo të ndodhë. Rishikimi i Mbrojtjes i Maqedonisë jep edhe një vlerësim që, në një të ardhme afatgjatë (mbi 10 vjet) ky probabilitet do të ulet më tej, sikurse edhe probabiliteti i *"kërcënimeve e rreziqeve jo-*

konvencionale dhe asimetrike". Megjithatë, dokumenti nuk shpjegon bazën për këtë vlerësim dhe veçanërisht burimin e optimizmit, sepse aktualisht, asnjë nga treguesit nuk të bën të besosh për një rënie në mundësinë e kërcënimeve asimetrike.

Sfidat e mjedisit janë përmendur në të gjitha vendet si problem që mund të ketë një ndikim serioz për sigurinë. Ndër shqetësimet mjedisore përmenden: ndotja, degradimi, ndryshimi i klimës, por edhe pakësimi i burimeve natyrore dhe potenciali për përleshje në të ardhmen, me synim monopolin mbi to.

Numërimi i kërcënimeve globale në dokumentet strategjike të rajonit tregon qartë shenjat e kopjimit nga dokumentet e tjera të këtij lloji, ose përdorimin e dokumente të vendeve të tjera si modele. Siç e kemi përmendur tashmë, kjo nuk është e çuditshme për rajonin - vendet që janë bërë pjesë e NATO-s po përdorin dokumentet e saj. Në anën tjetër, disa vende në rajon kanë qenë (ose ende janë) në një farë mase nën protektoratin e komunitetit ndërkombëtar, që do të thotë se versionet e para të dokumenteve të tyre strategjike janë shkruar nga anëtarët e komunitetit ndërkombëtar dhe thjesht miratuar nga aktorët vendorë. Më së fundi, edhe vendet që nuk përfshihen (ende) në dy kategoritë e përmendura kanë adoptuar idetë dhe standardet e komunitetit euroatlantik, duke e konsideruar atë si mjedisi i tyre i natyrshëm.

PËRFUNDIME

Pavarësisht mangësive, vetë ekzistenca e kornizës strategjike-doktrinale në (gati) të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor është një përparim serioz drejt stabilitetit të rajonit. Sigurisht ky është vetëm hapi i parë. Strategjitë dhe doktrinat janë në një farë mase si organizmat e gjallë – në çdo vend, ato duhet të ndryshojnë, në bazë të ndryshimit të filozofisë së sigurisë, të perceptimeve rajonale dhe ndërkombëtare për sigurinë dhe progresit të reformave në sektorin e sigurisë.

Ende në Ballkan nuk ka një komunitet sigurie, me gjithë përpjekjet për këtë. Nga ana tjetër, është e qartë se rikonfigurimi në rajon nuk ka përfunduar ende. Kjo natyrisht do të ndikojë në mënyrë të pashmangshme në ndryshimet e vazhdueshme të koncepteve strategjike. Sidoqoftë, dhjetë vite pas konfliktit të fundit rajonal, janë bërë hapat e parë, por të rëndësishme. Hapat e ardhshëm do të jenë akoma më të vështirë. Shteteve do t'u duhet të lëvizin nga perceptimi shumë teknik për nevojën e një kuadri strategjik-doktrinar tek arritja e vlerave të nevojshme, të cilat paskëta do t'i japin idesë për të pasur dokumente të tillë një kuptim më normativ. Kjo do të krijojë edhe kushtet për një rishikim cilësor të këtyre dokumenteve. Sigurisht, kjo

kërkon një situatë të qartë politike në rajon, e cila për momentin nuk po shihet.

BIBLIOGRAFIA

- Bjeloš, M. (2010), Strategic Policies in the Western Balkans - Serbia, Belgrade, CCMR.
- Dautović, K. (2010), Strategic Policies in the Western Balkans – Bosnia and Herzegovina, Belgrade, CCMR.
- Defence Strategy of the Republic of Croatia (2002)
- Delević, M. (2007), Regional Cooperation in the Western Balkans, Chaillot Papers, no. 104, ISS, Paris.
- Gyarmati, I. and Stančić, D. (2004), Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans, DCAF, Geneva.
- Hide, E. and Camberi, H. (2010), Strategic Policies in the Western Balkans - Albania, Belgrade, CCMR.
- Kovač, M. and Stojković D. (2009), Strategijsko planiranje odbrane, Vojnoizdavački zavod, Beograd.
- Mahečić, Z. (2010), Strategic Policies in the Western Balkans - Croatia, Belgrade, CCMR.
- Ministry of Defence of the Republic of Macedonia (1998) Strategy of Defence, Skopje.
- Ministry of Defence of the Republic of Macedonia (2005) White Paper on Defence.
- Ministry of Defence of the Republic of Macedonia (2010) Defence Strategy.
- National Defence Strategy of Albania (2007).
- National Defence Strategy of the Republic of Serbia (2009)
- National Security Strategy of Albania (2004).
- National Security Strategy of Montenegro (2006).
- National security strategy of Montenegro (2008).
- National Security Strategy of the Republic of Croatia (2002)
- National Security Strategy of the Republic of Serbia (2009)
- Ohrid Framework Agreement (2001)
- Predsjedništvo Bosne i Hercegovine, (2008) Odbrambena politika Bosne i Hercegovine. Sarajevo.
- Qehaja, F. (2010), Strategic Policies in the Western Balkans - Kosovo, Belgrade, CCMR.
- Radević, R. Strategic Policies in the Western Balkans - Montenegro, Belgrade, CCMR.
- Strategic Defence Review of the Republic of Croatia (2005)
- Strategic Defence Review of the Republic of Serbia (2006)
- Yusufi, I. (2010), Strategic Strategic Policies in the Western Balkans - Macedonia, Belgrade: CCMR.

MBI STRATEGJINË E SIGURISË KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

Dokumentet strategjike shqiptare, përfshi ato për sigurinë, janë cilësuar shpesh si teorike dhe që nuk përmbushin sa duhet standardin e të qenit njëkohësisht “dokumente pune”, pra të udhëheqin reformat. Artikulli fokusohet në dokumentet strategjike të sigurisë dhe argumenton se edhe atributi që kërkohet t’u jepet si “teorikë” është pjesërisht i vërtetë. Këto dokumente, siç shtjellohet në artikull, do ta kishin përmirësuar mjaft përmbajtjen e tyre dhe do të luanin një rol më të dallueshëm në punën e institucioneve të sigurisë, në qoftë se me të vërtetë do të kishin shfrytëzuar studimet teorike mbi sigurinë, të kryera në hapësirën Euro-Atlantike, në dy dekadat e fundit. Në këtë fushë, duke pasur ende në fuqi një dokument të përgatitur dhjetë vjet më parë, Shqipëria ka mbetur më prapa rajonit, por ka mundur të përfitojë nga përvojat pozitive mbi këto dokumente të një numri vendesh të tjera. Ajo gjithashtu, nuk ka reflektuar mbi ekspertizën që ndonjë institucion ndërkombëtar (si Qendra Marshall, Gjermani) ka dhënë ekskluzivisht për Shqipërinë.

Artikulli i kushton një vend të posaçëm projektit të ri të Strategjisë së Sigurisë (ende i pa zyrtarizuar e në fazë diskutimi) duke evidentuar anët pozitive të saj, por edhe dobësitë, për të cilat jepen rekomandime për përmirësim, sidomos në pjesët: “Interesat kombëtarë” dhe “Masat për implementim”. Në mënyrë të posaçme në artikull, evidentohet dobësia ende prezente e kapaciteteve shqiptare për punën me dokumente të kësaj natyre, si dhe nënvizohet nevoja e krijimit, forcimit dhe ruajtjes së këtyre kapaciteteve, pavarësisht nga rotacioni i pushtetit, krahas kapaciteteve të çmuara që disponon e ofron edhe shoqëria civile.

HYRJE

Hyrja e Shqipërisë në rrugën e transformimeve demokratike, pas vitit 1991, ishte e natyrshme që do të reflektohej edhe në fushën e sigurisë. Kjo u pa si te konceptet e reja, ashtu edhe në hapat konkrete (sidomos të natyrës politike/diplomatike) për sigurinë. Dokumenti i parë shqiptar i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) u miratua në vitin 1995.¹ Në periudhën vijuese, SSK-ja u rishikua edhe dy herë të tjera (në vitin 2000 e 2004). Aktualisht është hedhur për diskutim projekti i ri i SSK-së, ndërsa miratimi pritet të bëhet nga Kuvendi i Shqipërisë gjatë muajit Shtator (2014). Ndryshe nga dy

¹ Gjatë periudhës moniste nuk aplikohet përgatitja e SSK-së.

dokumentet e para të SSK-së, ku detyra për përgatitjen e tyre iu ngarkua Ministrisë së Mbrojtjes, dokumenti i vitit 2004 u përgatit nën drejtimin dhe koordinimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, me pjesëmarrjen e një numri më të madh institucionesh të shtetit.

Deri më sot në Shqipëri, për dokumentet strategjike për sigurinë (Strategjia e Sigurisë Kombëtare apo Strategjia Ushtarake) ka munguar një debat i mirëfilltët. Ato janë miratuar në Parlament me konsensus, me miratimin gati unanim të të gjitha krahëve të politikës. Projekti i ri i SSK-së duket se ka ngjallur një farë debati, jo vetëm në qarqet politike, por edhe në ato akademike, media, etj. Artikulli synon të kontribuojë me analizë, përfundime e rekomandime në këtë debat të përgjithshëm.

ROLI I STRATEGJISË SË SIGURISË KOMBËTARE

Në lidhje me sigurinë si koncept ka një pranim të përgjithshëm që studimet teorike gjatë Luftës së Ftohtë kanë qenë të mangëta. Në këtë fushë, ka pasur disa tentativa në vitet '50 (nga Wolfers) e më vonë në vitet '70 (Knorr dhe Smoke). Pas vitit 1990, studimet e kësaj natyre janë më të thella, sidomos nga Buzan dhe Baldwin.² Pa dyshim, siguria ka qenë dhe mbetet shumë e rëndësishme pasi ajo lidhet me një nga interesat më të rëndësishëm të kombit, duke shërbyer si shtysë për të alokuar burime të rëndësishme, por edhe si justifikim për të kufizuar një numër të drejtash dhe lirish të qytetarëve të vet. Gjatë Luftës së Ftohtë, siguria përgjithësisht barazohej me mbrojtjen dhe problemet ushtarake. Për rrjedhim, një çështje e dalë përpara studiuesve të fushës, merrte automatikisht rëndësi dhe konsiderohej edhe problem sigurie, nëse kishte ndonjë farë lidhje me problemet ushtarake, në të kundërtën ajo mbetej jashtë vëmendjes së tyre.³

Kur diskutohet për sigurinë, është e natyrshme që para së gjithash të qartësohet kuptimi i termit “siguri”. Përcaktimi i Wolfers për sigurinë si “*mungesë e kërcënimit ndaj vlerave të arritura*”, qëndroi për një kohë relativisht të gjatë dhe u adoptua nga një numër vendesh në dokumente të ndryshme strategjike, kryesisht gjatë Luftës së Ftohtë. Aktualisht, me zgjerimin e fushës së sigurisë, përtej asaj të mbrojtjes, janë propozuar përcaktime më elastike. Kështu, Baldwin sugjeron modifikimin e përcaktimit të mësipërm për sigurinë si “*probabilitet i ulët dëmi ndaj vlerave të arritura*”.⁴ Sipas tij, në pamundësi të sigurisë absolute, shtetet (sikurse edhe aktorë të tjerë) përpiqen që me mjete të ndryshme (jo domosdoshmërisht dhe jo

² David Baldwin, studiues për shkencat politike në Universitetin Princeton dhe Profesor Emeritus në Universitetin Kolumbia. Libri i tij “Shtetformimi ekonomik” u cilësua publikimi më i mirë në shkencat politike për politikën kombëtare amerikane, për vitin 1985.

³ Për më tepër, shih Baldwin, “The concept of security”, 1997, f.9

⁴ Po aty, f.13.

vetëm ushtarake) të pakësojnë mundësinë e sulmit nga agresori. Por kur vjen rasti i një fuqie madhore si tërmetet, gjithnjë sipas Baldwin, duke mos pasur në dorë uljen e probabilitetit të ndodhjes të tij, shtetet adoptojnë rregulla (kode) ndërtimi, për të minimizuar probabilitetin e dëmeve. Në këtë mënyrë, ndërsa përcaktimi i parë e vendos fokusin tek “kërcënimi”, përcaktimi i dytë fokusohet tek “vlerat”.

Në debatin e sotëm për konceptin e sigurisë, kanë zënë vend 7 pyetje⁵ kryesore:

1) Siguri për kë?

Megjithëse siguria mund të përfshijë dhe mund t’u shërbejë një numri të madh aktorësh dhe faktorësh, për lehtësi studimi, ajo konsiderohet e analizohet në raport e shërbim të individit, shtetit, apo grup-shteteve (p.sh. NATO).

2) Siguri për cilat vlera/interesa?

Ndryshe nga periudha e Luftës së Ftohtë, sot diapazoni i vlerave/interesave, objekt sigurie, është zgjeruar. Kështu p.sh. Raporti i UNDP i vitit 1994⁶ zhvilloi atë që sot quhet “përcaktimi i gjerë për sigurinë njerëzore” me 7 fusha kryesore: 1) siguria ekonomike (siguria nga varfëria); 2) siguria për ushqim; 3) siguria për shëndetin; 4) siguria; 5) siguria personale (siguria fizike nga ushtrimi sistematik i dhunës); 6) siguria e komunitetit (mbrojtja fizike dhe e traditave kulturore e grupeve të ndryshme etnike); 7) siguria politike (mbrojtja e lirisë civile dhe e shprehjes politike).

Shtete të ndryshme, në dokumentet e tyre strategjike të sigurisë, preferojnë të përdorin termin “interesa”, duke përfshirë zakonisht në to sigurinë e vendit e të qytetarëve, zhvillimin ekonomik, ruajtjen e vlerave kombëtare (ndonjëherë edhe promovimin e tyre në botë) etj.⁷ Në disa raste ato paraqiten në mënyrë më eksplicite (SSK-ja e ShBA). Në raste të tjera ato publikohen pjesërisht ose nuk publikohen fare, me argumentin që për shkak të sensitivitetit që zakonisht mbartin, mund të komplikojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera. Dokumenti i SSK-së së RSH-së (2004) në një farë mënyre luan me formulime të tilla si: “Përcaktimi i interesave kombëtarë është vendimtar” (pika 31) ose “Pushteti politik e ka për detyrë sublimë përcaktimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtarë” (pika 32) ndërsa më tej, (pika 33) disi në mënyrë të tërthortë, nën termin “interesa jetike” përcakton si të tilla: “[...] ushtrimi i sovranitetit, mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial..., e rendit kushtetues, ... e jetës së qytetarëve dhe e lirive e të drejtave

⁵ Baldwin, “The concept of security”, 1997, f.13-17.

⁶ Raporti i UNDP, 1994, f.24-33.

⁷ Shih SSK e ShBA, f.7 e vijim; SSK e Britanisë Madhe, f.21-23; SSK e Serbisë, f.14-16; SSK e Hungarisë, f.2, etj.

themelore të njeriut, zhvillimi ekonomik, mbrojtja e pasurive dhe e vlerave”, por pa bërë detajime të mëtejshme.

3) Çfarë niveli sigurie?

Kjo pyetje i ka ndarë studiuesit në dy kampe: ata që e konsiderojnë sigurinë si qëllim parësor, për rrjedhojë, të tillë që të meritojë mobilizimin/alokimin e të gjitha burimeve të kombit dhe kundërshtarët e kësaj ideje të cilët argumentojnë se siguria (kombëtare) absolute është e pamundur⁸, për më tepër ekzistojnë nevoja të tjera edhe më jetike (si nevoja për ushqim, ujë etj) të cilat shpesh i kanë shtyrë popujt të rrezikojnë për sigurimin e tyre. Në këto kushte, sipas grupit të dytë të studiuesve, shtetet alokojnë vetëm një pjesë të arsyeshme të burimeve të tyre për sigurinë, duke njohur e pranuar (herë në mënyrë eksplicite e herë jo) një nivel të caktuar rreziku.

Në praktikën e funksionimit të shteteve përgjithësisht aplikohet gasja e dytë, por kjo vështirë se gjendet e zyrtarizuar në dokumentet e tyre strategjike për sigurinë. Krejt ndryshe, formulimet që ndeshen në këto dokumente, me shprehje jo rrallë të natyrës emfatike si *“ta mbrojmë me çdo kusht”*⁹, të krijojnë përshtypjen e gabuar se në to është përqafuar gasja e parë.

4) Siguri nga cilat kërcënime?

Në përgjithësi çdo dokument sigurie bën kujdes të veçantë në trajtimin e kërcënimeve (shpesh edhe rreziqeve e sfidave) ndaj sigurisë, duke u lënë atyre një vend të rëndësishëm. Në jo pak raste, konstatohet edhe dukuria tjetër kur jo të gjitha kërcënimet gjejnë vend e zyrtarizohen në dokumentin e strategjisë së sigurisë, më shumë për arsye politike (për të mos dhënë mesazh dobësie tek rivali/agresori i mundshëm).¹⁰

Një tipar që spikat sot në çdo dokument sigurie është zgjerimi i gamës së kërcënimeve. Kështu, krahas kërcënimeve tradicionale, të formës së agresionit të hapur ndaj një vendi sovran (që për hapësirën Euro-Atlantike pranohet si mundësi me probabilitet shumë të ulët) renditen e merren në konsideratë edhe kërcënime e rreziqe të natyrës së terrorizmit, krimi të organizuar, trafikëve të paligjshme, korrupsionit, deri tek katastrofat natyrore apo të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut, mjedisi, mungesa e energjisë, ujit etj. Zgjerimi i spektrit të kërcënimeve e rreziqeve, ka përcaktuar edhe vështirësinë deri pamundësinë e parashikimit të situatave të sigurisë. Në përgjithësi të gjitha dokumentet e sigurisë sot, pavarësisht nga

⁸ SSK e Britanisë së Madhe (f.22) pranon: “Ne nuk mund të mënjanojmë plotësisht rreziqet”.

⁹ SSK e RSH, 2004, pika 7.

¹⁰ OSCE. 2014, f.10.

formulimet e përdorura, e theksojnë këtë realitet, që SSK-ja e ShBA e cilëson: “Një shekull i ri me trajektore të pasigurt”¹¹.

Në këtë kontekst, është me vend të elaborohet koncepti për termat “kërcënim”, “rrezik” dhe “sfidë”, pasi jo rrallë ato konsiderohen e përdoren si sinonime të njëra tjetrës. Kështu, “kërcënim” ka të bëjë kryesisht me një veprim/qëndrim të ndërgjegjshëm të njëres palë e cila në potencë kërcënon të përdorë një mjet për të arritur një përfitim apo lëshim nga pala tjetër. “Rreziku” është më shumë i lidhur me një faktor apo situatë ndaj të cilës një palë ka dobësi (të natyrave të ndryshme) për ta përballuar dhe duke qenë e ekspozuar ndaj tij në mënyrë objektive, në çdo moment, ekziston probabiliteti që nga një kombinim (më së shumti rastësor) shkaqesh që mund ta aktivizojnë atë faktor rreziku, të bëhet objekt e të vuajë pasojat prej tij. Për sa u përket “sfidave”, sidomos në kontekstin e dokumenteve në fjalë, kuptimi është më shumë për detyrime, për objektiva të vështira e komplekse që kërkojnë resurse e kohë për t’u realizuar.

5) Siguri me cilat mjete?

Mjetet në dispozicion të sigurisë janë të ndryshme, të tilla janë edhe rezultatet që mund të arrihen dhe pasojat që mund të sjellë përdorimi i një mjeti apo i një tjetri. Kështu, përdorimi i mjeteve ushtarake për arritjen e një qëllimi mund të sjellë rezultate më të shpejta, por shpesh shoqërohet me pasoja të padëshirueshme, sidomos për popullsinë lokale, mbi të cilën përdoren. Është kjo arsyeja që, në varësi nga situata apo niveli në të cilin siguria kërcënohet, zgjidhet edhe mjeti (mjetet) që duhet përdorur. “Asnjë aktor nuk mund të mbështetet në mënyrë të barabartë në të gjitha mjetet në dispozicion, sepse secili prej tyre dallon për nga logjika e përdorimit, kostoja dhe përfitimi që sjell”.¹²

ShBA mbajnë në konsideratë dhe aplikojnë të ashtuquajturën “DIME”¹³, që nënkupton përdorimin e mjeteve politike, informative, ushtarake dhe ekonomike, veç e veç apo së bashku, për arritjen e objektivave të sigurisë kombëtare. Në SSK-në e ShBA nënvizohet: “Ndërsa përdorimi i forcës është ndonjëherë i nevojshëm, ne do të konsumojmë gjithë opsionet e tjera, sa herë që kjo të jetë e mundur, përpara se të shkojmë në luftë”.¹⁴ SSK Britanike nënvizon gjithashtu “gjithë instrumentet e fuqisë së kombit”.¹⁵ SSK-ja e Serbisë është disi më kategorike: “Republika e Serbisë është e vendosur të përdorë gjithë kapacitetet dhe burimet e mundshme për të mbrojtur interesat

¹¹ SSK e ShBA, hyrje.

¹² Ejodus dhe Savkoviç, “Emergent Concept of National Security Policy in Republic of Serbia”, f.4.

¹³ DIME – Diplomacy, Information, Military, Economy

¹⁴ SSK e ShBA. 2010. f.30

¹⁵ SSK e Britanisë së Madhe. 2010. f.5

kombëtarë”¹⁶, ndërsa SSK-ja e Hungarisë shprehet disi më tërthorazi: “Hungaria mbështetet para së gjithash në mjetet politike, duke shfrytëzuar avantazhin dhe mundësitë e bashkëpunimit diplomatik, ekonomik dhe kulturor”¹⁷.

6) Siguri me çfarë çmimi?

Në përballjen me një pyetje të tillë, zakonisht mendimi shkon tek kostoja financiare. Në fakt, siguria është e lidhur edhe me kosto të tjera, në formë kufizimesh, shtrëngimesh apo deri privimesh nga një numër të drejtash nga më baziket. Në regjimet totalitare privime të tilla, në emër të sigurisë, apo “interesit të përgjithshëm” shkojnë deri në absurd, ku shteti merr të drejtën të ndërhyjë vrazhdë në jetën private të individit. Megjithatë sot, edhe në shoqëritë demokratike, për shkak të nevojës për t’u përballur me kërcënimet e reja (sidomos terrorizmi dhe krimi i organizuar) ndihmuar edhe nga teknologjia, shteti ndërhyr dhe shpesh ka kufizuar të drejta njerëzore të caktuara (këtu mund të sillnim në kujtesë masat shtrënguese në aeroporte e vende të tjera publike, përgjimet e komunikimeve telefonike apo të postës elektronike të organizatave apo individëve, etj).

Për sa i përket koston financiare, në kushtet e sotme kur siguria ka marrë dimensione të gjera, është tepër e vështirë të bëhet një llogaritje, qoftë edhe i përafërt i saj. Buxhetet e disa sektorëve të sigurisë si mbrojtja, shërbimet informative, policia, japin një ide të përafërt, megjithëse një pjesë e këtij informacioni është i klasifikuar dhe nuk publikohet. Ndërsa kostoja e sigurisë për kërcënime/rreziqe të tjera, si katastrofat natyrore (masat parandaluese apo për zbutjen e efekteve dëmtues të tyre) mbrojtja e mjedisit, energjia, etj, është pothuajse e pamundur të kalkulohet. Për to pranohet që kjo kosto do të vijojë të rritet në mënyrë të konsiderueshme në të ardhmen.

7) Për çfarë periudhe kohe?

Në përgjithësi dokumentet strategjike të sigurisë nuk janë shumë precizë në aspektin e periudhës kohore në të cilën ato synojnë/parashikojnë arritjen e objektivave të tyre të sigurisë. Kjo nuk duhet ngatërruar me afatet e vendosura në këto dokumente (3-5 vjeçare) për rishikimin e tyre. Duke qenë se përcaktimi i periudhave kohore paraqet vështirësi, një numër dokumentesh të sigurisë e kanë zgjidhur këtë duke përcaktuar objektiva të afërt (ose afatshkurtër) afatmesëm dhe afatgjatë.¹⁸ Natyrisht këtu bëhet kujdes që arritja e objektivave të një faze, të mbështesë, arritjen e objektivave të fazës tjetër.

¹⁶ SSK e Serbisë, f.16

¹⁷ SSK e Hungarisë, f.15

¹⁸ Përgjithësisht pranohet që periudha afatshkurtër të jetë 3 - 5 vjet, ajo afatmesme 5 – 10 vjet, ndërsa afatgjatë mbi 10 (ndonjë here mbi 15 vjet).

TRINIA “QËLLIMI–RRUGËT–MJETET” DHE ROLI I SSK

Konceptet për sigurinë kombëtare, të shprehura më lart, pikënisja për një dokument cilësor SSK-je, shpesh përmblihen në treshen: “Qëllimi–Rrugët–Mjetet”¹⁹. Në fakt, përjashtuar “kërcënimet” dhe “rreziqet”, gjithçka e përmendur më lart, përfshihet në të. Nga mënyra se si një dokument SSK-je paraqet dhe parashikon aplikimin e trinisë: “Qëllim-Rrugë-Mjete”, varet jo vetëm vlera e saj, por në një masë të madhe edhe siguria e vendit. Kjo qartëson edhe rëndësinë dhe rolin e SSK-së. Në çdo rast, dokumente të tillë kanë synim të dyfishtë, në mesazhin që mbartin, ato janë orientuar “së brendshmi” dhe “së jashtmi”. Si të tilla, përgjithësisht ato janë dokumente publike.

Në funksionin e vet të brendshëm, SSK-ja ka një rol të rëndësishëm, jo vetëm në qartësimin e interesave kombëtarë, në funksion të të cilëve duhet të vihen pjesa kryesore e burimeve të vendit, por duke vlerësuar kërcënimet e rreziqet ndaj këtyre interesave, ajo vë detyra e koordinon punën e institucioneve dhe instrumenteve të tjera të shtetit për t’iu kundërvënë atyre. SSK-ja përbën kështu “[...] një bazament të përbashkët gjuhe, praktikash, shkëmbimi informacioni, aranzhimesh, standardesh tekniko-operacionale, trajnimesh e stërvitjesh, midis agjencive që kanë tradita dhe përgjegjësi të ndryshme, duke i mundësuar kështu sistemit të sigurisë, optimumin e funksionimit. Në mënyrë të përgjithshme, është një mjet për planifikimin dhe verifikimin e politikave të shtetit”.²⁰

Në funksionin e vet të jashtëm, dokumenti i SSK-së është një mënyrë e zyrtarizuar për t’iu parashtruar vendeve aleate, por edhe atyre kundërshtarë, pozicionin e shtetit përkatës në lidhje me çështje themelore të sigurisë e prosperitetit të tij.

Krahas rolit dhe rëndësisë që ka dokumenti i SSK-së në vetvete, një rëndësi të veçantë merr edhe vetë procesi i përgatitjes së tij. Përfshirja në këtë proces i sa më shumë institucioneve, ka një efekt të madh koheziv në njohjen e kulturës së punës të njëri-tjetrit dhe në institucionalizimin e lidhjeve të tilla, që janë vendimtare në përballimin e situatave të sigurisë. “Procesi i të shkruarit të strategjisë së re ka rëndësi. Ai i imponon qeverisë të rivlerësojë objektivat e veta thelbësore dhe të bëjë korrigjime shumë të nevojshme të kursit. [Ky proces][...] i mundëson pjesës tjetër të shtetit, bile edhe botës, njohjen e objektivave të vendit. Në qoftë se kombinohet me vendimet për buxhetin – dhe këtu ka një “në qoftë se” të madhe, ai mund të formësojë në mënyrë efektive mënyrën si politikat marrin jetë”.²¹

¹⁹ Në literaturë e huaj: “Ends – Ways – Means”.

²⁰ Di Camillo & Lucia, 2009, f.28-29.

²¹ Smith dhe Stokes, 2014, “Obamës i duhet një Strategji e re Sigurie”.

http://www.politico.com/magazine/story/2014/03/white-house-national-security-strategy-104491_Page2.html#.U57_iXbNxyU

Vlerësimi i rolit të SSK-së në aspektin konceptual e atë praktik, sigurisht nuk duhet absolutizuar. Në fund të fundit ai është një dokument i shkruar, është një mënyrë për të zyrtarizuar e për t'iu dhënë rëndësinë që meritojnë “rrugëve” e “mjeteve” për arritjen e një qëllimi të caktuar sigurise. Fakti që një numër shtetesh nuk aplikojnë fare nxjerrjen e strategjisë së sigurisë kombëtare²², por bëjnë edhe pa të, konfirmon se, me apo pa një dokument të shkruar strategjie, janë masat (“rrugët” e “mjetet”) konkrete që në fund të fundit përcaktojnë nivelin e sigurisë të një vendi.

SIGURIA NË BALLKANIN PERËNDIMOR²³

Duke filluar nga takimi i Këshillit të Europës i Selanikut (2003)²⁴ termi “Ballkani Perëndimor” (WB), si një përfshirje, pa bërë dallim, i vendeve të ish-Jugosllavisë, pa Slloveninë, por duke i shtuar Shqipërinë, ka filluar të përdoret rëndom në politikën e jashtme të BE-së, bile edhe nga vetë vendet e këtij rajoni në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. Me gjithë diferencat që këto vende kanë në kulturë, gjuhë, tradita e deri në objektivat kombëtarë strategjikë, ato vijojnë të konceptohen e trajtohen, në shumë raste, si një bllok, sidomos nga BE-ja. Një qasje e tillë (shpesh e papëlqyeshme për vetë ballkan-perëndimorët) është e volitshme për përgjithësime në lidhje me forcat lëvizëse dhe tendencat e rajonit. Parë në bllok, “[...] *Misioni i ndërtimit të paqes në Ballkan ende nuk ka përfunduar [...]. Vetëm atëherë kur vendet e këtij rajoni të gjenden në një kurs të pakthyesëm drejt BE, ne mund të jemi në gjendje të festojmë [...]. Deri atëherë, duhet ta mbajmë Ballkanin në binarë, duke siguruar që Bosnja, Kosova dhe Maqedonia të jenë në tren*.”⁽²⁵⁾ Megjithëse i bërë disa vite më parë, ky konstatim, me sa duket, do të jetë relevant edhe për shumë vite të tjerë.

Në përgjithësi, BE-ja ka ushtruar influencën e vetë ndaj WB në një numër formash të karakterit politik, ekonomik, kulturor etj. Nga ana tjetër, fakti që të gjitha vendet e këtij rajoni, pa përjashtim, kanë vendosur në agjendat e tyre integrimin në BE, si një trend i natyrshëm, por edhe mënyra më efikase për prosperitetin e tyre, ka nxitur “reforma europianizuese” në secilin prej tyre, por edhe nevojën për bashkëpunim rajonal, duke braktisur konfrontimet e tensionet e

²² Dy nga vendet fqinje (Italia dhe Greqia) nuk kanë dokument të SSK. Sigurisht mungesën e tij ato e kanë zgjidhur me dokumente të tjerë. Aktualisht në të dy këto vende ka një debat për mundësinë e aplikimit të SSK. Britania e Madhe e nxori për herë të parë SSK-në e vet në vitin 2010. Deri në këtë kohë mjaftohej me të ashtuquajturin “Rishikim Strategjik i Mbrojtjes”.

²³ Në përgatitjen e këtij seksioni janë shfrytëzuar: Gyarmati and Stancic, “Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans”, DCAF, 2007 dhe Abusara, “Comparative Analysis of the Strategic Documents of the Western Balkans”, BCSP, 2010.

²⁴ Graef J. 2012. F.4

²⁵ Petersen. S. & Serwer, D. 2010.

deri një dekadë më parë. Në këto kushte, shihet edhe një farë konvergimi në konceptet, rrugët dhe mjetet për rritjen e nivelit të sigurisë kombëtare e rajonale.

Secili prej këtyre vendeve ka të paktën 3 dokumente madhorë sigurie: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake (apo e Mbrojtjes) dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (në disa vende Libri i Bardhë). Një “pasuri” e tillë dokumentesh sigurie natyrisht është edhe rrjedhojë e të shkuarës të trazuar të rajonit. Megjithatë, nga studimi i dokumenteve të sigurisë, të krijuhet përshtypja se analizat e kryera, si dhe mjetet e metodat që këto vende gjykojnë të vënë në shërbim të sigurisë, ndonjëherë duken jo bindëse, të pamjaftueshme ose përtej fuqive të tyre. Gjithashtu, rolet e misionet për institucionet kryesore të sigurisë paraqiten të gjeneralizuara, duke bërë të vështirë, që këto dokumente të jenë me të vërtetë dokumente pune, detyrues e koordinues për këto institucione. Nisur nga ky fakt, nuk duket pa bazë hipoteza se qeveritë e vendeve të këtij rajoni, ku më shumë e ku më pak, i konsiderojnë këto dokumente si një obligim ndaj partnerëve ndërkombëtarë, si një mesazh se po ecet në vazhden (modën) e Euro-Atlantike në këtë fushë dhe jo aq si një nevojë e brendshme.

SSK-të e këtyre vendeve ndjekin një mënyrë të ngjashme kompozimi, gjë që është e drejtë (me gjithë ndonjë dozë skolarizmi). Përgjithësisht ato ndjekin linjën: a) Parimet kryesore; b) Vlerat, interesat dhe objektivat kombëtare; c) Vlerësime për sfidat, kërcënimet dhe rreziqet; d) Fushat e veçanta të sigurisë (ku mbrojtja dhe forcat e armatosura zënë një vend të rëndësishëm); e) Implementimi i politikave/përfundimeve të sigurisë (përfshi disa institucione kryesore të nivelit strategjik).

Ngjashmëria është e dukshme edhe në mënyrën e konceptimit të çështjeve të sigurisë në rajon. Kjo mund të vijë si rezultat i faktit se problemet e analizuara janë të ngjashme, ose si rrjedhojë e influencës së shteteve të tjera perëndimore që kanë asistuar këto vende në çështjet e sigurisë.

Përgjithësisht të gjitha dokumentet e sigurisë theksojnë nevojën për anëtarësim në NATO (përfshirë Serbisë) gjithashtu (përfshirë Serbisë) i japin më tepër kredite NATO-s, në raport me BE-në, për çështjet e garantimit të sigurisë në rajon. Megjithatë, anëtarësimi në BE konsiderohet si një trend i natyrshëm për to, faktori kryesor i prosperitetit ekonomik e politik. Të gjitha shtetet e WB, gati njëlloj, shprehin aspiratën për të ndërtuar shoqëri demokratike, mbështetur në shtetin ligjor, në ekonominë e tregut dhe iniciativën e lirë.

Të gjithë dokumentet, në një masë të madhe kanë adoptuar konceptet Euro-Atlantike, duke u kushtuar më shumë rëndësi kërcënimeve të reja në raport me ato tradicionale. Karakteristik është fakti që ato janë tërësisht “produkte qeveritare”, të përgatitura pa

kontributet e faktorëve të tjerë jo-shtetërorë. Në Shqipëri, në një anketim të kryer nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim (IDM) 69% e të anketuarve kanë mendimin se problemet e sigurisë nuk janë konsultuar sa duhet me shoqërinë.⁽²⁶⁾

DOKUMENTI I SSK TË RSH - 2004

SSK-ja e RSH, e miratuar në vitin 2004 (SSK-2004) e humbi që herët aktualitetin, parë kjo sidomos në raport me një numër zhvillimesh të mëvonshme në fushën e sigurisë brenda dhe jashtë vendit. Për këtë mjafton të sillet shembulli që ndërsa në të ekziston objektivi afatmesëm/afatgjatë për integrim në NATO²⁷, në fakt Shqipëria është anëtare e NATO-s qysh prej Prillit 2009. Megjithëse në vetë këtë dokument vihej detyrimi për t'u rishikuar çdo dy vjet, u desh të kalonin 10 vjet, për të pasur në vitin 2014, një lëvizje serioze, ndërinstitucionale për ta rishikuar.

Përveç vjetërsisë, edhe analiza e përmbajtjes e SSK-2004 nxjerr në pah defekte, të cilat duhet të shmangen në dokumentin e ri të SSK. Në formën më sintetike ato paraqiten në analizën që bëri për të, Qendra Marshall (nga më autoritaret në fushën e sigurisë) në vitin 2006. Kështu (pas disa *konsideratash pozitive, të përgjithshme, sidomos në lidhje me aspiratën e integritit të RSH në NATO e EU*) kjo Qendër paraqet këto vërejtje për SSK-2004:²⁸

1. [...] *dokumenti mund të bënte shumë më tepër për të [...] qenë një "strategji veprimi" e qartë. Shumica e kapitujve nuk arrijnë të shkojnë përtej deklarimeve të përgjithshme në lidhje me [...] politikat aktuale.*
2. *Struktura e kapitujve kryesorë, shumë shpesh të paqartë në konceptim dhe përsëritës në përmbajtje [...] Kjo vlen edhe për kapitullin e fundit ku flitet për rolet dhe marrëdhëniet midis institucioneve drejtuese strategjike.*
3. *Doza e referimeve të përsëritura ndaj disa çështjeve të rëndësishme mund të lejë përshtypjen se (ato) janë përcaktuar keq, ose reflektojnë modele mendimi të stilit të vjetër [...]*
4. *Përtej prioritetit të shprehur qartë për integrim në NATO dhe BE, më tepër vëmendje duhej t'i kushtohej roleve [...] dhe parimeve udhëheqëse të këtyre dy institucioneve, sikurse*

²⁶ IDM, "Perceptimet e Elitës Shqiptare në çështjet e strategjisë së sigurisë, kërcënimeve e reziqeve", 2010, f.8, tek:

<http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/RAPORTI%20final%20english-edited%203.pdf>

²⁷ SSK e RSH, pika 16.1.

²⁸ Me disa shkurtime, sipas letrës që Drejtori i Qendrës Marshall, Zoti John P. Rose i dërgon Ministrit të Mbrojtjes më 10 Prill 2006.

edhe rëndësisë dhe roleve të institucioneve të tjera ndërkombëtare, si OKB, OSBE, KE, etj.

5. *Trajtimi i marrëdhënieve rajonale mund të përmirësohej ndjeshëm duke u kushtuar vëmendje organizatave të ndryshe të Evropës Juglindore e Qendrore, si edhe çështjeve kyçe në marrëdhëniet bilaterale me vendet në fqinjësi direkte apo të afërt.*
6. *Trajtimi i terrorizmit do të mund të përmirësohej nëse bëhej një detajim i shkurtër i rrugëve/formave në të cilat ai përbën një shqetësim ndaj sigurisë së Shqipërisë, nga brenda apo nga jashtë.*

Duke gjykuar mbi këto vërejtje të Qendrës Marshall, mund të konkludohet se SSK-2004 nuk e ka kaluar testin e kësaj Qendre. Ky fakt, së bashku me faktin tjetër që, pavarësisht nga të metat, ky dokument vijon të jetë në fuqi prej 10 vjetësh, dëshmon për mungesën e kapaciteteve të institucioneve tona të sigurisë për t'u përballur me sfidat e përgatitjes së dokumenteve të tillë në përputhje me standardet Euro-Atlantike.

Metodologjikisht, dokumente të kësaj natyre e kanë të domosdoshme realizimin e disa sondazheve, me qëllim njohjen e perceptimit të opinionit publik dhe vlerësimin e nxjerrjen e përfundimeve prej tyre. Në fakt SSK aktuale i mungon një komponent i tillë i rëndësishëm. Sondazhe të tilla të kryera nga institucione të tjera, jo qeveritare, vërtetojnë se perceptimi i publikut për kërcënimet e rreziqet ndaj sigurisë së vendit tonë, është i ndryshëm për nga prioritetet, krahasuar me atë që përshkruhet në SSK-2004.²⁹

Së fundi, në lidhje me mënyrën e të shkruarit – një numër paragrafesh të SSK-2004 fillojnë me: “*Kjo strategji [...]*”. Të krijohet përshtypja që SSK-ja i bën përshkrimin vetes, pa u marrë direkt me problemet që normalisht janë objekt i një strategjie të sigurisë kombëtare.

DOKUMENTI I RI I SSK

Përgatitja e dokumentit të ri të SSK-së të RSH (SSK-2014) është pa dyshim një zhvillim mjaft pozitiv në aspektin e sigurisë të vendit, pasi është cilësisht më i arrirë dhe përmbush një boshllëk konceptual për institucionet e sigurisë të vendit. Meritë e grupit të hartuesve të SSK-2014 është gjithashtu fakti që ia dolën ta finalizojnë atë në një

²⁹ Kështu, bazuar në këto sondazhe, konstatohet se publiku shqiptar konsideron si kërcënim kryesor për vendin korrupsionin, varfërinë, dështimin e reformave demokratike, ndërsa në tekstin e SSK-2004, kërcënimet kryesore lidhen me terrorizmin, krimin e organizuar etj (shih studimin e IDM tek: <http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/albperceptiononnatointegrations.pdf>, faqe 17).

kohë relativisht të shkurtër, rreth 6 muaj.³⁰ Nga ana tjetër, si në procesin e përgatitjes të SSK-2014, ashtu dhe në vetë tekstin e dokumentit, ka një numër risish e përmirësimesh, të cilat meritojnë të shihen më në detaje.

Para së gjithash, u shtua së tepërmi numri i institucioneve të përfshira në përgatitjen e SSK-2014.³¹ Bashkë me institucionet që tradicionalisht kanë qenë më pranë sigurisë, numri i tyre shkon në 18.³² Në këtë mënyrë, SSK-2014 bën një lidhje më të mirë të problemeve të sigurisë të RSH me institucionet e shtetit dhe detyrimet specifike të tyre ndaj sigurisë.

Në ecurinë e përgatitjes së dokumentit u kërkua e u shfrytëzua asistenca e një numri institucioneesh të specializuara ndërkombëtare, sidomos Qendra Marshall (Gjermani). Për sa i përket shoqërisë civile, megjithëse konsultimet me të kanë qenë më të shpeshta, praktikisht nuk pati ndonjë reflektim mbi sugjerimet e saj. Në këto kushte, do të ishte e tepërt të pretendohet marrja në konsideratë e disa gjetjeve në lidhje me perceptimin e publikut shqiptar për rrezikun, pjesë e një sondazhi të ndërmarrë nga IDM në gjithë territorin e Shqipërisë në Tetor 2013.³³

Një risi mjaft e rëndësishme në lidhje me procesin e përgatitjes të SSK-2014 ishte aplikimi i të ashtuquajturës “analiza SWOT”³⁴ që përbën një kontribut të rëndësishëm në vendosjen e një metodologjie të re, të drejtë e të këshillueshme edhe për të ardhmen, në kuadrin e rishikimit periodik të dokumentit të SSK të RSH. Pavarësisht nga kjo, vetë analiza SWOT ka disa dobësi. Kështu, në të do të duhej të kishte një ndarje më të qartë të fazave të saj. Nga materiali i vënë në dispozicion, bie në sy një ngjashmëri e madhe midis komponentit III, “Mundësitë” dhe komponentit I, “Anët e forta”, po ashtu midis komponentit IV, “Kërcënimet” dhe komponentit II, “Dobësitë”. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është konceptuar vetëm si “mundësi” (“oportunitet”) por nga ana tjetër duke qenë edhe një obligim, në kuadrin e “Mbrotjes kolektive”,³⁵ mund e duhej të trajtohej edhe te komponenti “Kërcënimet”.

³⁰ Me përjashtim të ShBA, ku përcaktohet në mënyrë taksative që Presidenti, jo më vonë se 150 ditë nga marrja e detyrës, duhet të miratojë në Kongres dokumentin e ri të SSK, përgatitja e SSK në vendet e tjera (atje ku kjo aplikohet) ka pasur raste që ka kërkuar 2-3 vjet kohë.

³¹ Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.229, datë 02.12.2013.

³² Referuar Shtojcës D, “Përgjegjësitë e institucioneve për zbatimin e SSK”, këto institucione janë: Kryeministria, Min. Jashtme, Mbrotjes, Brendshme, Shërb.Inteligjencës, Drejtësisë, Financave, Prokuroria, Shëndetësisë, Energjisë, Bujqësisë, Mjedisit, Transporteve, Arsimimit, Kulturës, Ekonomisë, Çështjeve Sociale, Integritetit.

³³ Për më tepër mbi këto gjetje shih në internet:

http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/perceptimi_i_publicit_shqiptar_per_sigurine_-_shqip_0.pdf

³⁴ SWOT – Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats (anët e forta, dobësitë, mundësitë, kërcënimet).

³⁵ Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Në analizën SWOT, trajtohen kërcënimet e ndryshme ndaj sigurisë së RSH, por pasi përmenden ato (krimi i organizuar, korrupsioni, hot-spot-et, etj) mungon elaborimi mbi mënyrën e ndikimit të tyre në sigurinë kombëtare të RSH. Gjithashtu, në të, jepen vlerësime definitive, si: *“Brenda vitit 2020, punësimi në sektorin bujqësor do të ulet me rreth 130 mijë njësi”*, që është e pamundur të parashikohet me saktësi. Nga ana tjetër, në tekstin e kësaj analize, ka hollësira të tepruara si: *“Në Shqipëri [...] nuk ka treg të zhvilluar për materialet e drurit, si peletat, për të cilat ka vetëm një impiant prodhimi në qytetin e Pogradecit”* ose *“profili i tensionit [elektrik] ka tendencën për të qenë më i ulët në pjesën jugore të vendit”*, etj. Dokumenti i analizës “SWOT” do të ishte më i shkurtër po të shmangeshin deklaratat e gjata politike, nga ana tjetër, ka pjesë ku stili është i natyrës didaktike (*“Klima është një kusht paraprak i mirë për përdorimin e energjisë diellore”* ose *“Edhe mbetjet bujqësore kanë potencial të mirë shfrytëzimi”*) që nuk i japin ndonjë vlerë të shtuar analizës.

Mangësitë e mësipërme dëshmojnë për mungesën në institucionet tona shtetërore (jo vetëm në ato të sigurisë) të kapaciteteve të konsoliduar, të aftë për të kryer analiza të nivelit strategjik. Për këtë arsye, jo vetëm që për to duhet investuar më shumë, por kur kapacitete të tilla krijohen, duhet të vlerësohen si asete të rëndësishme e të ruhen me kujdes, pavarësisht nga rotacionet e pushtetit.

Duke u kthyer sërish tek vetë dokumenti i SSK-2014, konstatohet se ai ka reflektuar e sintetizuar rezultatet e analizës SWOT, ndërsa disa pjesë të saj, sidomos “Analiza e mjedisit strategjik” dhe “Klasifikimi i rreziqeve”, janë mjaft cilësore për nga përmbajtja dhe i japin dokumentit një vlerë të padiskutueshme.

Me gjithë anët pozitive të SSK-2014, krahasimi i saj me dokumentet e SSK të disa vendeve të tjera, bazuar edhe në konsideratat konceptuale e metodologjike në lidhje me sigurinë kombëtare, të përmendura në krye të artikullit, nxjerr në pah disa aspekte ku SSK-2014 mund të përmirësohet më tej. Kështu në të:

Vihet re një tendencë për t’i dhënë dokumentit rolin sa të një strategjie, po aq edhe të një plani zbatimi (sidomos kapitulli “Domosdoshmëritë” dhe Shtojca D, “Përgjegjësitë institucionale”). Rëndësia e një strategjie nuk qëndron tek shkalla kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi institucionet zbatuese, apo nga niveli i detajimit të detyrave që vë, por tek horizonti problemor e kohor që përmban, tek shkalla e përgjithësimeve që bën, tek rëndësia e përfundimeve që nxjerr dhe mënyra si orienton punën e institucioneve zbatuese.

1. Në strukturën e SSK-2014, është aplikuar ndarja në dy pjesë, pjesa bazë dhe shtojcat, ku këto të fundit përfaqësojnë më shumë

se 50% të tekstit (nga 36 faqe gjithsej, 19 faqe janë shtojca). SSK-ja mund të kompozohet edhe kështu, megjithëse nuk ndeshet në përvojën e vendeve të analizuara në interes të këtij studimi. Problemi qëndron në faktin që pjesët më të arrira për nga përmbajtja (“Analiza e mjedisit strategjik” dhe “Klasifikimi i rreziqeve”) janë vendosur tek shtojca, gjë që automatikisht i jep lexuesit mesazhin e diçkaje jo aq të rëndësishme, që edhe mund të mos lexohet fare.

2. Sikurse u përmend në krye të këtij artikulli, një dokument i mirë i SSK-së duhet të përcaktojë: 1) vizionin për kombin, si një objektiv final, si qëllimi më vital (“*The end*”) për ekzistencën e prosperitetin e një vendi; 2) interesat më të rëndësishme që burojnë prej këtij qëllimi e janë të lidhura me të; 3) kërcënimet që mund ta vënë në rrezik përmbushjen e tij; 4) masat që duhen marrë (pa rënë në detaje teknike) për të shmangur/mposhtur këto kërcënime; 5) institucionet, strukturat e larta që ngarkohen me vendimarrjen strategjike për sigurinë dhe zbatimin e detyrave kryesore të sigurisë.³⁶ Këto përcaktojnë edhe strukturën e dokumentit të SSK. Në SSK-2014 ai vizion për kombin, për të cilin në fund të fundit formulohet strategjia, jepet pjesërisht në preambulë (por edhe këtu disi indirekt, duke iu referuar Kushtetutës, aspiratës së popullit e lidershipit politik) dhe pjesërisht tek kapitulli për interesat kombëtare të Shqipërisë, por mungon një paragraf i sintetizuar, produkt ekskluziv i kësaj Strategjie, i përshtatshëm për t’u referuar sa herë që nevojitet, nga institucionet, politikanët, studiuesit etj.
3. Vetë interesat dhe vlerat kombëtare janë trajtuar shumë shkurt (gjithsej rreth tetë rreshta) në një kohë që ato duhet të përbëjnë parakushtet/pikënisjen e gjithë shtjellimit të mëtejshëm të dokumentit të SSK. Si të tilla ato kërkojnë formulim të qartë, mundësisht të paraqiten të listuara e të identifikuara dallueshëm njëri nga tjetri, gjë që SSK-2014 nuk ia ka arritur plotësisht. Në SSK-në e ShBA ato zënë pjesën më të madhe të dokumentit, rreth 30 faqe.³⁷ Në atë të Britanisë së Madhe, përveç një deklarimi konciz të tyre, i gjithë kapitulli 2 (“Vendi i Britanisë së Madhe në botë”) në rreth 4 faqe, shtjellon pikërisht vendin dhe interesat strategjike britanike, të para në një kuadër kombëtar, rajonal e global. Në SSK të Serbisë shtjellimi i këtyre interesave është gjithashtu i drejt për drejtë. Në rreth dy faqe të këtij kapitulli parashtrohen 7 interesa (përfshi dhe vlera) kombëtare strategjike. SSK e Hungarisë, gjithashtu, parashton të listuara 10 interesa kombëtare.³⁸

³⁶ Komponenti i fundit (institucionet e larta të sigurisë) është i preferueshëm, por jo domosdoshmërisht gjen vend në çdo dokument të SSK-së.

³⁷ Këtu ka ndikuar edhe fakti që në SSK të ShBA, shtjellimi i interesave kombëtare është bërë i kombinuar me masat për sigurimin e tyre.

³⁸ SSK-ja e Hungarisë, f.2.

4. Kërcënimet, si pjesë e domosdoshme dhe e pashmangshme e një dokumenti të SSK-së, kanë një vend të rëndësishëm edhe në SSK-2014. Siç u përmend më lart, ato janë trajtuar me mjaft profesionalizëm dhe në krahasim me SSK-2004, përfaqësojnë një përmirësim të konsiderueshëm nga aspekti konceptual por edhe i formës së paraqitjes. Në këtë kontekst, ndoshta do të meritonte më shumë analizë renditja sipas prioritetit e tyre (p.sh, kërcënimet kibernetike më prioritare se radikalizmi) por në mungesë të informacionit në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të kërcënimeve, është e vështirë të arrish në përfundime në lidhje me drejtësinë e rezultateve të kësaj analize. Sidoqoftë, parë në tërësi, heqja e kësaj pjese nga teksti bazë i SSK-2014 dhe vendosja në formë shtojce, ia ul disi rëndësinë që ajo meriton.
5. Masat për realizimin e objektivave strategjike dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve ndaj sigurisë së vendit, në dokumentin e SSK-2014 janë shtjelluar tek Kapitulli II, "Domosdoshmëritë". Ky është kapitulli më i gjatë me rreth 9 faqe, që zë më shumë se gjysmën e tekstit bazë (rreth 1/4 e gjithë dokumentit të SSK-2014). Me gjithë rëndësinë që kjo pjesë ka në një dokument të SSK-së, mënyra e shtjellimit e bën këtë kapitull të ngjajë me një program qeveritar, më shumë administrativ nga forma dhe jo aq të karakterit të një strategjie. Sikurse u përmend më lart, një strategji, përfshi strategjinë e sigurisë kombëtare, nga vetë natyra, është më e gjeneralizuar në formë. Ajo synon të japë objektivin e largët dhe drejtimin kryesor drejt tij, pa u futur në detaje e detyrime të tepruara, duke marrë e trajtuar fusha specifike, njëra pas tjetrës. Në SSK-2014 janë nëntë fusha të tilla, ku për secilën prej tyre ka objektiva kryesorë e mbështetës që i japin një rigjinditet të pa nevojshëm kapitullit. Nga ana tjetër vetë renditja e tyre, që nënkupton edhe përparësinë me të cilën shihen nga SSK-2014, duket jo fort bindëse. Kështu, nuk mund të justifikohet që fusha e sigurisë dhe mbrojtjes, pikërisht në një dokument strategjie për sigurinë, të renditet pas asaj të arsimit, ndërsa nga ana e përmbajtjes është paraqitur në mënyrë shumë skematike. Përveç sa më sipër, tek ky seksion ka detaje të tepruara si p.sh: *"ndërtimin e një aksi ... ndërkombëtar që lidh një port në bregun shqiptar të Detit Adriatik ... me Detin e Zi, përmes lidhjes rrugore, hekurudhore, energjetike dhe të telekomunikacionit"* (f.8); *"Zbatimi i një programi kombëtar për kultivimin e kulturës e gjuhës shqipe"* (f.12); *"Përfundimi i procesit të dëmshpërblimit ekonomik dhe moral të të përndjekurve politikë"* (f.12) etj. Në dokumentet e SSK të vendeve të tjera (objekt studimi) kjo pjesë trajtohet në formë shumë më të përgjithësuar, duke iu përmbajtur komponentëve kryesorë të fuqisë së kombit (instrumentet politike e diplomatike, informacioni, instrumentet ushtarake, instrumentet ekonomike).

6. Faktori shqiptar në rajon, me zhvillimet politike të viteve të fundit, nga njëra anë paraqet një element tepër të rëndësishëm sigurie (për Shqipërinë dhe për rajonin) nga ana tjetër po kërkon me ngulm një rol e mbështetje më të madhe prej shtetit amë, Shqipërisë. SSK-2014 pothuajse e anashkalon këtë çështje (me përjashtim të përmendjes tek shtojca D, si detyrim në një nga objektivat e saj – faqe 33). Në këtë aspekt SSK-2004 është më konkrete, pasi qartazi, jo vetëm e deklaroi popullsinë shqiptare që jeton në trojet e veta, jashtë kufijve të RSH, si një faktor të rëndësishëm stabiliteti e sigurie rajonale, por deklaroi edhe pozicionin mbështetës të RSH ndaj tij.³⁹ Edhe dokumentet e SSK të vendeve të tjera mbajnë pozicione të qarta në raport me atë pjesë të popullsisë së vet që jeton jashtë kufijve shtetërorë. Kështu, në SSK të Serbisë (2009) deklarohet: *“Interesi i Republikës së Serbisë është mbajtja dhe forcimi i vijueshëm i lidhjeve të atdheut amë me Serbët që jetojnë e punojnë jashtë atdheut, promovimi i bashkëpunimit kulturor, ekonomik, apo formave të tjera dhe mbështetja për të ruajtur identitetin e tyre kombëtar e kulturor”*.⁴⁰ Në SSK të Britanisë së Madhe nënvizohet fakti që *“një në çdo dhjetë britanikë”* tani jeton jashtë kufijve të vendit, si dhe roli që një prani e tillë në botë, me cilësitë individuale që zotëron, së bashku me rolin e gjuhës angleze, bëjnë që influenca e Britanisë në botë të tejkalojë përmasat fizike të saj.⁴¹ Në këtë kontekst, SSK-ja Britanike shkon më tej duke deklaruar interesin dhe ndërmarrjen e hapave konkrete për të ndikuar e formësuar (me mjete demokratike) mjedisin ndërkombëtar të sigurisë.⁴² SSK-ja e ShBA shkon akoma më tej në këtë aspekt duke shpallur përgjegjësitë e veta për të ndikuar e dhënë formë rendit botëror, në interes të sigurisë së vet kombëtare, të partnerëve e aleatëve të vet e deri atë globale.⁴³
7. Masat për zbatimin e objektivave të SSK-së, zbërthehen më tej, tek shtojca D, *“Përgjegjësitë e institucioneve për zbatimin e SSK”*. Këtu në formë matrice, janë dhënë detyra konkrete për gati të gjitha ministrinë, si dhe një numër institucionesh të tjera, për secilën nga *“Domosdoshmëritë”* e paraqitura tek Kapitulli II. Një praktikë e tillë, e pa ndeshur në dokumentet e vendeve të tjera, me gjithë karakterin e një programi qeveritar që i ka dhënë SSK-2014, ka edhe anën e vet pozitive, pasi disiplinon më mirë punën e bashkërenduar të institucioneve shtetërore për përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj sigurisë së vendit.

³⁹ SSK-2004, e bën këtë në hyrje të dokumentit dhe pastaj në pikat: 7, 16/3, 25, 41, 43.

⁴⁰ SSK-ja e Serbisë, f.16.

⁴¹ Shih, SSK e Britanisë së Madhe, f.4, si dhe pikat: 2.5, 2.6.

⁴² SSK e Britanisë së Madhe, pikat: 0.5, 0.16, 1.13, 1.15, 1.16, 2.5, 2.7, 2.10, 2.16.

⁴³ SSK-ja e ShBA, f.12-14, 24-27, 36, 40-47.

Sidoqoftë, krahas anës pozitive, në mënyrën se si këto detyra janë formuluar, paraqesin edhe disa probleme. Kështu, objektivat e vendosura për secilën nga 9 domosdoshmëritë, në një masë të konsiderueshme janë të përgjithshme dhe si të tilla, jo të matshme. Në matricë ka objektiva të tillë si: “*Aftësimi i administratës publike*”(f.28); “*Shtimi i E-shërbimeve*” (f.27); “*Krijimi i mjedisit të favorshëm*” (f.29) etj.

Gjithashtu, në matricë ka ndonjë mospërputhje me dokumente të tjerë të rëndësishëm sigurie, p.sh: për objektivin “*Zbatimi i RSM 2013*”(f.31) janë ngarkuar vetëm dy ministri (Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave) kur vetë dokumenti i RSM ka detyrime për 7 institucione.⁴⁴ Në matricë ka edhe ndonjë pasaktësi. Kështu, për objektivin “*Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar*”(f.31) institucioni përgjegjës është Ministria e Brendshme ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme është lënë si institucion mbështetës.

8. SSK-2014 e ka të nevojshme pasqyrimin e institucioneve/ instrumenteve kryesore, përgjegjëse për zbatimin e saj. Disa prej tyre⁴⁵ janë sanksionuar tashmë në Kushtetutën e RSH dhe në një numër aktesh të tjerë ligjorë, duke e bërë jo aq të domosdoshme përmendjen e tyre në dokumentin e SSK. Por nga ana tjetër, deri tani në Shqipëri kanë munguar institucionet dhe mekanizmat përkatës, me përgjegjësinë e vlerësimeve të pavarura apo mbledhjes e bashkërendimit të produkteve dhe veprimtarisë të institucioneve të sigurisë, si dhe bërjen e propozimeve tek autoritetet përkatëse. SSK e Britanisë së Madhe është mjaft eksplícite në këtë aspekt, duke zyrtarizuar:

- a) Krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (KSK), nën drejtimin e Kryeministrit, i cili, nëpërmjet takimeve të përjavshme, merr informacion të përditësuar e përpunon direktivat përkatëse.
- b) Krijimin e Bordit të Implementimit të SSK, nën drejtimin e Zyrës së Kryeministrit dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ministrive kryesore, i cili raporton rregullisht te Kryeministri dhe KSK për ndryshimet në fushën e sigurisë.
- c) Raportimin e përvitshëm nga Kryeministri në Komisionin Parlamentar të Sigurisë në lidhje me ecurinë e realizimit të SSK.
- d) Kryerjen çdo dy vjet të vlerësimeve në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet dhe përpunimin e masave kundërvepruese.

⁴⁴ Institucionet pjesëmarrëse në përgatitjen dhe zbatimin e RSM-2013 janë: Min. Jashtme, Min. Mbrojtjes, Min. Brendshme, Min. Financave, Min. Trasporteve, Min. Drejtësisë, SHISH.

⁴⁵ Presidenti, Parlamenti, Këshilli i Ministrave, Kryeministri, Këshilli i Sigurisë Kombëtare.

9. Përveç sa më lart, në SSK-2014 konstatohen edhe disa probleme më shumë të natyrës teknike apo të stilit. Kështu, p.sh, në tekst ndeshet shpesh fraza: “*ne do të ...*”. Për nevoja të jetëgjatësisë, dokumente të tilla bëjnë kujdes që frazeologjia të shmangë ndonjë disponim negativ nga “pala tjetër”, duke synuar mundësisht miratimin me konsensus. Nga ana tjetër në të ka edhe gabime gjuhësore të përsëritura.⁴⁶ Ndërsa për të lehtësuar referimin, në dokument të tilla është i preferueshëm numërzimi i paragrafëve.

PËRFUNDIME

1. Me gjithë progresin e bërë në Shqipëri në lidhje me përgatitjen e dokumenteve strategjike për sigurinë, ende konstatohet dobësi në përmbajtjen e tyre. Kriteri kryesor për të vlerësuar një dokument strategjik sigurie është kërkesa për të siguruar njëherazi horizontin e duhur konceptual strategjik dhe harmonizimin e përpjekjeve ndër-institucionale për përballimin e sfidave ndaj sigurisë së vendit. Deri tani, dokumentet shqiptare të kësaj natyre, i kanë synuar të dy këto funksione, por nuk kanë mundur të kryejnë asnjërin si duhet.
2. Projekti i SSK-2014 është një dokument me vlerë, pasi reflekton një numër zhvillimesh të fundit në fushën e sigurisë, në nivel kombëtar, rajonal e më gjerë, për të cilat SSK-2004 nuk mund të shërbente më. Pavarësisht nga kjo, ajo ka nevojë për disa përmirësime, sidomos në lidhje me interesat kombëtare strategjike dhe masat për mbështetjen e mbrojtjen e këtyre interesave nga kërcënimet e rreziqet. Dokumenti është ende në kohë për t'i kryer këto përmirësime, para miratimit përfundimtar të tij nga Kuvendi i Shqipërisë.
3. Pavarësisht nga forma përfundimtare që do të marrë SSK-2014, ajo duhet të sanksionojë ngritjen e institucioneve, me autoritetin dhe kapacitetet përkatëse, të cilët duke vepruar nën varësinë e institucioneve të larta kushtetuese (Presidenti, Parlamenti, Qeveria) të sigurojnë zbatimin e “përditshëm” të detyrave të kësaj Strategjie.
4. Megjithatë dokumenti i SSK-së rishikohet në periudha të caktuara kohore, përgatitja e kapaciteteve për përgatitjen e dokumenteve strategjike të sigurisë, si dhe të planeve të tjerë sektorialë në mbështetje e zbatim të tyre, duhet të konsiderohet një detyrë e proces i vijueshëm. Ruajtja e këtyre kapaciteteve, pavarësisht nga rotacioni i pushtetit, si dhe fuqizimi i tyre, përbën një nga kushtet e

⁴⁶ Kështu në tekst në vend të “qasje” përdoret gabimisht “përqasje”.

rëndësishme për të përballuar sfidat gjithnjë e më të vështira të sigurisë.

5. Kapacitete të rëndësishme në përgatitjen apo punën me dokumentet strategjike të sigurisë po spikatin e po fuqizohen edhe në një numër organizatash të shoqërisë civile në Shqipëri. Institucionalizimi i kontakteve dhe bashkëpunimit me to, në interes të sigurisë, është më përfitim reciprok për të dyja palët. Përsa i përket përgatitjes së dokumenteve kombëtarë të sigurisë, ekspertiza e shoqërisë civile, jo vetëm që u rrit cilësinë, por ekonomizon edhe përpjekjet për përgatitjen e tyre. \

BIBLIOGRAFIA

- Abusara Adel, "Comparative Analysis of the Strategic Documents of the Western Balkans", 2010.
http://www.bezbednost.org/upload/document/comparative_analysis.pdf
- Baldwin David, "The concept of security", 1997.
<http://www.princeton.edu/~dbaldwin/selected%20articles/Baldwin%20%281997%29%20The%20Concept%20of%20Security.pdf>
- Di Camillo Federica & Marta Lucia, "National Security Strategies: The Italian Case", 2009.
http://www.realinstitutoelcano.org/wps/wcm/connect/b55d20804f018b61b53ef53170baead1/WP39-2009_DiCamillo-Marta_Italy_National_Security_Strategy.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=b55d20804f018b61b53ef53170baead1
- Graef Josefin, "The EU enlargement process in the Western Balkans", 2012.
http://www.academia.edu/2236951/Reinventing_Europes_Internal_Other_in_the_Western_Balkans
- Gyarmati Istvan & Stançi Darko, "Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans" 2007.
<http://www.dcaf.ch/Publications/Study-on-the-Assessment-of-Regional-Security-Threats-and-Challenges-in-the-Western-Balkans>
- Koncepti Strategjik i NATO-s. 2010. Botim anglisht.
http://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_publications/20120214_strategic-concept-2010-eng.pdf
- Liaropoulos Andrew. "Dimensioni institucional i Politikës Greke të Sigurisë: a nevojitet një Këshill i Sigurisë Kombëtare?" 2008. Botim anglisht.
[file:///C:/Users/User/Downloads/006_Liaropoulos%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/006_Liaropoulos%20(1).pdf)
- OSCE, "Threat perception in the OSCE area", 2014.
<http://www.osce.org/networks/118080?download=true>
- Papadimopoulos Themistoclis, "Një model për kulturën strategjike kombëtare greke". Botim anglisht.
http://www.lse.ac.uk/europeanInstitute/research/hellenicObservatory/pdf/2nd_Symposium/Themistoclis_Papadimopoulos_paper.pdf

Petersen Soren Jansen & Serwer Daniel, "The Balkans Can Still Be Lost", 2010. http://www.nytimes.com/2010/11/11/opinion/11iht-edjessen.html?_r=0

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Britanisë së Madhe. 2010. Botim anglisht. https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/61936/national-security-strategy.pdf

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Hungarisë. Botim anglisht. http://www.mfa.gov.hu/NR/rdonlyres/61FB6933-AE67-47F8-BDD3-ECB1D9ADA7A1/0/national_security_strategy.pdf

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Serbisë. 2009. Botim anglisht. http://www.mod.gov.rs/multimedia/file/staticki_sadrzaj/dokumenta/strategije/Strategija_nacionalne_bezbednosti_RS_eng.pdf

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë. 2004. Botim shqip. <http://www.shish.gov.al/files/Ligjet/LIGJI%20NR.9322,%20DATE%2025.11.2004%20PER%20MIRATIMIN%20E%20STRATEGJISE%20%20SE%20SIGURISE%20KOMBETARE%20TE%20RSH.pdf>

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë. 2014 (projekt). Botim shqip.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të ShBA. 2010. Botim anglisht. http://www.whitehouse.gov/sites/default/files/rss_viewer/national_security_strategy.pdf

Strategjia Evropiane e Sigurisë. 2003. Botim anglisht. <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/78367.pdf>

NJË EMËR PËR STRATEGJINË E SIGURISË KOMBËTARE 2014

Mund të fillohej nga shumë anë marrja në shqyrtim e një dokumenti si Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë (SSKRSH), por më tërhoqi vëmendjen një detaj - mungesa e një emri (ose motoje) dhe mendova ta shoh në këtë këndvështrim: ç'emër duhet të ketë SSKRSH?

Nuk është e thënë që strategjitë të kenë një emër të tillë, por në një pjesë të mirë të tyre vihet re përdorimi i një lloji motoje. Do të përmendja disa prej strategjive të SHBA-së. Në vitin 1994, SSK-ja amerikane kishte emërtimin: "A National Security Strategy, of Engagement and Enlargment" (Një SSK për angazhim dhe zgjerim).² Një vit më pas, në shkurt 1995, SSK-ja amerikane mbante përsëri të njëjtin emër. Këtë emër e mbajti edhe në shkurt 1996, kur u miratua SSK-ja e SHBA-së për vitin në vijim. Emri ndryshoi në vitin 1997, kur ajo u quajt "A National Security Strategy, for a New Century" (Një SSK për një shekull të ri).³ Këtë emër SSK amerikane e mban edhe në versionet e mëvonshme, të viteve 1998 dhe 2000. Në vitin 2001 ndërron sërish emër dhe quhet "A National Security Strategy For A Global Age" (Një SSK për një erë globale).⁴ Strategjitë e miratuara në vitet 2002, 2006 dhe 2010 nuk mbanin asnjë emër, përveç atij standart "National Security Strategy of USA". Por praktika e vendosjes së një emri apo motoje për një SSK nuk është veç amerikane. SSK-ja e Britanisë mban moton: "A Strong Britain in an Age of Uncertainty: The National Security Strategy" (Një Britani e fortë në një epokë pasigurie: SSK).⁵ Në fakt, përpjekja për të gjetur një moto për SSKRSH, është një përpjekje për të kuptuar rëndësinë e saj dhe vlerën që do të ketë si dokumenti strategjik më i rëndësishëm.

SIGURIA, STRATEGJIA DHE STRATEGJIA E MADHE

Nisur nga semantika e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, del se dy janë shtresat përbërëse kuptimore: "Strategjia" dhe "Siguria

¹ Autori është në proces për gradën shkencore "Doktor", Studime mbi sigurinë, Akademia e Forcave të Armatosura.

² "A NATIONAL SECURITY STRATEGY, OF ENGAGEMENT AND ENLARGMENT", White House, July 1994, US Government Printing Office, Washington DC.

³ "A NATIONAL SECURITY STRATEGY, FOR A NEW CENTURY", White House, May 1997, US Government Printing Office, Washington DC.

⁴ "A NATIONAL SECURITY STRATEGY FOR A GLOBAL AGE", White House, December 2000, US Government Printing Office, Washington DC.

⁵ "BRITAIN IN AN AGE OF UNCERTAINTY: THE NATIONAL SECURITY STRATEGY"; Printed in the UK for The Stationery Office Limited on behalf of the Controller of Her Majesty's Stationery Office, London 2010.

Kombëtare”. Në qendër qëndron Siguria – siguria e një kombi. Ajo ç’ka e mbështjell këtë sferë, është Strategjia - strategjia si art luftimi për mbijetesë kombëtare, për fuqizim kombëtar, për vazhdimësi, për ... Siguri.

Por, çfarë është Siguria? Fjalori i gjuhës shqipe e përshkruan kështu:

“Siguri-a: Të qenët jashtë çdo rreziku dhe të papriture; gjendje pa ndonjë rrezik a të keqe të papritur, sigurim. [Vërtetësia e plotë e diçkaje; mungesa e çdo dyshimi në lidhje me diçka; bindja e plotë se diçka është e vërtetë, e përpiktë a e drejtë. Dihet (nuk dihet) me siguri. Me siguri matematike me siguri të plotë.] Besimi në diçka; bindja e plotë a besimi i patundur për t’i dalë në krye një pune ose se gjithçka do të shkojë mirë, ashtu siç duhet, siç parashikohet, siç dëshirohet. Siguria në të ardhmen [në ditën e nesërme]”.⁶

Pra siç shihet, thelbi i sigurisë në planin që po diskutojmë (Siguria Kombëtare), qëndron tek “të qenët jashtë çdo rreziku dhe të papriture” dhe tek “bindja e plotë a besimi i patundur për t’i dalë në krye një pune [...] ashtu siç parashikohet, siç dëshirohet.” E konceptuar sipas teorive të studimeve mbi sigurinë, përgjigjja mbi pyetjen “Çfarë është Siguria?” do të përcaktohej kështu nga Walter Lippmann:

“Një komb quhet i sigurt, kur ndodhet në atë gjendje, ku nuk ekziston rrezik që ta detyrojë atë të sakrifikojë vlerat themelore, nëse do të donte të shmangte luftën, dhe nëse sfidohej të ishte i aftë që t’i ruante ato nëpërmjet fitores së një luftë të tillë”.⁷

Këto pak referenca shërbejnë për të kuptuar se siguria e një kombi është gjendja më e rëndësishme, ajo që duhet garantuar para çdo gjendje tjetër. Kryer kjo, krijohen mundësitë e zhvillimit që nga shkenca deri tek arti, etj. Pra siguria është terreni ku mbështetet ekzistenca e një kombi dhe jeta e një shteti. Nuk ka shtet serioz që ta trajtojë me shpërfillje sektorin e sigurisë. Në këtë mënyrë, SSKRSH-ja duhej të kishte vlerën e dokumentit kryesor për politikën shqiptare, me qëllim që kjo e fundit të shfaqte aftësinë e saj në këtë lloj “arti” të quajtur strategji.

“Strategji – arti dhe shkenca e zhvillimit dhe përdorimit të instrumenteve të fuqisë kombëtare në një mënyrë të sinkronizuar dhe

⁶ ÇABEJ E., CIPO K., DOMI M., KRAJNI A., MYDERRIZI O.; “Fjalor i gjuhës shqipe”; njihet gjerësisht si: Fjalori i vitit 1954, viti i botimit të parë; ribotuar, “Shtëpia Botuese Çabej”, Tiranë, 2005.

⁷ BUZAN, Barry; “People, States & Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era”; ECPR Press Classics, 2008, f.36.

të integruar me qëllim që të arrihen objektivat në një mjedis, kombëtar dhe/ose ndërkombëtar.”⁸

Ky dokument themelor i sigurisë do të mundësonte evidentimin e vërtetë të rreziqeve dhe kërcënimeve me qëllim shmangien apo amortizimin e tyre. Nga rëndësia që ka për kombin dhe shtetin, SSKRSH-ja duhet të ishte një dokument i rëndësishëm që gjeneronte konsensus politik mes palëve, një rregullator “i artë” që nuk mund të shkelet – do të ishte pranim universal i politikave, rregullave të lojës, nga palët vendimmarrëse politike shqiptare. Ky konsensus, i shoqëruar edhe me shtimin e rendimentit që SSKRSH-ja u mundëson aktorëve të brendshëm të sigurisë, do të arrinte që ta ngrinte reputacionin në nivel rajonal e më gjerë, për bashkëpunime dypalëshe, shumëpalëshe, në organizata ndërkombëtare, etj. Pika e dobët ndoshta qëndron te mos-vlerësimet reale të shkallës dhe natyrës së rreziqeve kombëtare. Dështimi do të thotë dështim ndaj krijimit të një mjedisi të sigurt kombëtar. Por dështimi vjen kryesisht (edhe) nga moszbatimi i SSKRSH-së. Në Shqipëri kjo është diçka e provuar tashmë: mungesë strategjie dhe vullneti politik për të ruajtur sigurinë kombëtare.

Mungesa e zbatimit të SSKRSH-së (7 vjet pa një të tillë!) dhe mungesa e seriozitetit me të cilën politika trajton një dokument të tillë, çon në mosrealizim të objektivave kombëtarë:

“Strategjia kombëtare e sigurisë - Arti dhe shkenca e zhvillimit dhe përdorimit të diplomacisë, ekonomisë dhe fuqisë informative të një kombi, së bashku me Forcat e tij të Armatosura, në kohë paqeje e lufte, për të siguruar objektivat kombëtare”.⁹

Dokumenti zyrtar i SSKRSH-së, edhe pse teorikisht, është kuadrati rrethues i gjithë politikës që i mundëson kombit shqiptar sigurinë e jetës në çdo aspekt – në nivel qytetari dhe shteti. Fundja, pak rëndësi ka emri që i vendoset. E rëndësishme është theksimi i rëndësisë që ka ky dokument.

Ne po çalojmë si shtet (ndoshta edhe si komb) jo vetëm në mungesën e kulturës strategjike, në mungesën e formimit që kanë politikanët tanë mbi çështjet tej mase të ndjeshme të sigurisë, në mungesën e një dokumenti serioz të SSKRSH-së, në mungesën e zbatimit (qoftë edhe të gabuar) të asaj që ne vetë kemi miratuar si SSKRSH – por edhe në një plan akoma më të gjerë e me pasoja shumë më të gjata në kohë: shqiptarët nuk kanë një strategji të madhe.

⁸ JOINT PUBLICATION 1-02; “Department of Defense dictionary of military and associated terms”; DIANE Publishing, DOD USA, April 2001, f. 507.

⁹ JOINT PUBLICATION 1-02, “Department of Defense dictionary of military and associated terms”; DIANE Publishing, DOD USA, April 2001, f. 358.

Strategjia e madhe, ajo më e larta, është bazamenti i zhvillimit të jetës/ekzistencës së një kombi, shteti apo shtet-kombi. Është prodhim i mendjeve më të ndritura të një kombi, i talenteve të çdo fushe, i njerëzve më seriozë, më intelektualë, më racionalë e natyrisht më patriotë të çdo shtet-kombi. Ajo është një vizion, një koncept i shtrirë në gjerësinë maksimale të jetës së një kombi. Historiani ushtarak Liddell Hart ka një qasje unike ndaj diskutimeve mbi strategjinë:

“Lufta është “çështje shumë serioze” në lidhje me fatet e kombeve, për t’u lënë në dorë të strategëve të çfarëdoshëm. Ekziston një nevojë për horizontin më të gjerë të *strategjisë së madhe*, e cila përfshin gjendjen e paqes që shtrihet përtej çdo lufte.”¹⁰

Ai mendon se strategjia është diçka e ngjashme, por jo e njëjtë me strategjinë e madhe: “Sikurse taktika është një zbatim i strategjisë në një plan më të ulët, ashtu edhe strategjia është një zbatim në një plan më të ulët i “strategjisë së madhe”.¹¹

Ndonëse pothuajse një sinonim me politikën që udhëheq drejtimin e luftës, termi “strategji e madhe” shërben për të nxjerrë në pah e kuptimin e “politikës në veprim / politikës ekzekutive”. Kjo për shkak se strategjia e madhe – strategjia më e lartë – është aty që të koordinojë të gjitha burimet e një kombi, ose një grupi kombesh, drejt suksesit të objektivit politik të luftës – qëllimi i përcaktuar nga politika themelore. Lufta nuk përfshin veç konfliktin e armatosur, por edhe luftën ekonomike, etj.

Strategjia e madhe duhet të llogarisë e të zhvillojë burimet ekonomike dhe fuqinë njerëzore të kombeve ... përfshirë burimet morale – pasi ushqimi i frymës së vullnetit të njerëzit, shpeshherë është po aq i rëndësishëm sa edhe të zotërosh format më konkrete të fuqisë. Strategjia e madhe duhet të rregullojë gjithashtu shpërndarjen e fuqisë ndërmjet shërbimeve të ndryshme dhe ndërmjet shërbimeve dhe industrisë. Veç kësaj, fuqia luftuese nuk është veçse njëri prej instrumenteve të strategjisë së madhe – e cila duhet të llogarisë dhe të aplikojë fuqinë e presionit financiar dhe jo më pak, të presionit etik, për të dobësuar vullnetin e kundërshtarit.

Gjithashtu, teksa horizontet e strategjisë janë të kufizuar nga lufta, strategjia e madhe sheh përtej luftës, tek paqja pasuese. Ajo nuk duhet të kombinojë vetëm instrumentet e ndryshme, por të sistemojë gjithashtu edhe përdorimin e tyre, sikurse të shmangë edhe dëmtimin e gjendjes së ardhshme të paqes – me qëllim sigurinë dhe prosperitetin e saj. Gjendjes së brengosur së paqes, për të dyja palët, e cila ka pasuar shumicën e luftërave, mund t’i gjendet filli te fakti, i pangjashëm me strategjinë, se mjedisi i strategjisë së madhe është

¹⁰ B. H. Liddell Hart IN KEANE, Michael; “Dictionary of Modern Strategy and Tactics”; Naval Institute Press, 2005; f.133.

¹¹ Po aty.

për pjesën më të madhe *terra incognita* – ende në pritje të eksplorimit dhe të kuptimit.¹²

Nëse do të përpiqeshim të gjenim një copëz të ngjashme me atë të vizionit të strategjisë së madhe, atë mund ta vëmë re te preambula e Kushtetutës së RSH:

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, *me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar*, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, Vendosim këtë Kushtetutë”.¹³

Kjo aspiratë shekullore mund të jetë ajo që flisnim më sipër, - shtrati shekullor në të cilin lëvizin strategjitë e mëdha. Sidoqoftë, kjo aspiratë shekullore e përmendur në Kushtetutë nuk është e përmendur në SSK, të paktën në versionin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Parathënia e SSKRSH 2014, fillon kështu:

“Siguria, liria dhe mirëqenia janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuar dhe përfaqësojnë themelet mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe *progresi i kombit. Garantimi i një mjedisi që ofron siguri dhe liri për qytetarët është përgjegjësia parësore e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) të Republikës së Shqipërisë (RSH)*”.¹⁴

Faktikisht, shqiptarët kanë një veçori që nuk e kanë të gjithë kombet: shpërndarjen në rajon e kanë përtej kufijve shtetërorë të RSH-së, në të gjitha anët e kufirit tokësor. Pra të kesh një impenjim që prodhon *liri dhe siguri* për kombin, duhet të jetë *përgjegjësia parësore* jo vetëm brenda kufijve shtetërorë të RSH-së (nëse nuk e

¹² HART, Liddell cituar: BARTHOLOMEES, J. Boone, Jr.; ‘A Survey of Strategic Thought’: “U.S. Army War College Guide to National Security Policy and Strategy”; DIANE Publishing, 2004, f.80.

¹³ “KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”; publikuar zyrtarisht në format elektronik në: http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta_perditesuar_15171_1.pdf; Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor.

¹⁴ “STRATEGJIA E SIGURISË KOMBËTARE”, qershor 2014, http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf; f.3.Të gjitha referimet ndaj SSK 2014 do të jenë nga dokumenti i publikuar në këtë adresë.

kemi ne, cili shtet duhet ta ketë?!). Natyrisht që kjo përgjegjësi nuk është “premtim” për trazira, ndryshime kufijsh, etj, por është një përkujdesje dhe gjithë-përfshirje kombëtare krejt natyrale (mund të marrim shembull nga fqinjët se si i kanë strategjitë për minoritetet e tyre).

Preambula e SSKRSH 2014 thotë: “Në themel të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë është *aspirata e popullit shqiptar* dhe vullneti politik për të realizuar vizionin e përbashkët, për një atdhe që garanton siguri, drejtësi, barazi dhe mirëqenie për të sotmen dhe brezat e ardhshëm; një vend i lirë, demokratik dhe i zhvilluar, anëtar i përkushtuar i NATO-s dhe i integruar në Bashkimin Europian”.¹⁵ Natyrisht që ky “kujdes” ose “citim” i pasaktë i Kushtetutës së RSH (“*me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar*”), jep pa fjalë pafuqinë e të dalit zot ndaj asaj ç’ka përcakton e sjell përballë e ardhmja, në mënyrë të pashmangshme.

Nga sa më sipër bëhet i qartë fakti i mungesës së një “strategjie të madhe” për kombin tonë. Një strategji e tillë detyrimisht duhej të ishte për gjithë shqiptarët, në rajon po se po, por edhe me vëmendje të veçantë për shqiptarët e shpërndarë në botë. Për këta të fundit, mund të krijoheshin programe të veçanta që do të mund të aktivizonin një potencial të fjetur lobimi e financimi shqiptar. Strategjitë e vendeve të ndryshme ka raste që fillojnë edhe me një rishikim historik të strategjive të tyre, gjë që bën një rifreskim të arritjeve e objektivave strategjike. Ky rishikim historik, është konfirmimi që strategjia kombëtare dhe natyrisht strategjia e madhe, janë rruga e pandryshueshme në të cilën kalon kombi – kjo rrugë është më e rëndësishme se sa interesi politik i individit ose forcave politike. Mungesa e një strategjie të madhe, moszbatimi dhe mostrajtimi me seriozitet ndër gjithë këto vite i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, mangësitë e forcave politike në trajtimin e çështjeve të sigurisë, çojnë në shmangie nga përballja me problemet e vërteta të fuqizimit e të rritjes së sigurisë së kombit shqiptar – kjo gjë mund të konsiderohet si një rënie, në të cilën të shpëtojnë vetëm ndërhyrjet nga aktorët që “mirëmbajnë” sistemin ndërkombëtar. Pra nëse e ndajmë në këtë mënyrë zbatimin: a) nivel taktik; b) nivel strategjik dhe c) nivel i strategjisë së madhe, Shqipëria mund të konsiderohet si zbatuese e nivelit taktik. Ky nivel merret kryesisht me trajtimin e momentit dhe me paparashikueshmërinë që del nga mungesa strategjike. Themeli i nivelit strategjik është trajtimi me vërtetësi dhe kujdes të veçantë i fuqisë kombëtare. A do të mundë SSKRSH-2014 që të konsolidojë nivelin strategjik? Po fuqinë kombëtare?

¹⁵ “STRATEGJIA E SIGURISË KOMBËTARE”, qershor 2014, http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf; f.3. Të gjitha referimet ndaj SSK 2014 do të jenë nga dokumenti i publikuar në këtë adresë.

STRATEGJIA DHE NJË FORMULË E FUQISË KOMBËTARE

Një nga gjërat më të vështira të strategjisë është përlogaritja e veprimeve pasi shpesh herë këto veprime e madje edhe synimet strategjike, mbështeten tek llogaritja e fuqisë. Në rastin konkret, llogaritja e fuqisë kombëtare është ajo që do të ndihmonte për një vlerësim më të saktë të mundësive të realizimit të strategjisë. Strategjia synon shtimin e fuqisë kombëtare dhe anasjelltas, një fuqi kombëtare e shtuar shtyn drejt hapësirash më të gjera strategjike, drejt qëllimesh më ambicioze (shembuj ka shumë, por ja dy: fuqizimi amerikan, influenoi ndërtimin e një strategjie me ambicie globale; fuqia e Turqisë solli hapjen strategjike të paraqitur nga Davutogllu, etj). SSK-ja është një element i gërshetuar me elementët e tjerë të fuqisë. Ky element në një pjesë të mirë të rasteve rezulton, në mos më i rëndësishmi, si nga më të rëndësishmit. Fuqia kombëtare mund të jetë relative, pra jo saktësisht e matshme. Sidoqoftë ajo ka elementë të cilët janë të llogaritshëm. Të paktën, strategjia, mund të shihet nëse nuk funksionon ose nëse nuk jep rezultat. Dinamika e mjedisit dhe e aktorëve bën që vlerësimi për fuqinë kombëtare të ndryshojë me kalimin e kohës dhe me ndryshimin e fuqisë së aktorëve ndikues. Kjo është një arsye e mirë që strategjia e sigurisë kombëtare, nëse është e ndërtuar me efikasitet të përfitojë nga përparësitë që sjell transformimi i mjedisit strategjik ose të minimizojë humbjet e mundshme të fuqisë. Nëse kjo strategji nuk shfrytëzon si duhet kinetikën e sistemit e të mjedisit ku zhvillohet, pasoja është reduktimi i fuqisë kombëtare. Natyrisht që fuqia kombëtare e reduktuar, minimizon edhe qëllimin strategjik të një shtet-kombi, pasi objektivat e mundshëm që mund të arrijë një strategji kombëtare varen nga fuqia.

Me fjalë të tjera, ashtu si në të gjitha përpjekjet strategjike, gjatë vlerësimit se ku qëndron një shtet-komb në raport me fuqinë e aktorëve të tjerë rajonalë e globalë, plekset më shumë arti se sa shkenca. Kjo gjë nuk e ka frenuar një ish-zyrtar qeveritar që të krijojë një formulë për zhvillimin e një llogaritje të vështirë të fuqisë kombëtare “të perceptuar” – e fokusuar kryesisht te aftësia e shtetit për të bërë luftë:

$$F_p = (M + E + U) \times (S + V)$$

Përbërësit e kësaj formule:

F_p = Fuqia e perceptuar

M = Masa kritike: popullsi dhe territor

E = Ekonomia, mundësitë

U = Ushtria, mundësitë

S = Strategjia, qëllimi strategjik

V = Vullneti për ushtrimin e Strategjisë Kombëtare

Pavarësisht nga kontributi i saj i mundshëm në përlllogaritjen e vlerës së F_p , kjo formulë jep disa leksione të rëndësishme. Elementet më të prekshëm, (M, E, U), të cilët mund të jenë të përcaktuar në mënyrë objektive, përfshijnë gjithashtu edhe cilësi të ndryshueshme cilësimesh subjektive: territor që mund të jetë i gjerë, por i mbuluar me vargmale dhe që ka pak lumenj të lundrueshëm; një popullsi që është e madhe, por e pakualifikuar dhe e paarsimuar; ose rastet në të cilët, pavarësisht kualifikimit ushtarak superior në teknologji dhe armë nga njëra anë, kundërshtari, është i aftë që të triumfojë nëpërmjet superioritetesh të pakapshme, të cilat renditen që nga aftësia drejtuese deri te morali. Ç'është më e rëndësishmja, duke demonstruar se fuqia kombëtare është një produkt – jo një shumë – e përbërësve të vet, formula të sjell ndërmend se sa të rëndësishëm janë aspektet relative dhe kontekstuale. Shtetet e Bashkuara të Amerikës zbuluan në Vietnam se nuk ka rëndësi se sa e lartë është shuma e aftësive të prekshme, ekonomike dhe ushtarake, në raport me një kundërshtar ku vlefshmëria e të cilit është e përcaktuar nga aftësitë e qëllimit strategjik (S) dhe të vullnetit kombëtar (V). Zero shumëzim për çdo numër, pa pasur rëndësi se sa i madh është ai numër, jep rezultatin zero.¹⁶

Pra, po qe se e marrim në konsideratë këtë formulë, nëse $(S + V) = 0$, atëherë F_p kombëtare shqiptare do të ishte e barabartë me zero. Si strategjia edhe vullneti politik për ta zbatuar SSK-në në Shqipëri, në dekadën e fundit kanë qenë një zero konstante – për këtë nuk ka dyshim. Mjafton të përmendim faktin se ky dokument i rëndësishëm i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, u miratua për herë të fundit në vitin 2004 dhe pati një kohëzgjatje trevjeçare, deri në vitin 2007. Nëse SSK-ja do të kishte rëndësinë që thuhet rëndom nga politika se ky dokument ka, atëherë në këto shtatë vite që Shqipëria pati një dokument të vjetruar, me sfida të tejkaluara dhe të pavlera, do të ishin marrë hapa për ta rinovuar. Por nuk u ndërmor asnjë hap. Një pjesë e madhe e politikanëve shqiptarë, sigurisht që as nuk ka qenë në dijeni të kësaj mungese. Jemi përballë një shembulli ku S (strategjia) = V (vullneti politik) = 0. Thënë kjo, merret menjëherë me mend se sa fuqi kombëtare të perceptuar mund të kishte Shqipëria. Në vendet me fuqi shtetërore tradicionale, SSK-ja është një “Bibël” e cila përcakton fatet e kombit. Edhe në Shqipëri kjo “Bibël” i përcakton fatet, por me mungesën e zbatimit të saj i përcakton negativisht.

¹⁶ JABLONSKY, David; “National Power” (ff. 145-163); U.S. Army War College, Guide To National Security Issues, Volume I: Theory Of War And Strategy, 3rd Edition, Department of National Security and Strategy, June 2008, USA.

VËSHTRIM KRITIK MBI SSKRSH 2014

Duke pranuar *a priori* se për SSKRSH-2014 do të ketë një vullnet pozitiv politik dhe se në dekadën në vijim ky dokument do të perfeksionohet, shfaqet vetvetiu sfida e ngritjes së fuqisë kombëtare. Elementët e fuqisë i sheh të shpërndarë nëpër fragmente të SSKRSH, por realisht mungon një sinkronizim teorik dhe praktik. Me fjalë të tjera, ne nuk i kemi të renditur mirëfilli dhe nuk ka ekzistuar në këto vite një praktikë e ekzekutimit të politikës shtetërore e cila të demonstrojë se fuqia kombëtare është impenjimi kryesor i saj (madje, gjenden mjaft shembuj që tregojnë një vullnet politik zhbërës të fuqisë kombëtare). Ka studiues të ndryshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare të cilëve mund t'u referohesh për fuqinë kombëtare, por besoj se strukturimi që i bën asaj Hans J. Morgenthau, është ndër më klasikët e ndër më të lexuarit në Shqipëri.¹⁷

Duke ndjekur këtë strukturë, mund të shohim se si thelbi i fuqisë së kombit është vendimtar në përcaktimin e strategjisë. Thelbi i fuqisë së kombit qëndron si në elementët e pandryshueshëm edhe në ata të ndryshueshëm, por faktori bazë padyshim që është gjeografia e një vendi. Për sa i përket këtij faktori, Shqipëria mund të thuhet se favorizohet në kohë paqeje dhe mund të jetë nën presionin e kërcënimit në kohë lufte – kjo për shkak të rrugëkalimeve në të cilat ndodhet. Po qe se mendojmë harrimin e Korridorit të rëndësishëm XVIII ose investimet e pakta në rrjetet hekurudhore, porte e aeroporte, mund të themi se nuk kemi asnjë strategji që do zgjaste në dekada, për të na integruar në gjeosistemin ballkanik, europian, apo edhe detar-mesdhetar. Po kaq e dobët është edhe strategjia e dy-tre dekadave të fundit për shfrytëzimin e burimeve minerare kombëtare.

Natyrisht që është ambicioz ky deklaram në domosdoshmëritë strategjike të SSKRSH 2014:

“Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik do të arrihet duke: Inkurajuar rritjen e vlerës së burimeve natyrore përmes përpunimit sa më të thellë të tyre në vend dhe dekurajimit të eksporteve të lëndëve të para të papërpunuara [...] Zbatimi dhe monitorimi i politikave për të zhvilluar burimet natyrore në mënyrë transparente, të qëndrueshme dhe të kontrolluar”.¹⁸

Por edhe pse ambicioz, duket si përsëritje e asaj që thuhej në vitin 2006 në strategjinë e miratuar për zhvillimin e industrisë minerare e cila premton se kishte: “Vizion të saj një zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje përmes burimeve minerare dhe energjetike,

¹⁷ MORGENTHAU, Hans J.; “Politika ndërmjet kombeve, Lufta për pushtet dhe paqe” (Shqipëroi: Tonin Beci; Origjinali: Politics among nations, the struggle for power and peace); Shtëpia botuese: Tirana Times; Tiranë 2008.

¹⁸ SSKRSH 2014, f.8.

në dobi të Ekonomisë”.¹⁹ Slogani i saj “Minerale dhe Energji për një zhvillim të qëndrueshëm” duke ruajtur përherë Vlerat e saj profesionalizmin dhe transparencën.

Nisur nga eksperiencia e deritanishme dhe nga mungesa e një strategjie konkrete për shfrytëzimin sa më efikas të burimeve natyrore e të detajuar se si do të arrihet kjo gjë, mbetet për t’u parë nëse ky element do të luajë rol në fuqinë kombëtare.

Shqipëria, dikur e katërta në botë për krom: “Si rezultat nxjerrja e kromit është shtuar 155 herë dhe sot Shqipëria renditet e katërta në botë për nxjerrjen e këtij minerali; nxjerrja e qymyrit është rritur në 577 herë”²⁰ - sot rrezik mund të jetë e katërta në botë për numrin e viktimave nëpër miniera dhe kjo tregon qartë seriozitetin e trajtimit të këtij sektori.

Sipas të njohurës “Geological Survey”, Shqipëria ka pasuri përrallore burimesh natyrore: dhe minerare. “Botimi i 2001 i kësaj reviste deklaronte se burimet e mundshme minerare janë (në milionë tonë) krom: 5; bakër: 45-50; nikel: 500; qymyr: 350. Aktivitetet e shkuara dhe të tashme industriale bazohen në përdorimin e burimeve natyrore si lëndë e parë e papërpunuar”.²¹

Nëse këtë përshkrim gjeologjie e përkthejmë në “gjuhën” e Morgenthaut, do të thuhej Shqipëria ka mundësi të ketë “fuqi përrallore kombëtare”. Ushqimi – edhe ky është një element jo pa rëndësi i fuqisë kombëtare. Prodhimi vendas bujqësor dhe blegtoral i ulur në maksimum dhe pa një strategji afatgjatë për rimëkëmbjen e tij nuk i japin një pikë të fortë as këtë herë fuqisë kombëtare. Nëse do të kishte një investim serioz, futje të teknologjisë së re, orientim të asaj pjese prodhuese të popullsisë ndaj tregjeve, rezultatet mund të ishin më të vlefshme sa duken. Ndër krizat kryesore të botës së dekadave të ardhshme janë uji i ëmbël dhe ushqimi.

“Deri në vitin 2030, bazuar në një skenar mesatar të rritjes ekonomike dhe nëse nuk llogariten fitimet e prodhimit, kërkesat globale për ujë të ëmbël do të rriten nga 4.500 miliard m³ që janë sot, në 6.900 miliard m³. Kjo shifër është 40% më e lartë se sa furnizimi aktual të mundshëm, i sigurt, me ujë (përfshirë fluksin e rikthimit dhe duke marrë parasysh se një pjesë e furnizimit duhet të rezervohet për kërkesat mjedisore)”.²²

¹⁹ “STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS MINERARE”; Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Tiranë, maj 2006, f.6.

²⁰ WINNIFRITH, Tom; Perspectives on Albania; Macmillan Academic and Professional, 1992, f.133.

²¹ UNITED NATIONS, ECONOMIC COMMISSION FOR EUROPE, COMMITTEE ON ENVIRONMENTAL POLICY; “Environmental Performance Reviews, Volume 24 di Environmental performance reviews series; United Nations Publications, 2007, f.87.

²² WATER RESOURCES GROUP; “Charting Our Water Future, - Economic frameworks to inform decision-making”; Copyright © 2009: The Barilla Group, The Coca-Cola Company, The

Por në SSKRSH 2014 nuk flitet gjerësisht për këtë gjë. Zor të mendohet se ka grupime të gjera politikanësh që të mendojnë se uji i ëmbël do të jetë burim konfliktesh në një të ardhme të afërt. SSKRSH 2014 e përmend veç tre herë ujin, por jo të lidhur me ndonjë strategji shfrytëzimi të ujërave të ëmbla, apo me ndonjë rrezik që vjen prej tij (Shërbimet Inteligjente të SHBA e fusin te rreziqet konkrete të së ardhmes së afërt):

“Zbatimi i një strategjie kombëtare, transparente dhe të integruar, për garantimin e sigurisë energjetike, duke shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme *pasuritë ujore* [...] Parandalimi i degradimit mjedisor dhe reduktimi i pasojave të ndryshimeve klimatike, duke menaxhuar me efektivitet *basenet ujore* [...] Shqipëria është e prekur dhe rrezikohet edhe në të ardhmen nga erozioni [...] Në brendësi të territorit, erozioni parashikohet të shkaktojë reduktim të tokës së punueshme dhe *burimeve ujore*”²³

Ky element kaq i vlefshëm jetësor dhe kaq i rëndësishëm për dekadat ku jetojmë, nuk është menaxhuar dhe s’po menaxhohet në atë formë sa të shtojë fuqinë kombëtare shqiptare, do të ishte arritje, së paku, mos shpërdorimi. Nëse do të vazhdonim më tej mund të prekim edhe një element tjetër të rëndësishëm të fuqisë kombëtare, atë të popullsisë. Ky element është i kombinuar nga dy shtresa: sasia dhe cilësia. Të dyja janë të rëndësishme dhe të dyja shtojnë osë pakësojnë fuqinë e një kombi. Popullsia dhe shpërndarja në territor (ky koncept gjeopolitik i parrahur fare në analizat tona të sigurisë) ndikojnë drejtpërsëdrejti te fuqia kombëtare. SSKRSH 2014 me të drejtë vëren se: “Miliona njerëz kanë dalë nga varfëria ekstreme, *ndërkohë që popullsia globale po rritet, çka shton presionet demografike mbi vendet e zhvilluara*. Kjo prirje do të vijojë të mbetet e tillë.”²⁴ Por nëse këtë “mjedis strategjik” (siç e quan SSKRSH 2014) global e minimizojmë brenda hapësirës sonë kombëtare, do të shihnim se shprehja “*as above so below*” (si e madhja dhe e vogla) qëndron. Ne kemi një zhvendosje të popullsisë brenda Shqipërisë e cila nuk pati asnjë orientim dhe krijoi harta demografike që nuk i kemi parë kurrë më parë në historinë e vendit tonë. Ky migrim i brendshëm u shty fillimisht nga eliminimi i shërbimeve mjekësore, arsimore dhe atyre që kanë lidhje me ndërtimin e një jetese si energji elektrike, furnizim me ujë të pijshëm, etj, në zonat rurale apo qyteza e qytete të dorës së dytë. Presioni i të varfërve që donin kushte dhe i të pasurve që donin të investonin, mbi qytetet e mëdha, solli postimin e popullsisë drejt ultësirës dhe një akumulim në një trekëndësh në

International Finance Corporation, McKinsey & Company, Nestlé S.A., New Holland Agriculture, SABMiller plc, Standard Chartered Bank, and Syngenta AG. Ky raport u financua nga Banka Botërore.

²³ SSKRSH 2014, f.9,15,22.

²⁴ SSKRSH 2014, f.19.

Shqipërinë e mesme, me aksin Tiranë-Durrës të mbipopulluar në mënyrë të pakrahasueshme me asnjë periudhë tjetër. Por popullsia, ashtu si dhe uji përmendet veç tre herë edhe në Shtojcën C të klasifikimi i rrezeve: *“Shfaqje e një pandemie që kërcënon në masë shëndetin publik të popullsisë.”* Natyrisht që një pandemi është një rrezik i madh dhe popullsia duhet ruajtur nga ky rrezik. Lind pyetja, po nga vetvetja dhe nga mungesa e strategjisë demografike, kush duhet ta ruajë popullsinë? Sipas shifrave të Censurit 2011 nga INSTAT: Tirana - 749 365 banorë (454 banorë për km²); Durrësi - 262 785 banorë (343 banorë për km²); Fier- 310 331 banorë (164 banorë për km²); Elbasan- 295 827 banorë (92 banorë për km²). Këto shifra flasin vetë se në cilën hapësirë është e përqendruar popullsia shqiptare (2 800 000 sipas po këtij censuri).²⁵

Ajo që është më e vështira, nuk është një Plan Rregullimi për territorin, por një plan për (ri)shpërndarjen sa më të saktë popullsisë. Kjo do të kërkonte një strategji e cila të mbështetej te rivitalizimi i rrjeteve të brendshme të transportit fillimisht dhe te një trajtim i cili i referohet edhe historisë e padyshim gjeografisë sonë të brendshme. Kjo gjë mungon. Dëmtimi nga ky migrim është në planin strategjik, atë të mbrojtjes e sigurisë, të shfrytëzimit të hapësirës kombëtare, të shkatërrimit të mjedisit, të zbehjes së mundësisë për shfrytëzimin e zonave rurale, të shkatërrimit kulturor të zonave me trashëgimi të pandërprerë historike, etj. Një dëmtim akoma edhe më i madh është shpërdorimi i energjisë njerëzore – me mijëra shqiptarë me paratë e fituara në emigrim apo në Shqipëri, ndërtuan fushave, kodrave, shesheve e ku mundën, në mënyrë të paplanifikuar e thuajse 100% të paligjshme. Risistemimi i territorit shumëzoi me zero këtë energji disavjeçare. Kjo është kostoja e mospasjes/moszbatimit të një Strategjie të Sigurisë Kombëtare.

Mbi këtë element të fuqisë kombëtare, popullsinë, vendi ynë ka edhe një problem tjetër: emigracionin. Si rrallë më parë, nuk është parë një emigrimi tillë i shqiptarëve. Shifra të tilla emigrimi të kujtojnë ikjet masive të arbërve pas rënies së Shqipërisë nën pushtimin osman. Ndërkohë, ka lindur me kohë nevoja që të ketë një ndërmarrje më serioze dhe më të organizuar në lidhje me atë pjesë shqiptarësh që jeton jashtë Shqipërisë. Për rëndësinë, emergjencën dhe nevojën që paraqet kjo çështje, nëse do të ndërtohej një ministri, nuk do të ishte gjë e tepërt. Menaxhimi i ndershëm i emigrantëve mund të rezultonte më i vlefshëm për shtetin shqiptar se sa për vetë emigrantët. SSKRSH 2014 e njeh këtë problem:

“Shqipëria përballet me fenomenin e emigracionit masiv. Rrjedhja jashtë vendit e potencialit njerëzor ka ndikuar

²⁵ INSTAT 2011, “Censuri i popullsisë dhe banesave”, Popullsia banuese, sipërfaqja dhe dendësia sipas qarqeve, f.133.

negativisht në zhvillimin shoqëror, ekonomik, kulturor e shkencor, si dhe në ngadalësimin e ritmeve të rritjes së prodhimit të brendshëm. *Një pjesë e konsiderueshme e fuqisë aktive punëtore të vendit kontribuon në ekonominë e vendeve të tjera*".²⁶

Në këtë mënyrë është përcaktuar qartë reduktimi i fuqisë kombëtare nëpërmjet këtij fenomeni që prek elementin popullsi, por nuk ka pasur ndonjë strategji konkrete që do të ngjallte rikthimin e këtyre të ikurve – përveçse atyre në letër, por kurrë të zbatuara në mënyrë serioze.

Për të qëndruar përsëri te popullsia, por në një aspekt tjetër të fuqisë kombëtare: prirjet e popullsisë. Në SSKRSH 2014 forcimi i kohezionit shoqëror dhe identitetit kombëtar jepet kështu në këtë paragraf:

“Forcimi i kohezionit shoqëror dhe identitetit kombëtar: Kohezioni shoqëror është faktor vendimtar për garantimin e sigurisë kombëtare dhe të ardhmen e vendit. Shqipëria ka një popullsi etnikisht homogjene, të re dhe dinamike. *Vendi vjen nga një e kaluar e vështirë historike, e cila ka lënë gjurmë në organizimin e brendshëm shoqëror, duke krijuar jo rrallë ndasi dhe mungesë konsensusi shoqëror e politik.* Këta faktorë kanë ndikuar në rrjedhën e zhvillimit normal ekonomik, shoqëror, politik e kulturor”.

Në fakt, nga e kaluara ka një trashëgimi që synonte të kundërtën e asaj që përmendet më sipër. Sistemi monist synoi bashkimin e brendshëm nëpërmjet shkrirjeve të kufijve të brendshëm krahinorë. Kjo gjë u arrit, duke zbehur organizimin fisnor të shqiptarëve dhe duke i lejuar hapësirë veprimi organizimit shtetëror. Mund të përmenden me qindra raste, të cilët janë të mbështetur sot, pikërisht tek e kundërta, të favorizimi farefisnor, krahinor, fetar, klanor, miqësor, etj, të cilët janë bërë edhe mënyra e vetme me të cilën funksionojnë emërimet në shtetin e politikën shqiptare të dekadave të fundit. Eliminimi i meritokracisë ka sjellë edhe eliminimin e fuqisë së institucioneve, fuqisë së shtetit dhe ka prodhuar ulje tërësore të fuqisë kombëtare. Mënyra se si janë hequr nga institucionet shqiptare për vite me radhe teknikienët më të aftë, gjithnjë ose në emër të punësimit të militantëve ose në emër të punësimit “të miqve”, është një tymnajë që fsheh një operacion makabër, ku po që se shtetin do e krahasonim me një organizëm, atij iu hoqën thuajse gjithë organet jetike duke i lënë vetëm aparatit artificial të frymëmarrjes. Ky operacion, naiv ose jo, që u shtri në periudhën e quajtur tranzicion, ka dy shpjegime: papërgjegjshmëri e politikanëve ose thërrmim i

²⁶ SSKRSH 2014, f.22.

qëllimshëm i instrumenteve shtetërore për interesa jo-shqiptare. SSKRSH 2014, duhet ta shohë më në thellësi arsyen se përse ndodh kjo “*ndasi dhe mungesë konsensusi shoqëror e politik*”.

Në këtë mënyrë kemi prekur edhe një element tjetër të fuqisë kombëtare, cilësinë e qeverisjes, që në SSKRSH-2014 paraqitet si një objektiv vendimtar: “*Domosdoshmëritë strategjike dhe objektivat mbështetëse përfshijnë forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, forcimin e institucioneve shtetërore*”.

Cilësia e qeverisjes varet edhe nga cilësia e parlamentarëve tanë, të cilët jo pak herë kanë treguar se në lidhje me sigurinë kanë koncepte jo fort të qarta. Nëse në shtetet e zhvilluara përqafohen teoritë e sigurisë apo të marrëdhënieve ndërkombëtare nga forcat e caktuara politike, këtu në Shqipëri kjo gjë nuk ndodh. Nuk kemi konstruktivistë që të përballen me realistë, nuk kemi politikanë që mbështesin “dilemën e sigurisë” e të tjerë që argumentojnë të kundërtën, nuk ka as nga ata që janë me një strategji të qartë se si Shqipëria duhet të jetë e organizuar me shtetin si aktorin më të fuqishëm e nuk ka as nga ata që vendosin organizatat në plan të parë, nuk kemi liberalë që luftojnë me konservatorë, etj, - thënë me pak fjalë e kemi të ulët cilësinë e politikanëve dhe kjo sjell cilësi të dobët qeverisje. Edhe brenda partive ku krijohen politikanët, ashtu si edhe në shtet, ekzistojnë formulat e bazuara në lidhje të tjera, jo në zbatim të frymës së meritokracisë, demokracisë në organizata, rotacionit etj. Partitë politike janë një aset i madh kombëtar, pasi prej tyre dalin ata që udhëheqin shtetin; nuk i kemi parë asnjëherë si pasuri kombëtare partitë tona! Ky element i fuqisë kombëtare përsëri nuk është i konsideruar si pikë e fortë në llogaritjen që bëjmë. SSKRSH 2014 ka shansin të tregojë se si mund të përmirësohet cilësia e qeverisjes dhe e përfaqësuesve politikë, nëse kjo gjë konsiderohet fuqizim kombëtar.

Një tjetër element i fuqisë kombëtare janë edhe Forcat e Armatosura (FA), por në nivelin që ka rënë kufizimi i tyre ato nuk përbëjnë më një shtyllë të fuqisë kombëtare. Shifra e FA shqiptare sot është e krahasueshme me atë të viteve ‘20. Nëse shifra do të ishte e parëndësishme, ajo do të kompensohej nga aftësia e drejtimit dhe nga cilësia e teknologjisë moderne në drejtim. Sa i përket drejtimit, duhet thënë se FA janë në vazhde reformash të pandërprera dhe akoma nuk ka një stabilitet përfundimtar; përse i përket modernizimit dhe teknologjisë, edhe kjo gjë është akoma larg asaj që und të quhet një ushtri moderne. Pavarësisht vështirësive (shpesh herë të mbjella nga politika) FA shqiptare kanë dhënë një produkt të vlefshëm ndërkombëtar – numri i misioneve është i lavdërueshëm dhe gatishmëria politike e Shqipërisë në lidhje me strategjitë e NATO-s e ato perëndimore ka qenë gjithnjë i cituar si vullnet për tu marrë shembull. Kjo frymë pozitive na jep mundësinë për të kërkuar më

shumë, por duhet të pasur një strategji më serioze e zhvillimit të fuqisë ushtarake shqiptare.

Natyrisht që një nga elementet bazë të fuqisë kombëtare është edhe diplomacia. Shfrytëzimi i potencialeve të partneriteteve strategjike duket se është një objektiv ambicioz i SSKRSH 2014:

“Politika e jashtme e RSH do të vijojë të ndërtohet rreth boshteve të saj të konsoliduara: Politika konstruktive rajonale, e mbështetur në parimet e bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë, përfshirjes së barabartë dhe pa kushte të gjithë vendeve në proceset rajonale dhe përparimit të drejtave të pakicave; Partneriteti strategjik me SHBA-të si faktor me rëndësi themelore në funksion të konsolidimit të demokracisë, paqes, zhvillimit dhe proceseve integruese të vendit dhe rajonit.”²⁷

Por nëse shohim praktikën e deritanishme, ku misioni ynë diplomatik në SHBA, në vendin që e kemi konsideruar partnerin kryesor strategjik, është tej mase i tkurrur, atëherë edhe vlera që i japim këtij partneriteti vetkuptohet. Nuk ka vlerë që të kemi si pikë orientimi Ambasadorin amerikan në Tiranë – natyrisht figurë shumë e respektuar –por është e nevojshme që të njohim mendësinë strategjike amerikane. Dhe meqë jemi tek kjo e fundit, e meqë përdorim shpesh fjalën partner strategjik, a nuk do të ishte e udhës që të kishte një informim të gjerë publik e madje edhe për politikanët në lidhje me strategjinë amerikane dhe pozicionin se ku ndodhemi ne në këtë botë komplekse? Por ekzistojnë pak tituj nga studiues amerikanë që të kenë ardhur te shqiptarët. Orientim shtetëror për të kuptuar partnerin tonë strategjik ka akoma edhe më pak. Teksa përmendet rajoni në SSKRSH-2014 “harrohen” shqiptarët e Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë. Nuk është tabu trajtimi i tyre. Papjekuria në trajtimin e realitetit të mjedisit të sigurisë është më e rrezikshme se sa trajtimi me vërtetësi i çështjeve të mprehta. Pas marrëveshjes strategjike të Prizrenit (2014) lihet në heshtje Kosova. E të gjitha këto zbehje e problematika natyrisht që ulin edhe një element tjetër të fuqisë kombëtare, “moralin kombëtar” i cili sjell deformimin e elementit tjetër që lidhet me të, “mbështetja shoqërore”. Me moral të rënë dhe me një fragmentizim shoqëror të theksuar ndaj qëndrimeve për çështjet kryesore të sigurisë, zor se arrihet efekti i mrekullueshëm që kanë arritur popujt me moral maksimal e me bashkim të palëkundshëm. Rritja e këtij elementi të fuqisë kërkon operacione psikologjike të sofistikuara të cilat të kenë në bazë ushqimin e vlerave më të mira të shoqëria. Dhënia e modeleve frymëzuese është një domosdoshmëri. Sipas SSKRSH 2014:

²⁷ SSKRSH 2014, f.13.

“Forcimi i kohezionit shoqëror dhe identitetit kombëtar do të arrihet duke: Zbatuar një program kombëtar për kultivimin e kulturës e gjuhës shqipe; Zgjidhur çështjen e pronës dhe përfunduar procesin e urbanizimit përmes legalizimit të zonave informale. *Përfunduar procesin e dëmshpërblimit ekonomik dhe moral të të përndjekurve politikë të diktaturës komuniste, me qëllim integrimin e plotë të kësaj shtrese në shoqëri.*”²⁸

Për sa i përket gjuhës, edhe kjo rrezikohet nga rishikimi standardit. Teza Kosova dhe Shqipëria janë dy kombe me dy gjuhë të ndara, duket se shpërblehet naivisht nga rishikimi i gjuhës standarde që kërkohet së fundi: *“dy gjuhë standarde [...] proces që çon në formimin e dy kombeve të veçanta, siç ndodhi me serbët dhe kroatët.”*²⁹. Gjuha mund të bëhet edhe çështje sigurie, kur kultura, identiteti, kombi etj vihen nën shënjestër nga kundërshtari me qëllim pakësimin e fuqisë kombëtare, përçarjen dhe shmangien nga objektivat strategjike realë. Por dëmshpërblimi për të përndjekurit dhe prona zor se ka lidhje me identitetin apo kohezionin.

Identiteti duket qartë si ruhet sapo kujtojmë shkatërrimin e pamëshirshëm e sistematik të monumenteve të kulturës. SSKRSH 2014 është shpresëdhënëse në këtë drejtim, por siç e thamë strategjitë kanë qenë dhe më parë. Mbetet veç të shohim efikasitetin.

Elementi i fundit i fuqisë kombëtare që dua të përmend, janë shërbimet Inteligjente të një vendi ose fuqia informative. Në Shtojcën-C të klasifikimeve të rreziqeve, në SSKRSH 2014, klasifikohen si rreziqe të nivelit të dytë *“Veprimtari subversive spiunazhi kundër interesave të RSH-së”*.³⁰

Ndoshta ky rrezik duhet të ishte në nivelin e parë. Nëse marrim parasysh të gjitha detajet e shkatërrimit të fuqisë kombëtare shqiptare, element pas elementi të zbatuara në 2-3 dekada, dhe të bëjmë pyetjen “pse ndodhën?”, atëherë do të kishim dy alternativa:

- a) mungesë organizimi dhe paaftësi politike – d.m.th. shkatërrim nga elementi i brendshëm;
- b) operacione të mirë-organizuara dhe profesionale për eliminimin e fuqisë kombëtare e shtetërore shqiptare, influencuar nga faktorë joshqiptarë – shkatërrim nga elementi i jashtëm.

Në të dyja alternativat kemi të përbashkët se është shkatërruar fuqia kombëtare shqiptare. Ajo që është e dukshme është se ky

²⁸ SSKRSH 2014, f.12

²⁹ FRASHËRI, Kristo; Shkrimi u publikua në 3 maj 2014 në gazetën Shqiptarja.com (print) – gjendet në këtë adresë:

<http://www.shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=212847&IDCategoria=1#sthash.ZugNuVXI.dpuf>

³⁰ SSKSH 2014, f.25

veprim shkatërrues i shtrirë në vite, nuk ka përgjegjës konkretë. Kjo gjë vjen nga fakti se interesat kombëtare të Shqipërisë nuk ruhen nga ndonjë bazë shumë e veçantë ligjore. Shkatërrimi i administratës shtetërore, arsimit, territorit, mjedisit, i shërbimit diplomatik apo i shërbimit informativ janë cenim i interesit kombëtar. Duhet të ketë një mekanizëm të saktë frenimi dhe dënimi duhej të ishte maksimal për përgjegjësit. Natyrisht mungon konsensusi politik për formulimin e një dokumenti kornizë për raportin e interesit kombëtar me vendimmarrjen dhe natyrisht me inteligjencën. Shpesh herë veprimet politike shqiptare kanë të gjitha tiparet e veprimeve subversive – por, këto nuk shihen si rrezik(?!). Ndërtimi i një shërbimi inteligjent të aftë dhe shumë të specializuar në fusha të ndryshme shkencore, që të kryente analizë strategjike të bazuar te formulat gjeopolitike, paralel me një analizë të tillë të kryer nga diplomacia dhe paralel me një SSKRSH e cila të ishte një strategji e mbështetur në një mjedis global strategjik, gjeopolitik, të njohur thellësisht, do të ishte ndërtimi i një korace të qëndrueshme mbrojtëse për fuqinë kombëtare. Kjo kulturë strategjike për ndërtimin e shërbimeve inteligjente mungon, pra mungon fuqia kombëtare e këtij elementi. Mungon analiza e bërë në rrafshin strategjik shekullor. Kjo gjë shmanget nga qëndrime irracionale dhe justifikime ideologjike, por ndërkohë eliminojmë kështoj aktivizimin e elementit kryesor të analizës: gjeografinë. SSK-në e SHBA-së (1988) i referohet Walter Lipmanit në këtë aspekt duke konstatuar:

“Sjellja e kombeve gjatë një periudhe të gjatë kohore është më e besueshme, ndonëse jo i vetmi tregues i interesave të tyre kombëtare. Në fakt, edhe pse interesat e tyre nuk janë të përhershme, ato janë shumë të qëndrueshme [. . .] Nuk ka asnjë mister të madh se përse duhet të jetë kështu: të vërtetat e gjeografisë janë të përhershme [. . .] si rrjedhim, breza të njëpasnjëshëm njerëzish kanë prirje për t’u përballur me të njëjtat probleme të përsëritura dhe të reagojnë ndaj tyre pak a shumë në mënyra të bëra zakon. [...] Ekziston një përputhje thelbësore gjatë kohëve, kur politikat tona shqyrtohen në perspektivë historike. Interesat qendrore dhe objektivat e këtij kombi kanë ndryshuar pak që nga Lufta e Dytë Botërore.

Dimensioni i parë historik i strategjisë sonë është relativisht i thjeshtë, i qartë, dhe jashtëzakonisht i ndjeshëm. Ky dimension, është bindja se interesat më themelore të sigurisë kombëtare të SHBA-së do të rrezikoheshin, nëse një shtet ose një grup shtetesh kundërshtarë do të dominonin masën kontinentale Euroaziatike - ajo zonë e globit të cilës i referohen shpesh si heartland (“zemër e dheut”). Ne luftuam dy luftëra botërore për ta penguar që të ndodhë kjo. Dhe, që nga viti 1945, ne jemi përpjekur të fenojmë Bashkimin Sovjetik që të mos e zgjerojë avantazhin e tij gjeostrategjik për të

dominuar fqinjët e vet në Europën Perëndimore, Azi e Lindjen e Mesme dhe të ndryshonte në këtë mënyrë rrënjësisht ekuilibrin global të fuqisë, në dëmin tonë.”³¹

Natyrisht që termi Euroazi, për sa i përket strategjive tona dhe mendësisë gjeopolitike shtetërore është thujse i panjohur, por nuk është kështu për partnerët tanë strategjikë. Po përmend veç një emër të njohur për opinionin publik shqiptar, z. Philip Reeker, Zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit për Europën dhe Euroazinë. Funkcioni i tij flet qartë për hapësirën strategjike në të cilën ndodhet Shqipëria. Kjo hapësirë ka vulën e pashlyeshme të gjeografisë, e cila do të ndikojë përherë strategjitë tona. Për tu kthyer edhe një herë te çështja fillestare e një emri për SSK. Natyrisht që SSKRSH 2014 sjell një frymë optimizmi dhe shfaq seriozitet në pika të ndryshme. Ajo ka mangësi, por koha do të tregojë nëse emri i saj është apo nuk është: “SSKRSH, një dokument thjesht sa për tu pasur”.

BIBLIOGRAFIA

- “A NATIONAL SECURITY STRATEGY FOR A GLOBAL AGE”, White House, December 2000, Us Government Printing Office, Washington Dc.
- “A NATIONAL SECURITY STRATEGY, FOR A NEW CENTURY”, White House, May 1997, Us Government Printing Office, Washington Dc.
- “A NATIONAL SECURITY STRATEGY, OF ENGAGEMENT AND ENLARGMENT”, White House, July 1994, Us Government Printing Office, Washington Dc.
- “BRITAIN IN AN AGE OF UNCERTAINTY: THE NATIONAL SECURITY STRATEGY”; Printed In The Uk For The Stationery Office Limited On Behalf Of The Controller Of Her Majesty's Stationery Office, London 2010.
- “KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”; Publikuar Zyrtarisht Në Format Elektronik:
[Http://www.Parlament.al/Web/Pub/Kushtetuta_Perditesuar_15171_1.Pdf](http://www.Parlament.al/Web/Pub/Kushtetuta_Perditesuar_15171_1.Pdf); Miratuar Me Ligjin Nr. 8417, Datë 21.10.1998 Të Kuvendit Popullor.
- “National Security Strategy”, White House, January 1988, Us Government Printing Office, Washington Dc; Feddocs Pr 40.2 : Se 2/988.
- “STRATEGJIA E SIGURISË KOMBËTARE”, Qershor 2014,
[Http://www.Parlament.al/Web/Pub/Teksti_17880_1.Pdf](http://www.Parlament.al/Web/Pub/Teksti_17880_1.Pdf)
- “Strategjia E Zhvillimit Të Industrisë Minerare”; Ministria E Ekonomisë Tregtisë Dhe Energjetikës, Tiranë, Maj 2006.
- B. H. Liddell Hart IN KEANE, Michael; “Dictionary Of Modern Strategy And Tactics”; Naval Institute Press, 2005.
- Bartholomees, J. Boone, Jr.; ‘A Survey Of Strategic Thought’; “U.S. Army War College Guide To National Security Policy And Strategy”; Diane Publishing, 2004.

³¹ “National Security Strategy”, White House, January 1988, US Government Printing Office, Washington DC; FedDocs PR 40.2 : SE 2/988.

BUZAN, Barry; "People, States & Fear: An Agenda For International Security Studies In The Post-Cold War Era"; Ecpr Press Classics, 2008.

Çabej E., Cipo K., Domi M., Krajni A., Myderrizi O.; "Fjalor I Gjuhës Shqipe"; Njihet Gjerësisht Si: Fjalori I Vitit 1954, Viti I Botimit Të Parë; Ribotuar, "Shtëpia Botuese Çabej", Tiranë, 2005.

FRASHËRI, Kristo; Shkrimi U Publikua Në 3 Maj 2014 Në Gazetën Shqiptarja.Com (Print) – [Http://Www.Shqiptarja.Com/News.php?Idnotizia=212847&Idcategoria=1#Sthash.Zugnuvxi.Dpuf](http://www.shqiptarja.com/news.php?idnotizia=212847&idcategoria=1#Sthash.Zugnuvxi.Dpuf)

JOINT PUBLICATION 1-02, "Department Of Defense Dictionary Of Military And Associated Terms"; Diane Publishing, Dod Usa, April 2001.

MORGENTHAU, Hans J.; "Politika Ndërmjet Kombeve, Lufta Për Pushtet Dhe Paqe" (Shqipëroi: Tonin Beci; Origjinali: Politics Among Nations, The Struggle For Power And Peace); Shtëpia Botuese: Tirana Times; Tiranë 2008.

U.S. Army War College, Guide To National Security Issues, Volume I: Theory Of War And Strategy, 3rd Edition, Department Of National Security And Strategy, June 2008, Usa.

United Nations, Economic Commission For Europe, Committee On Environmental Policy; "Environmental Performance Reviews, Volume 24 Di Environmental Performance Reviews Series; United Nations Publications, 2007.

Winniffrith, Tom; Perspectives On Albania; Macmillan Academic And Professional, 1992.

GJEOGRAFIA SI FAKTOR I RËNDËSISHËM I SIGURISË ENERGJITIKE TË RAJONIT

Kriza e Ukrainës dhe frika e ndërprerjes së gazit nga Rusia për konsumatorët evropianë ka nxitur një debat të ri rreth politikës së jashtme dhe sigurisë së BE-së, jo vetëm brenda vendeve antare, por dhe në periferinë e saj. Në një situatë të tillë krize, në varësi nga gatishmëria e BE-së për zgjerim, dhe mesazheve të dërguara nga Brukseli për proceset integruese, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të gjenerojnë bashkëpunim ose “xhepa pasigurie”. Kancelarja gjermane Angela Merkel ka meritën për një shtytje të re në procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE, nëpërmjet thirrjes së Samitit BE-Ballkani Perëndimor. Kjo shihet në çështjet e vëna në fokus dhe në kohën e thirrjes së tij, ndërsa diskutimet mes BE-së, Ukrainës dhe Rusisë rreth furnizimit me gaz janë në një pikë kritike për dimrin që po afron. Motoja e procesit të lançuar nga Merkel ishte: “ndryshim përmes kontakteve” në fushën ekonomike, turizmit, infrastrukturës dhe energjisë. Ky punim, nëpërmjet analizave gjeopolitike, trajton pikërisht rëndësinë e krijimit të kontakteve në rajonin tonë veçanërisht në fushën e sigurisë energjetike në linjë me Strategjinë e Sigurisë Energjetike Evropiane. Gjithashtu, në mënyrë të posaçme trajtohet siguria energjetike në vendin tonë, çështje që në dokumentin e ri të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, konsiderohet si kërcënim i nivelit të parë.

HYRJE

Thomas Friedman në librin e tij *Bota është e sheshtë* shpjegon se si globalizimi në shekullin e XXI na ka mundësuar të jetojmë në një botë të ndërlidhur dhe organike. Teoria e Friedmanit shpjegon se ajo që ndodh në Teksas rreth eksportit të gazit të argjilit (shale gas) nga SHBA jugore drejt Evropës mund të afektojë fatin e gjithë vendeve ish anëtare të Paktit të Varshavës më tepër sesa idetë dhe politikat që harton Berlioni apo Brukseli.²

Në kuadrin e takimit të Unionit të Doganave, i cili u mbajt në Minsk, me përfaqësues nga Rusia, Ukraina, Bjellorusia, Kazakistani dhe BE, më 26 Gusht 2014, u zhvillua takimi mes Presidentit Rus Putin dhe atij Ukrainas Poroshenko. Megjithatë, shtrëngimi i duarve

¹ Autori është kandidat për doktoraturë në fushën e sigurisë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Tiranë. Disertacioni i tij lidhet pikërisht me kërkimet në fushën e sigurisë energjetike dhe ndikimin që kjo e fundit paraqet për vendin tonë.

² Friedman, Th. (2008), ‘The world is flat’.

mes dy presidentëve, kontrastoi me publikimin nga NATO të fotove, ku paraqitej depërtimi i trupave ruse në territorin ukrainas.³ Rezultati i takimit ishte “mundësia e hartimit të një plani armëpushimi” nga ana e Ukrainës dhe nisja e dialogut për energjinë dhe gazin. Gjatë konferencës së shtypit, ndër të tjera Putin u fokusua edhe tek çështjet e energjisë: “[...] duhet t'i kthehemi dialogut për energjinë, duke përfshirë dhe problemet e gazit [...] duke folur sinqerisht, kjo është një çështje e vështirë. Ka arritur në një fund pa krye, por ne sërish duhet të flasim rreth saj”.⁴

Në fakt nuk kaloi më shumë se 24 orë dhe kryeministri Ukrainas Arseny Yatsenyuk pretendoi se kishte informacione rreth planeve ruse për ndërprerjen e furnizimit me gaz të BE-së në dimër, gjë që Ministri Rus i Energjisë Alexander Novak e mohoi menjëherë.

Në këtë kuadër kompleks, ngrihen një numër pyetjesh të cilat janë bërë objekt analize në këtë artikull: Çfarë ndodh nëse Moska ndërpret furnizimet me gaz për BE-në dhe Ballkanin Perëndimor? Cila është rëndësia që merr Konferenca BE-Ballkani Perëndimor në dritën e krizës së Ukrainës? Cilat janë efektet mbi vendin tonë?

SIGURIA ENERGJETIKE EVROPIANE - FAKTE DHE SHIFRA

Në realitetin evropian ku gjeografikisht burimet e energjisë janë të përqendruara vetëm në Detin e Veriut dhe në Norvegji, me Rusinë si furnizuesja kryesore e Evropës, vendet anëtare të BE-së, të varura nga burimet e huaja dhe çmimet e tyre që shpesh nuk reflektojnë ato të tregut, janë të prirura të influencohen nga “frika e konsumatorit”. Historikisht Rusia ka qenë furnizuese e rregullt e Evropës, që pas Luftës së II-të Botërore, gjë që e ka ndihmuar të sigurojë të ardhura të rregullta për ekonominë e saj. Nëpërmjet Rsisë, Evropa ka pasur gjithmonë një furnizues të rregullt, megjithëse jo shumë të domosdoshëm pas zbulimit të rezervave të mëdha të gazit dhe naftës në Detin e Veriut dhe Hollandë. Por, ndonëse për furnizimin me naftë Evropa ka alternativa, siç është Lindja e Mesme dhe Deti i Veriut, ajo që përbën thembrën e Akilit për të, është gazi natyror, i cili, në totalin e energjisë primare botërore, krahasuar më qymyrin dhe naftën, po zë një vend gjithnjë e më të madh.⁵

Dy vitet e fundit (2011-2012) konsumi i gazit ka pasur një ulje me 10% në 2011 duke i shtuar dhe një ulje prej 2.2 % në 2012.⁶ Ky fakt lidhet si me krizën financiare të BE-së, ashtu dhe me reduktimin e rezervave të Veriut, por një faktor i rëndësishëm është dhe rritja e

³ BBC, “Ukraine Crisis: NATO images show Russian’ troops”, 28 gusht 2014;

<http://www.bbc.com/news/world-europe-28972878>

⁴ Radio Free Europe, 26 gusht 2014; <http://ew.rferl.org/content/ukraine-russia-minsk-talks-start/26551135.html>

⁵ IEA, The Golden Age of Gas 2012

⁶ Eurogas, Statistical Report 2013; www.eurogas.org

konsiderueshme e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, me një rritje prej 5.5% në 2012.⁷ Gjithashtu një rol të rëndësishëm ka luajtur importi i qymyrit me kosto të ulët nga SHBA, si rrjedhojë e bumit të gazit të argjilit. Fatkeqësisht, kostoja ekonomike e energjisë së lirë nga qymyri është një faktor që BE-ja nuk mund ta injorojë me gjithë “politikat e gjelbra” për reduktimin e CO₂, siç është “Politika 20-20-20”.

Vendet e BE-së (28 anëtarë) një pjesë të furnizimit me gaz e sigurojnë nga burimet vendase, në masën 34%, ndërsa në 2012, kjo shifër u ul me 5.5% (afërisht 163 miliardë mmk gaz); 23 % e sigurojnë përmes furnizimit me tubacione nga Rusia dhe 21% me tubacione nga Norvegjia. Algjeria furnizon afërisht 9% të importit të BE-së përmes tubacioneve dhe LNG (gazit të lëngshëm të naftës), ndërsa pjesa prej 13% sigurohet nga 13 vende të tjera duke përfshirë Katarin si furnizuesi i vetëm më i madh përmes transportit të LNG.⁸

Në krahasim me shitjen e LNG që kryhet në tregun e lirë bazuar në çmimin e referencës së ditës ose (spot market) shitja e gazit të tubacioneve është bërë përmes kontratave afatgjata 20 deri 25 vjeçare. Në kontratat afatgjata Rusia ndjek tri parime kryesore:

- formula e çmimit bazohet në indeksin e çmimit të naftës së para 6 ose 9 muajve më parë;
- ndalohet ndërprerja e kontratës në mënyrë të një anëshme përveç shkaqeve madhore të forcave të natyrës;
- “përdor ose humb”, ku konsumatori duhet ta përdorë sasinë e gazit të prokuruar më parë.

Duke qenë se maturimi i rezervave të gazit në fushat ekzistuese në Evropë (vetëm në 2012, 163 miliardë metra kub gaz më pak), është në rritje vit pas viti, kjo ka krijuar premisën dhe orientimin drejt burimeve të Rusisë e ndikuar kjo edhe nga lufta e fuqishme e kësaj të fundit, për të rritur varësinë evropiane ndaj furnizimeve të saj me energji. Për ta arritur këtë rezultat Rusia ka përdorur si *karotën edhe shkopin*, përmes uljes së çmimeve të gazit për disa vende dhe rritjen e tyre për vende të tjera. Në tabelën e mëposhtme duken qartë luhajtjet e çmimeve të gazit për vendet perëndimore dhe vendet e Lindjes për të njëjtën sasi gazi të shitur.

⁷ Eurogas, Statistical Report 213; www.eurogas.org

⁸ Eurogas, po aty.

Rajoni/vendi	Çmimi (USD/1,000 m ³ gas)	Rajoni/vendi	Çmimi (USD/1,000 m ³ gas)
Evropa Perëndimore dhe Turqia		Evropa Lindore	
Britania e Madhe	313.4	Hungari	390.8
Holandë	371.4	Sllovaki	429.0
Gjermani	379.3	Rumani	431.8
Finlandë	384.8	Serbi	457.3
Francë	393.7	Slloveni	485.6
Austri	397.4	Bullgari	501.0
Turqi	406.7	Çeki	503.1
Itali	440.0	Bosnjë	515.2
Zvicër	442.2	Poloni	525.5
Greqi	476.7	Magedoni	564.3
Danimarkë	495.0		

Tabela 1: Çmimi mesatar i gazit shitur nga Gazprom në vendet Evropiane në gjysmën e parë të 2012 (USD për një mijë metra kub).

Nga tabela shihet se megjithëse vende si Gjermania, Anglia, Hollanda, Franca janë më larg në distancë dhe kostot e transportit dhe tarifës së tubacionit janë më të larta, çmimet për to janë më të lira. Këto diferenca çmimesh nxjerrin në pah efektet e faktorëve politikë. Në këtë kontekst, është me vend analizimi i varësisë energjetike të Evropës Perëndimore në krahasim me vendet e Evropës Lindore. Tabela më poshtë paraqet nivelin e varësisë së vendeve nga gazi rus, ku Gjermania e ka 37.1%, Franca 16.5% ndërsa vende si Polonia dhe Bullgaria 100%.

Rajoni/vendi	Varësia nga Importi Rus (%)	Rajoni/vendi	Varësia nga Importi Rus (%)
Evropa Perëndimore dhe Turqia		Evropa Lindore	
Gjermani	37.1	Hungari	86.6
Francë	16.5	Sllovaki	100
Austri	77.5	Rumani	100
Turqi	45.4	Bullgari	100
Itali	18.8	Ceki	73.1
Greqi	52.8	Poloni	89.5


Tabela 2: Përqindja e gazit Rus në totalin e importit në disa prej vendeve të BE (2010).

Burimi: Eurostat/Gazprom/Stratfor.

Nga krahasimi i tabelave bie në sy fakti që sa më e lartë varësia ndaj gazit rus aq më i lartë është çmimi që paguhet. Rrjedhimisht, siguria energjetike nuk është vetëm mungesa fizike e saj por çmimi i energjisë përbën një nga kërcënimet kryesore për vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore në marrëdhënie me Rusinë si pasojë e varësisë totale ndaj burimeve të saj.

ETJA PËR GAZIN RUS: ROLI I UKRAINËS

Në total BE importon 53% të energjisë që konsumon, gjë e cila përlogaritet në € 1 miliardë/ditë.⁹ Vetëm për 2013, BE-ja pagoi afërsisht €400 miliardë për energjinë e vet, nga të cilat, € 300 miliardë vetëm për naftën dhe produktet e saj. 1/3 e kësaj shume (39% e gazit natyror dhe 31% e naftës) u importua vetëm nga Rusia.¹⁰ Grafiku i mëposhtëm paraqet më qartë nivelin e varësisë së BE ndaj Rusisë dhe korridoret kryesore të furnizimit ku Ukraina ka rolin kryesor.



Harta 1: Nevojat e BE për gazin Rus.

Burimi: Inez Torre/CNN

Si përgjigje ndaj krizës në Ukrainë dhe varësisë energjetike në rritje të vendeve anëtare, Komisioni Evropian hartoi një Strategji të Sigurisë Energjetike Evropiane (SSEE) (shpallur më 28 Maj 2014).¹¹ SSEE përcaktoi objektivat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ku fokusi kryesor ishin masat kundrejt një ndërprerje të mundshme ku përmendim. Midis masave në fjalë mund të përmendim: i) rritja e stoqeve të gazit; ii) zhvillimi i infrastrukturës energjetike për furnizimin dykahësh; iii) ulja e kërkesës afat-shkurtër; iv) dhe kalimi në energji alternative.

Komisioneri i Energjisë Gunther Oettinger deklaroi gjatë konferencës për shtyp, ku u prezantua SSE, se "[...] *duhet të shmangemi të biem viktimë të shantazhit politik dhe tregtar*".¹² Por përtej deklaratave politike, Oettinger është i vetëdijshëm se dimri që po afron ia kushtëzon së tepërmi hapësirën për negociata me Rusinë

⁹ EC, DG Energy; aksesuar më 26 Gusht 2014; http://ec.europa.eu/energy/security_of_supply_en.htm

¹⁰ COM (2014) 330 Communication from the Commission to the European Parliament and Council: *European Energy Security Strategy*, Brussel, 28 May 2014.

¹¹ COM (2014) 330, po aty.

¹² European Commission, "Energy Security: Commission puts forward comprehensive strategy to strengthen security of supply", Press Release, Brussel 28 May 2014; http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-606_en.htm

dhe Ukrainën rreth sigurisë energjetike të BE-së. Megjithatë Oettinger deklaroi se ka një plan B në rast të krizës së mundshme, siç janë stoqet e gazit në Gjermani, Letoni dhe disa vende të tjera, të grumbulluara gjatë verës, që mund të sigurojnë përballimin e dimrit në rast ndërprerje. Por këto stoqe janë vetëm për BE, kryesisht për vendet e Evropës Perëndimore dhe nuk përballojnë furnizimin e Ukrainës e cila në mungesë të gazit ka shumë të ngjarë të ndërpresë sasinë e destinuar për në BE, duke bërë që pasojat t'i vuajnë anëtarët e Evropës Lindore dhe Qendrore. Figura më poshtë dëshmon qartë rëndësinë e Ukrainës për sa i përket “politikës së tubacioneve”.



Harta 2: Burimi: Unioni Ukrainas i Gazit

Sikurse edhe në krizat e mëparshme të gazit, Ukraina përballet me problemin e borxheve të prapambetura. Aktualisht ajo ka një faturë prej \$ 5.3 miliardë të papaguar dhe Gazprom i ka ndërprerë furnizimin që në Qershor 2014, duke lejuar vetëm gazin e destinuar për BE që kalon nëpër Ukrainë. Ukraina, nga ana e vet, akuzon Gazprom për çmime të larta të gazit dhe çështja ka kaluar në Gjykatën e Arbitrazhit Tregtar në Stokholm, ku gjykimi kërkon të paktën 15 muaj shqyrtim. Ukraina dhe BE-ja nuk e kanë këtë kohë pasi dimri po afron, dhe frika që Ukraina të shfrytëzojë gazin e destinuar për BE ka nxitur lëvizjet e kësaj të fundit përmes takimit të Minskut, dhe së fundmi takimit të Moskës për gjetjen e një zgjidhje të përkohshme, derisa Gjykata e Stokholmit të dalë më një vendim për caktimin e çmimit.¹³

¹³ EU, “Outcome of gas talks between Vice-President Oettinger and Russian Energy Minister Novak”, Statement, Brussel 29 August 2014; http://europa.eu/rapid/press-release_STATEMENT-14-262_en.htm

Takimi i mbajtur në 29 Gusht në Moskë, mes Komisionerit Oettinger dhe Ministrit Rus të Energjisë Novak, për gjetjen e një zgjidhje, duket se nuk ia arriti qëllimit. Ndër të tjera, në të u diskutua:

- Ukraina duhet të paguajë borxhin e plotë prej \$ 5.3 miliardë;
- Ukraina duhet të fillojë të paguajë një pjesë të borxhit dhe për sasinë e gazit në vazhdim përmes një formule të përkohshme çmimi të rënë dakord derisa Stokholmi vendos për çështjen;
- Përdorimi i tubacionit OPAL që lidh tubacionin Nordstream-it me Gjermaninë si alternativë në rast ndërprerjesh të mundshme.

Përtej negociatave dhe leximit të deklaratave publike është thelbësore ideja e pashprehur, ajo që fshihet përtej konferencave të shtypit. Në takimin e Minsk-ut, Putin do të shprehej: *“edhe sikur të donim të arrinim një marrëveshje apo të binim dakord të ulnim çmimin me 100 \$ tashmë çështja është në Gjykatë të Arbitrazhit”*.¹⁴ Mesazhi i përcjellë nga Putin është i qartë, në këtë mënyrë BE dhe Ukraina vihen përpara dy alternativave të vështira: ose Ukraina t'i kërkojë BE-së të paguajë borxhin e saj dhe kjo e fundit ta marrë përsipër këtë, gjë e cila duket opsioni më i pamundur ose Ukraina të heqë dorë nga Marrëveshja me BE-në dhe të bëhet pjesë e Unionit të Doganave së bashku me Rusinë, Biellorusinë, Kazakistanin me qëllim krijimin e Unionit Euroaziatik. Poroshenko deklaroi në Minsk se marrëveshja me BE është e pakthyeshme, gjë e cila e ktheu Takimin e Minsk-ut në një ngërç.

Në dritën e këtyre zhvillimeve, duket më pranë mundësia e një ndërprerje të furnizimit me gaz nga Rusia (më shumë për Ukrainën dhe ndoshta në formën e kufizimeve për BE-në), pavarësisht se askush në BE dhe në periferinë e saj nuk ka dëshirën të merret me të, në mënyrë direkte. Mbetet të shihet nëse dhe kur kjo do të ndodhë. Gjithsesi, që nga kriza e fundit e gazit në 2009, shumë gjëra kanë ndryshuar dhe BE-ja ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm si: krijimi i stoqeve të detyrueshme të gazit për të paktën 60 ditë, ndërtimi i tubacionit Nord Stream që anashkalon Ukrainën dhe ndërtimi i linjave të furnizimit dykahësh ku vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të mund të furnizohen nga vende si Austria, Gjermania. Aktualisht Ukraina furnizohet nga Sllovakia përmes gazit që vjen nga Gjermania, megjithëse në sasi të kufizuara dhe çmime disa herë më të larta. Ky është plani B i Oettinger dhe asi i vetëm në negociatat me Rusinë.

¹⁴ Vladimir Putin, “Answers to journalists’s question following working visit to Belarus”, President of Russia Portal. 27 August 2014; <http://eng.kremlin.ru/transcripts/22852>

KONFERENCA BE-BALLKANI PERËNDIMOR: SIGURIA ENERGETIKE SI VLERA MË E MADHE E RAJONIT!

Konflikti në Ukrainë përpos krizës së gazit minon dhe një çështje të rëndësishme të BE-së, - *Politikën Evropiane të Fqinjësisë* (European Neighbourhood Policy). PFE, e krijuar në 2004, është konsideruar si alternativa e gjeopolitikës tradicionale duke përfshirë 16 vendet e Afrikës Veriore, Lindjes së Mesme dhe Evropës Lindore.¹⁵ 10 vjet më vonë PFE-ja është në prag dështimi. Në Lindje, PFE-ja ka krijuar konkurrencë me Rusinë, por në disavantazhin e BE-së, përderisa krahina të ndryshme, të orkestruara nga Rusia, po kërkojnë pavarësi apo autonomi shumë më të gjerë. Në Jug gjithashtu, ndryshimet dramatike politike dhe ngritja e aktorëve të rinj si ISIL/ISIS kërcënojnë fuqimisht angazhimin e pakët të BE-së në këto shtete dhe objektivin e saj për një rajon të sigurt në kufijtë e saj.

Në këtë kontekst të gjerë, është e qartë që BE nuk dëshiron në Ballkanin Perëndimor “xhepa pasigurie”.¹⁶ Prandaj, Konferenca BE-Ballkani Perëndimor në Berlin me pjesëmarrjen e shteteve të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Bosnjës, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Kancelares Gjermane Merkel, Kancelarit Austriak, Presidentit të Komisionit Evropian Barroso dhe Komisionerit të Energjisë Oettinger merr rëndësi të veçantë edhe nga ky aspekt.¹⁷ Motoja kryesore e konferencës ishte “ndryshim përmes kontakteve” në tre kolona kryesore e shprehur dhe në deklaratën përmbyllëse: forcimi i qeverisjes së mirë (lufta kundër korrupsionit, sundimi i ligjit), bashkëpunimi rajonal dhe rritja e prosperitetit përmes rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm.¹⁸

Jude Dempsey nga *Carnegie Europe* duke lavdëruar Kancelaren Merkel për thirrjen e konferencës BE-Ballkani Perëndimor shprehet se:

*“[...] nëse do të braktisej agjenda e reformave, niveli i lartë i papunësisë në rajon (mesatarisht 25 përqind) korrupsioni endemik, qeverisja e dobët do të bënin që të forcoheshin pozitat e populistëve dhe nacionalistëve. Destabiliteti do të pasonte. Kjo nuk është ajo çka BE-ja ka nevojë në oborrin e saj, duke marrë në konsideratë se çfarë po ndodh në qoshet lindore dhe jugore të BE-së”.*¹⁹

¹⁵ EUEA, “European Neighbourhood Policy 2004”.

¹⁶ J. Bugajski, “Return of the Balkans: Challenges to European Integration and US Disengagement”, Strategic Studies Institute, May 2013, fq.25.

¹⁷ German Federal Foreign Office, “Western Balkan Conference in Berlin: Commitment to the European Perspective”, 28 August 2014; http://www.auswaertiges-amt.de/EN/Europa/westlicherBalkan/AktuelleArtikel/140828_Westbalkankonferenz.html

¹⁸ The German Federal Government, “Final Declaration by the Chair of the Conference on the Eastern Balkans”, Press Release No.288/2014, 28 August 2014.

¹⁹ Jude Dempsey, “Don’t forget Western Balkan”, CarnegieEurope, 28 August 2014; <http://carnegieeurope.eu/strategieurope/>

Në fakt, destabiliteti, të cilit i referohet Dempsey, ka të bëjë më frikën e zhvendosjes së aksit të konfliktit nga Ukraina drejt Ballkanit, ku ekzistojnë çështje të diskutueshme bilaterale dhe territoriale. Por për të kuptuar konferencën e Berlinit është e rëndësishme të kuptohet Samiti i Minskut i mbajtur në 26 Gusht mes Rusisë dhe Ukrainës.

Në Minsk palët shpalosën pretendimet e tyre për çështje si: i) embargo e ushqimeve; ii) strategjia zgjeruese e Rusisë; iii) dhe sovraniteti i Ukrainës.²⁰ Qëndrimet e kundërta, ashtu si pritej, mes Putin dhe Poroshenko nuk sollën ndonjë rezultat. Takimi i Minskut pati dhe fitues, veçse fituesi nuk ndodhej në takim. Qëndrimi asnjans dhe i qetë i Turqisë gjatë krizës së Ukrainës u shfaq nga Ahmet Davutoglu, kryeministri i ardhshëm i Turqisë, i cili do të shprehej një ditë pas takimit të Minskut për rëndësinë e takimit dhe oportunitetet që i paraqiteshin Turqisë për furnizimin me energji të BE pas mosmarrëveshjeve të mëdha mes Ukrainës dhe Rusisë.²¹

Konflikti mes Rusisë dhe Ukrainës dhe planet për ndërtimin e Unionit Euroaziatik janë të papranueshme për BE-në, rrjedhimisht Rusia do të kërkojë anashkalimin e Ukrainës si vend transit i energjisë. Turqia përbën aksin kryesor Jug - Lindje të korridorit të energjisë dhe Turqia do të mbajë kartën kryesore si me Perëndimin ashtu dhe Lindjen. Korridori Jugor i Gazit që kalon përmes hapësirës anadolliane do të jetë nyja kryesore për transitin e energjisë nga Kaukazi drejt Evropës dhe mënyra e vetme e diversifikimit të energjisë për BE.

Në këtë kontekst merr rëndësi Ballkani Perëndimor dhe pozicioni i tij gjeo-strategjik do të shërbejë për tranzitin e energjisë dhe tubacioneve që zgjaten nga Kaukazi e Kaspiku përmes Turqisë drejt BE-së. Kjo u nënkuptua dhe në deklaratën përmbyllëse të samitit BE-Ballkani Perëndimor ku u konkludua se:

*“shtetet pjesëmarrëse bien dakord që politika energjetike Evropiane është e rëndësishme së lartë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Bashkëpunimi rajonal brenda kuadrit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore është një komponent i rëndësishëm, veçanërisht për sa i përket sigurisë energjetike, efikasitetit energjetike dhe mbrojtjes së klimës. Vendet e Ballkanit Perëndimor do të vazhdojnë të punojnë intensivisht në avancimin e mëtejshëm të Komunitetit të Energjisë dhe në tejkalimin e pengesave në zbatim”.*²²

²⁰ Euroactiv, “Putin shakes hand with Poroshenko but no solution found”, 26 August 2014.

²¹ Dr.Cemil Etem, “Russia, EU and Davutoglu’s term in Turkey”, Turkey Agenda, 28 August 2014; <http://www.turkeyagenda.com/russia-eu-and-davutoglus-term-in-turkey-1086.html>

²² The German Federal Government, “Final Declaration by the Chair of the Conference on the Western Balkans”, Press Release No.288/2014, 28 August 2014, fq.3.

Por, pavarësisht pranimi – apo kandidimi për pranim në BE, Ballkani Perëndimor është i përçarë përsa i përket energjisë dhe punon kundra vlerave e rregullave të BE-së. Mosfunksionimi ligjor, proteksionizmi dhe korrupsioni i madh i mbartur nga komunizmi janë të gjitha në kontrast me standardet e BE-së. Ky problem shtohet më tepër, kur marrim në konsideratë rolin e Ruisë në rajon që ka zotëruar një sërë asetesh dhe privatizimesh që lidhen me infrastrukturën energjetike në rajon. Treguesi më i drejtpërdrejt është projekti Southstream. Në hartën më poshtë mund të shihet sesi Gazprom ka blerë shumicën e aksioneve të kompanive që ka krijuar për ndërtimin e tubacionit.



Harta 3: Projekti Southstream dhe përqindja e aksioneve të shpërndara sipas vendeve përkatëse.

Burimi: Gazprom

E shkuara komuniste e Ballkanit Perëndimor ka gjeneruar dy probleme të mëdha: së pari, mosfunksionimi ligjor, që është pengesa më e madhe në lejimin e investitorëve strategjike (sidomos në projekte strategjike energjetike dhe infrastrukturore); së dyti, proteksionimi në sektorin energjetik është kundër hapjes së tregut dhe kundër normave të funksionimit të sistemit energjetik të BE-së. Këta dy faktorë minojnë në tërësi përpjekjen e BE-së për diversifikim të rrugëve të furnizimit dhe krijimin e infrastrukturës së re lidhëse apo terminale të reja të energjisë dhe asaj të rinovueshme.

Rënia e Murit të Berlin-it në '89 ishte hapja e një ere të re ndryshimesh në Evropën Lindore dhe Qendrore ku vendet aspiruan për demokraci dhe u anëtarësuan në NATO dhe BE. Ndërsa në Ballkanin Perëndimor, vala që pasoi ishte ajo e fuqizimit të kleptokracisë, ardhja në pushtet e ish-liderëve komunistë që vijoi me pranimin formalisht në letër të parimeve dhe ligjeve të BE-së, por në praktikë asgjë nuk ndryshon në – biznesin e përditshëm.

Ballkani Perëndimor mund të shërbejë si një alternativë e fuqishme për diversifikimin e furnizimit me energji të BE-së duke marrë në konsideratë:

- krijimin e një terminali LNG Krk në Kroaci i cili do të mundësonte futjen në treg të një sasie prej 5 miliardë metra kub gaz në vit (mmkv/v) me mundësi zhvillimi deri në 15 mmkv;
- ndërtimi i tubacionit ndërlidhës dykahësh Kroaci-Hungari që do të mundësonte transportin e një sasie prej 1.5-2.5 mmkv me mundësi zgjerimi deri në 6.5 mmkv;²³
- zbulimi i rezervave të reja në tokë dhe det;
- hapja e korridorit energjetik TAP i cili do të transportojë 10 mmkv përmes Greqisë-Shqipërisë-Italisë me potencial rritje në ardhmen, në 20 mmkv, nga burimet që mund të vijnë nga Azerbajxhani dhe Iraku;²⁴
- ndërtimi i tubacionit IAP që mund të sigurojë 5 miliardë metra kub etj.

Por situata në fakt është përkeqësuar nga dy faktorë të rëndësishëm. Së pari, interesat ruse shfrytëzojnë sistemin e korruptuar dhe ligjin e dobët, e cila e gërshetuar me interesat tregtare të tyre kërkojnë ta mbajnë rajonin të varur në furnizimin me burimet ruse. Së dyti, sistemi i korruptuar dhe mungesa e ligjit promovojnë proteksionizmin në sistemin energjetik dhe nuk lejojnë hapjen e tregut energjetik ndaj BE-së, ku firmat dhe bizneset mund të investojnë për lidhjen e rrjetit me atë të BE-së.

Megjithëse vendet e rajonit janë anëtarë të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë Ukrainën dhe Moldavinë, ato nuk zbatojnë detyrimet që rrjedhin prej legjislacionit të traktatit. Rast flagrant është ai i Serbisë ku megjithëse paketa e tretë energjetike përcakton qartë sistemin e “unbundling” (mos mbivendosjes) për infrastrukturën energjetike dhe tubacionet, nuk merren masa për ndalimin e ndërtimit të Southstream. Për më tepër marrëveshja e Serbisë me Gazprom në 2008, ku i kaloi 51% të asetëve të kompanise shtetërore Serbiagas, është i vetmi rast në rajon, në dallim me çdo shtet tjetër të përfshirë në Southstream.

Pyetja është si ka mundësi që një vend kandidat për anëtarësim në BE nuk respekton legjislacionin e BE-së, duke rritur në këtë mënyrë varësinë energjetike të vendit të vet si dhe të bllokut ku kërkon të bëjë pjesë?

Ndërsa Kroacia akoma nuk ka filluar ndërtimin e terminalit të LNG në Krk i cili do të mundësonte transportin e 5 miliardë metra kub gaz në vit. Kroacia konsumon vetëm 3 mmkv kështu pjesa tjetër do të

²³ OSW. A Croatian-Hungarian Gas Interconnector has been put into operation, Center for Eastern Studies, (2011) Warsaw.

²⁴ Ribaj, P., dhe Qendro, E. (2011), fq.86.

ishte e disponueshme për vendet e Evropës Qendrore përmes linjës Hungari-Kroaci nëse do funksiononte në të dy kahët. Kjo do ishte një rrugë e re furnizimi për BE dhe mund të furnizonte dhe Ukrainën së bashku me Sllovakinë, por vendet e ish-Jugosllavisë në Ballkanin Perëndimor kërkojnë të aplikojnë shkollën e vjetër diplomatikë të Titos “Vendosim perëndimin kundër Rusisë”, por në rastin konkret kjo nuk mund të funksionojë pasi kanë bërë zgjedhjen e tyre me Perëndimin.

Prania e Komisionerit të Energjisë Gunther Oettinger mes ministrave të ekonomisë së Ballkanit Perëndimor gjatë Samitit të BE-Ballkani Perëndimor, të 28 Gushtit, dëshmoi qartë se rruga e zhvillimit ekonomik të rajonit është integrimi energjetik i tij në Strategjinë Energjetike Evropiane. Një Ballkan i ndërlidhur energjetikisht është më i sigurt, më i zhvilluar dhe është më afër BE-së.

Paul Collier, Drejtor i Qendrës për Studimin e Ekonomisë Afrikane, në librin e tij *Planeti i plaçkitur*, del me formulën e famshme.²⁵

Burime – teknologji + rregulla (qeverisje të mirë) = Varfëri

Burime + teknologji – rregulla (qeverisje të mirë) = Plaçkitje

Burime + teknologji + rregulla (qeverisje të mirë) = Prosperitet

Gjatë pjesëmarrjes në inaugurimin e hapjes së *Programit për Qeverisjen e Burimeve*, në Universitetin e Calgary-it, Collier, pyetjes së zyrtarëve Ganez “A mund të bëhet Afrika si Kanadaja?” do t’i përgjigjej si më poshtë: “[...] *çështja nuk është a mundet Afrika të bëhet si Kanadaja, por a do Afrika të bëhet si Kanadaja*”.²⁶ “*Është në dorën e tij nëse Ballkani kërkon të integrohet në BE*”, do të shprehej Merkel në konferencën e shtypit me Presidentin Barroso dhe kryeministrin Rama.

ROLI I SHQIPËRISË NË ARKITEKTURËN ENERGJETIKE RAJONALE

Strategjia e Sigurisë Energjetike Evropiane (2014) parashikon 24 projekte infrastrukturore për gazin dhe 6 për elektricitetin kryesisht në Evropën Lindore.²⁷ Shqipëria ndodhet në një pozicion gjeo-strategjik, ku gërshetohen akset e korridoreve Lindje-Perëndim, Jug-Veri dhe një portë detare në ngushticën e Otrantos. Kalimi i Projektit të shumëpërfolur TAP dhe lidhja e tij me projektin Ionian Adriatik

²⁵ Collier, P. (2010). *The Plundered Planet: How to reconcile prosperity with nature*. Oxford: Oxford University Press, fq. 3-9.

²⁶ Konferenca Resource Governance, organizuar nga Universiteti i Calgary-it, Kanada, 15-17 Maj 2013.

²⁷ COM (2014), fq. 330.

Pipeline (IAP) e vendos vendin tonë në qendër të interesit për Unazën Ballkanike të Gazit (Balkan Gaz Ring).²⁸ Nëse shtojmë këtu dhe potencialin që paraqesin fushat e gazit të shfrytëzuar të Dumresë si depozita për stoqet e gazit në rast krizash atëherë piktura është e plotë se si vendi shndërrohet në një pjesë të rëndësishme e arkitekturës energjetike evropiane sidomos në kohë krizash.

Nga ana tjetër, kontratat e firmosura në fushën e hidrokarbureve me kompanitë e shumta shtrojnë një vlerësim potencial pozitiv. Nga të dhënat e paraqitura, Bankers Petroleum, Stream Oil and Gas dhe potencialet e Petromanas mund ta çojnë prodhimin e naftës në Shqipëri diku rreth 45-50,000 fuçi në ditë deri në 2015 (2.3-2.5 milionë tonë në vit).²⁹ Kjo shifër do të rezultonte në prodhimin më të madh që ka arritur ndonjëherë vendi ynë, edhe përtej kulmit të vet në 1974 (Shqipëria prodhonte për konsumin e vet dhe arrinte të eksportonte balancën prej 5-10.000 fuçi në ditë ose 255-510,000 ton/vit).

Shqipëria ka rezerva të konsiderueshme hidrokarbure në Ballkan, shumë më të mëdha se vendet e tjera, përveç Rumanisë e cila megjithëse prodhon rreth 90,000 f/d rezervat e saj janë në tkurrje dhe rënie, ndërsa Turqia prodhon rreth 45,000 f/d por me nivelin e konsumit të saj është një sasi e papërfillshme.

Në këtë kontekst, të bëhesh një vend eksportues i hidrokarbureve në Ballkan, sadopak qoftë kjo sasi, është një mjet shumë i rëndësishëm dhe do t'i japë Shqipërisë një levë politike si aktor i rëndësishëm në rajon.

Gjatë 2012-2013, prodhimi i naftës mund të ketë shtuar rreth \$ 400-500 milionë në ekonominë shqiptare, duke përfaqësuar rreth 4% të GDP së vendit.³⁰ Nëse çmimi i naftës Brent (Bursa me të cilën vlerësohet nafta Shqiptare) do të ketë vlerë prej \$100-115 për fuçi për vitet në vijim, rritja e prodhimit të naftës në Shqipëri do të kontribuonte rreth \$ 1 miliardë ose rreth 7-8 % të GDP së vendit deri në vitet 2015-2016. Nëse do të marrim në konsideratë efektin spiral të ekonomisë së naftës duke përfshirë aktivitetet në industrinë e rafinerive dhe atyre të lidhura me shërbimet e tjera që janë në funksion të ekonomisë së naftës dhe hidrokarbureve siç mund të jetë ndërtimi i tubacioneve të reja, terminaleve të eksportit në Vlorë dhe Porto Romano, kontributi kumulativ në GDP do të ishte shumë herë më i madh.

²⁸ Pajtim Ribaj, Elton Qëndro, "Gjeopolitika Energjetike dhe Siguria Kombëtare: Qasje ndaj Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëria", Qendra Hapësirë, Tiranë, 2011.

²⁹ Bankers Petroleum Annual Financial and Operational Results 2013; Stream Oil & Gas Annual Financial and Operational Results 2013; Trans Oil Group Annual Financial and Operational Results 2013; Petromanas Energy Inc Financial Statement 2013.

³⁰ AlbEITI Report 2010, 2011, 2012.

Rritja e prodhimit të naftës në Shqipëri do të ndikonte në pozicionimin e vendit, strukturën rajonale të fuqisë, zhvillimin ekonomik dhe mundësisht suksesin dhe dështimin e projekteve të tjera në rajon siç mund të jenë kërkimet në det apo tokë.³¹ Rritja e prodhimit të naftës në Shqipëri do të rriste eksportin drejt Italisë, ndërsa Greqia, mund të ishte e interesuar në importin e një sasive të konsiderueshme nafte nga Shqipëria tani që projekti Burgas-Aleksandropoulos është jashtë loje dhe për më tepër që Greqia ka ndërprerë importet nga Irani për pasojë të sanksioneve.

Në këtë panoramë, Shqipëria i ka të gjithë potencialet dhe shanset për tu shndërruar në një një të rëndësishme të arkitekturës energjetike rajonale dhe asaj evropiane.

PËRFUNDIME

Teknologjia dhe ndërvarësia nuk kanë mundur të zbehin rolin e gjeografisë. Sot, më shumë se kurrë, kontrolli i pastër i hapësirave të çmuara siç janë korridoret detare apo burimet energjetike e kthejnë gjeografinë në qendër të vëmendjes.³² Sa më e vogël bëhet bota për shkak të ndërvarësisë, globalizimit dhe teknologjisë, aq më i çmuar, aq më strategjik bëhet çdo vend dhe territor. Prandaj, njohja e gjeografisë na ndihmon për të kuptuar se kriza e Ukrainës është një krizë për hapësirë, është “Polonia e 1939”.

Samiti BE-Ballkani Perëndimor shënoi një shtysë të re në avancimin e “progresit prej kërmilli” të integritit të rajonit. Prezantimi i një procesi integrimi me plan afatmesëm 4-vjeçar i bazuar në rishikimin e përvitshëm është një ndër mesazhet më të rëndësishme të përcjella nga Brukseli dhe Berlina.

E thënë me fjalët e Kryeministrit shqiptar Rama, “integrimi në BE nuk është një proces ku BE vetëm jep dhe Ballkani merr, por ku Ballkani jep dhe ndan vlerat e tij”. Në këtë moment kyç të krizës mes Evropës dhe Rusisë, furnizimi me energji, korridoret detare dhe siguria energjetike janë nga faktorët kryesorë në rritjen e rëndësisë të rajonit

Ballkani Perëndimor dhe kryesisht Shqipëria ndodhet në qendër të këtyre zhvillimeve që kërkojnë mençuri dhe maturi për të kuptuar se alternativa e gjeopolitikës sot janë korridoret energjetike, burimet dhe siguria energjetike.

Si thotë Collier, është në dorën e Shqipërisë nëse do të bëhet!!

³¹ Greqia dhe Mal-i i Zi kanë shpallur një program të gjerë tenderimi në det për kërkim hidrokarburesh duke u bazuar në vijimin e gjeologjisë dhe morfologjisë së shelfit të tyre me lidhje të ngjashme me gjeologjinë e Patos Marinzës në Shqipëri.

³² Kaplan, R. (2012), fq.343.

BIBLIOGRAFIA

- Bugajski, J. (2013), *Return of the Balkans: Challenges to European Integration and US Disengagement*, Strategic Studies Institute.
- Collier, P. (2010), *The Plundered Planet: How to reconcile prosperity with nature*. Oxford: Oxford University Press.
- Friedman, Th. (2006), *The First Law Of Petropolitics*, New York Times.
- Friedman, Th. (2008), *The world is flat*, Published by Farrar, Straus & Giroux.
- Friedman, Th. (2009), *Flat, Hot And Crowded*, Published by Farrar, Straus & Girox.
- Kaplan, R. (2012), *The Revenge of Geography What the map tells us about coming conflicts and the battle against fate*, Random House, New York.
- Kici, V. (2013), *Nafta në Albanide: Ide të reja mbi Gjeologjinë e Shqipërisë*, Albin, Tiranë.
- Klare, M. (2005), *Blood and Oil: The dangers and consequences of America's growing petroleum dependency*, Penguin Adult.
- Laurent, E. (2007), *Ana e fshehtë e naftës*, Shtëpia botuese 55.
- Qendro, E., Ribaj, P. (2011), *Gjeopolitika Energjetike dhe Siguria Kombëtare: Qasje ndaj Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëria*, Qendra Hapësirë.

ABSTRACTS

Camilla CARINI

EULEX Kosovo: A Tool for European Enlargement

After almost ten years of UN administration, Kosovo unilaterally declared independence in 2008. However, it was clear that its institutions were not able to independently carry out some functions in the area of rule of law and that it was therefore necessary to strengthen them. The EU was thus ready to take over the UN, and EU Member States agreed in deploying EULEX, a civilian mission under the European Security and Defense Policy in order to strengthen that sector in Kosovo.

Since 2004, CSDP has been increasingly focusing on the promotion of rule of law. Whose aim consists of strengthening the reforms sustainability and continuation once the mission leaves the hosting country. Ginsberg and Penksa have developed the analytical framework of the 'analysis of impact' in order to evaluate various aspects of CSDP missions. This paper uses this analytical framework, focusing on external political impact, which consists in the effect of a CSDP mission on the domestic policies of the country where it is deployed, in terms of support among political leaders and population.

The goal of this paper is to demonstrate that EULEX considerably matters in terms of external political impact (i.e.: it considerably influences the policies of Kosovar institutions), that it is only a part of EU's comprehensive approach to Kosovo and that, despite the weak political will of Kosovar institutions in implementing reforms, political impact is strongly influenced by the enlargement perspective for the country.

Adel ABUSARA

Comparative Analysis of the Strategic Documents of the Western Balkans

One of the important tests of the achieved level of democratization for every country in transition is the state of affairs of its strategic-doctrinal framework. By analyzing the main strategic documents of a country, their hierarchy, the main stakeholders that participate in their creation, the (non-)existence of the flow of information between the authorities and the public before these documents are adopted, and most importantly – their content, one can find out much more than mere security and defense aspirations of its political elite.

The importance that is being given to the adoption of these documents according to the democratic standards and following the right hierarchy shows if the need for their existence is really understood, or it is just the concern of the political elites to have the “shell”, the empty “form” of a democratic country, without making a real effort to create comprehensive security and defense systems as well as security policy.

This kind of analysis for the Western Balkan countries is very difficult. The geopolitical status of the region is still a matter of concern: ten years after the last conflict in the region, not all the boundaries are clear, the status of Kosovo is still somewhat disputable, the future of Bosnia-Herzegovina is still gloomy and Macedonia is not much closer to the solution of its dispute with Greece.

The countries’ answer to the ultimate push from the international community (and especially the EU in this sense) for regional cooperation, their sincerity and willingness to cooperate, clearly show how far they have moved from the “remnants” of their recent gloomy past.

The article tries to detect and observe new trends in security sectors in the Western Balkans and their general level of democratization through comparative analysis of main strategic documents. That is being justified by the facts that the countries of the region have had similar experience of instabilities and crises in the last decade of 20th century, as well as a slow stabilization process at the beginning of the new century. On the other hand, they all have adopted their first strategic documents in the last 10 years or so.

Foto DURO

On Albania’s National Security Strategy

The Strategic documents in Albania, including those dealing with security, have often been qualified as “theoretical” and not very much as “working documents”, aiming to push forward the reforms. The paper focuses on the strategic security documents and argues that even the claimed “theoretical” attribution is only partially true. According to the author, these documents might have improved their content, playing a more distinct role over the security institutions performance, had they built more on the theoretical security studies conducted in the Euro-Atlantic space during the last two decades. In this area, Albania is lagging behind the region, since it has still in force a security strategy, adopted ten years ago, failing to benefit from the positive examples of other countries concerning security in general and security related documents. It has also failed to reflect

over the expertise, which the GM Centre, Germany, a distinguished international think tank, provided exclusively for Albania in 2006.

Given the fact that the security documents in Albania have been adopted without a real debate in the Parliament (letting alone the civil society) the paper pays a special attention to the new draft of the Security Strategy (still in the debating phase and not yet formalized). It brings evidence concerning some of its advantages as well as weaknesses, while offering recommendations for further improvement, especially related to “national interests” and “implementing measures”. In particular, the paper brings to the fore the weaknesses of the Albanian capacities in drafting and working with strategic security documents. It underscores the need of building, enhancing and preserving these capacities, despite the political changes, as well as considering and exploiting the precious capacities already possessed and offered by civil society in Albania.

Albert HITOALIAJ

A Name for the National Security Strategy 2014

A few weeks ago the National Assembly approved the law "On the approval of the National Security Strategy of the Republic of Albania", considered as the most strategic national document. It is composed of the following pillars: concept and goal of the National Security Strategy, national values, strategic interests, responsibilities and necessities, along with the operational responsibilities held by various involved actors. Obviously, there have been high expectations on the final version of this relevant document. Nevertheless, it did not manage to fuel an appropriate level of interest from the general public and has not stirred the expected enthusiasm or intense public debates over its content. It lacks a serious and critical spirit as well as the formula: ‘National Security Strategy means National Power’.

This document - that presents the national essential interests, future risks, developmental approach of the national power, etc. - is a key roadmap that stands above the strategies of defense, foreign policy, intelligence, etc. As such, it deserved a much more detailed handling. This handling should have been a continuation of the pre-election promised seriousness (a promise held correctly), on the immediate elaboration of the National Security Strategy of the Republic of Albania (NSSRA). In author's point of view, the shortcomings reflected in NSSRA are the outcome of the combination of a series of elements, which are distributed both in time and in different societal layers, either politicians or not. The basis of this article will be the analysis of the first security strategy and its relation with the concept of national power.

Elton QËNDRO

Geography as an Important Factor for Regional Energy Security

The Ukraine crisis and the fear of gas supply interruption from Russia against European customers have triggered a new debate about the EU foreign and security policies, both domestically and in relation to other states of its periphery. In this new security context, in accordance with EU willingness to enlargement and the messages that it sends to the Western Balkan (WB) countries in favor of their EU integration agenda, this region might generate more security and cooperation or, rather, turn back again to the “insecurity pockets”.

The new impetus that the Summit of EU-Western Balkans (of 28 Aug 2014) took over the EU integration process of the Western Balkans shows once more the relevance of this region to the EU. On the other hand, the place that the energy security took in the agenda of this event, shows the importance of this security component (which considering the above-mentioned circumstances are taking prominence) and the role that the Western Balkans could play in this context.

Through a geo-political analysis, the article deals exclusively with the importance of the cooperation in the area of energy security, inside the WB region and between this region and EU, in conditions of an “ever interconnected and interrelated” world. It raises questions and tries to give answers on some very sharp issues, such as: “the consequences of an interruption of gas supply from Russia”; “Ukraine’s crisis and its impact, in terms of energy perspective, both for Europe and the Western Balkans”; “some direct consequences of these developments towards Albania and what, from the other hand, opportunities may this country get, in becoming part of the “international energy architecture”, etc.

Considering the relatively strong energy dependence of EU from Russia, the article suggests some rational solutions (either short or long term ones) which could be summarized in some measures for the creation and raise of gas stocks; development of an energy infrastructure able to provide two-way supply; application of effective measures for the reduction of energy consumption, reliance strengthening on alternative energy sources, etc, all of them combined with discovering of new oil and gas sources. In this respect, Albania could find interesting perspectives not only in national but also in regional level and even beyond.